

**Banka popullore e Republikës së Maqedonisë**



**Raporti vjetor viti 2017**

Shkup, prill viti 2018

Përkthim në gjuhën shqipe: Grupi punues i Fakultetit të biznesit dhe ekonomisë pranë  
Universitetit të Evropës Juglindore Tetovë (i pa lekturuar).

## Përmbajtja

Fjala e guvernatorit.....	5
I. Politika monetare në vitin 2017.....	8
1.1. Qëllimet e politikës monetare.....	8
1.2. Pozicionimi i politikës monetare.....	9
II. Ambienti ndërkombëtar .....	17
III. Zhvillimet makroekonomike në vitin 2017 .....	21
3.1. PBB dhe inflacioni.....	21
3.2. Tregu i punës.....	24
3.3. Financat publike .....	26
3.4. Bilanci i pagesave, PIN dhe borxhi i jashtëm.....	30
3.5. Agregatet monetarë dhe kreditorë .....	35
3.5.1. Agregatet monetarë .....	35
3.5.2. Aktiviteti kreditues .....	38
IV. Mjedisi makroekonomik dhe politika monetare në vitin 2018 dhe 2019.....	41
V. Instrumentet monetare .....	44
Shtojca 1. Zhvillimet në tregun e këmbimit valutor dhe ndërhyrjet e BPRM-së .....	47
Shtojca 2. Zhvillimet në tregun e parasë .....	50
VI. Menaxhimi dhe investimi i rezervave valutore .....	52
6.1. Drejtimet themelore të menaxhimit me rezervat valutore .....	52
Shtojca 3. Aktivitetet lidhur me përmirësimin e kapacitetit institucional në menaxhimin e rezervave valutore .....	53
6.2. Kushtet për investime në tregjet financiare ndërkombëtare në vitin 2017 .....	54
6.3. Investimi i rezervave valutore .....	56
6.3.1. Shpërndarja e investimeve sipas portofoleve .....	56
6.3.2. Ekspozimi i kredisë dhe instrumentet .....	58
6.3.3. Struktura valutore .....	60
6.3.4. Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit dhe rezultatet nga investimi i rezervave valutore.....	61
VII. Aktivitetet dhe zhvillimet në sistemet e pagesave dhe pagesës së shërbimeve .....	64
7.1. Aktivitetet nga ana e BPRM-së .....	64
7.2. Volumi i qarkullimit pagesor .....	65
7.3. Zhvillimet e pagesave jo të gatshme në Republikën e Maqedonisë.....	66
7.4. Infrastruktura pagesore e cila përkrah pagesat digjitale .....	69
VIII. Lëshimi dhe menaxhimi i kartëmonedhave dhe monedhave të Republikës së Maqedonisë- operacionet e thesarit .....	71
8.1. Paratë e lëshuara në qarkullim .....	71

8.2.	Furnizimi i bankave dhe qendrave të parasë me kartëmonedha dhe monedha .....	72
8.3.	Përpunimi dhe shkatërrimi i kartëmonedhave dhe monedhave .....	73
8.4.	Ekspertizë për paratë e dyshimta / të falsifikuara .....	73
8.5.	Kontrolli i zbatimit të standardeve dhe kritereve për operacionet e "cash-it" me bankat dhe qendrat e parasë.....	74
8.6.	Shitjet e monedhave për qëllime koleksionimi.....	75
IX.	Kryerja e mbikëqyrjes dhe supervizionit .....	76
9.1.	Kontrollet në terren të rreziqeve.....	76
9.2.	Kontrollet në terren në përputhshmëri me rregulloret.....	77
9.3.	Përfundim .....	78
9.4.	Licencimi i bankave dhe kursimoreve në vitin 2017 .....	78
X.	Statistika .....	79
XI.	Auditimi i brendshëm.....	82
XII.	Përmirësimi i kapacitetit institucional të BPRM-së .....	83
12.1.	Planifikimi strategjik .....	83
12.2.	Menaxhimi me resurset njerëzore .....	83
12.3.	Aktiviteti hulumtues .....	84
12.4.	Menaxhimi i rreziqeve operacionale .....	85
12.5.	Sigurimi i vazhdimësisë në punë .....	86
12.6.	Siguria e sistemit të informacionit dhe mbrojtja e të dhënave personale.....	86
12.7.	Zhvillimi në fushën e teknologjisë informatike .....	87
XIII.	Aktivitete të tjera .....	88
13.1.	Bashkëpunimi ndërkombëtar .....	88
13.2.	Marrëdhëniet me publikun.....	89
13.3.	Edukimi financiar .....	90
13.4.	Aktivitetet e Muzeut dhe Bibliotekës dhe arkivit të BPRM-së.....	91

## Fjala e guvernatorit

Të nderuar,

Vitin që e lamë pas ishte një nga vitet më specifike në aspekt të planit ekonomik, në të cilin erdhën në shprehje pasojat nga prolongimi i krizës politike ndaj ekonomisë vendore e shprehur nëpërmjet stagnimit ekonomik. Vlen të përmendet se rreziqet dhe pasiguria ishin më të përhapura në gjysmën e parë, ndërsa në gjysmën e dytë të vitit erdhi gjer te stabilizimi i pritjeve dhe përshpejtimi gradual i ekonomisë. Në kësi ambienti makroekonomik, në vitin 2017 Banka popullore e Republikës së Maqedonisë (BPRM) arriti me sukses qëllimet e politikës monetare për ruajtjen e stabilitetit të çmimeve duke ruajtur qëndrueshmërinë e kursit të këmbimit të denarit ndaj euros, si dhe forcimin e mëtejshëm të stabilitetit financiar në ekonomi.

Gjysma e parë e vitit ishte në shenjën e paqëndrueshmërisë politike, e cila u pasqyrua me një rënie të aktivitetit ekonomik, përmbajtja e investitorët vendas dhe të huaj dhe ndryshimet e preferencave valutore të popullatës në raport me depozitat në banka. Megjithatë, në gjysmën e dytë të vitit, me stabilizimin e mjedisit politik dhe pritshmërisë së subjekteve ekonomike, erdhi gjer te përmirësimi i arritjeve makroekonomike, rritja e hyrjeve në tregun valutor dhe përmirësimi i strukturës së depozitave në favor të depozitave në denarë. Në përgjithësi, në vitin 2017, ekonomia e Maqedonisë përjetoi një stagnim ekonomik, që kryesisht ka të bëjë me rënien së investimeve që pasqyron kufizimin e investitorëve dhe stagnimin e projekteve publike të mëdha infrastrukturore, ndërsa konsumi dhe eksportet private mbeten shtytësit kryesorë të rritjes. Sidoqoftë, vlen të theksohen zhvillimet pozitive në fund të vitit, si dhe ruajtja e fundamenteve makroekonomike dhe transformimi strukturor i realizuar në vitet e fundit, të cilat së bashku me mjedisin e favorshëm të jashtëm japin një bazë solide për një kthim të shpejtë në rrugën e rritjes së qëndrueshme ekonomike. Ajo bazohet kryesisht në sektorin e eksportit i cili vazhdon të shënojë rezultate solide. Krahas kësaj, trendi i reduktimit të papunësisë, i mbështetur nga aplikimi i mëturshëm i masave aktive të tregut të punës, vazhdoi edhe në vitin 2017, duke ulur kështu papunësinë në 22.4%. Zhvillimet pozitive në tregun e punës, së bashku me rritjen e transfertave private dhe kreditimin e popullatës, ishin faktorët kryesorë që mbështetën konsumin privat.

Në llogarinë rrjedhëse të bilancit të pagesave në vitin 2017, u realizua një deficit i ulët prej 1.3% të PBB-së, që paraqet një zvogëlim krahasuar me vitin paraprak dhe njëherit një realizim më të ulët krahasuar me parashikimin, gjë që i konfirmon edhe realizimet e sektorit të jashtëm. Rezultatet e këtilla kanë të bëjnë kryesisht si rezultat i përmirësimit të saldosh të bilancit të mallrave dhe shërbimeve, si dhe në transfertat private. Rritja e eksportit ishte kryesish i përkrahur nga kompanitë e reja me kapital të huaj, por edhe të kompanive tradicionalisht të orientuara kah eksporti. Në llogarinë financiare, në vitin 2017, u vu re një nivel më i ulët e investimeve të huaja direkte prej 2.3% të PBB-së, që kryesisht pasqyron përmbajtjen e investitorëve, si dhe pagesat më të larta të dividendëve ndaj aksionarëve të huaj. Megjithatë, në tremujorin e fundit, u arrit përmirësim në këtë segment, në përputhje me pritjet e stabilizuar. Në tregun valutor, për dallim nga gjysma e parë kur u arrit rritje të shitjeve neto të monedhave të huaja me rritje të daljeve kryesisht për dividendë, në gjysmën e dytë, në përputhje me ambientin e përmirësuar, u realizua një blerje neto, e cila

tejkalonte plotësisht shitjen, duke lejuar një sasi të madhe të blerjes neto të monedhës së huaj për tërë vitin.

Në vitin 2017, BPRM ka vazhduar qasjen aktive në menaxhimin e rezervave valutore dhe në kushte jashtëzakonisht të ndryshueshme në tregjet ndërkombëtare, ka arritur kthim pozitiv nga investimi i rezervave valutore.

Inflacioni gjatë vitit 2017 shënoi një lëvizje graduale në rritje, në përputhje me lëvizjet e çmimeve botërore të produkteve bazike, veçanërisht të karburanteve. Mesatarisht, inflacioni shënonte 1.4% dhe ishte në suaza të projeksonit. Përsheptim shënoi edhe inflacionin bazë, e cili megjithatë rezultoi pjesërisht nga faktorët e njehershëm (duke përfshirë akcizat mbi produktet e duhanit). Fillimi i normalizimit të normës bazë të interesit në dhjetor 2016 (pas rritjes së saj në maj 2016 si reaktion i krizës politike dhe spekulimeve) vazhdoi edhe në dy muajt e parë të vitit 2017, me çka në shkurt të vitit 2017 solli normën e interesit përsëri në nivelin para krizës në nivel prej 3, 25%. Deri në fund të vitit, kjo normë e interesit ka ngelur e pandryshuar, në kushtet e inflacionit të ulët, pozicionit të favorshëm të bilancit të pagesave, zhvillimeve të qëndrueshme në tregun valutor dhe nga mesi i vitit edhe zhvillimet graduale pozitive të depozitave të bankave, por gjithashtu në gjysmën e parë të vitit është e pranishme pasiguri dhe nevoja për vëmendje.

Gjatë vitit 2017 janë shënuar lëvizje të favorshme të depozitave dhe kredive të bankave. Depozitat gjithsej u rritën për 5.4%, gjatë një kontributi rritës të depozitave në denarë nga aspekti valutor (kryesisht në gjysmën e dytë të vitit) dhe të depozitave afatgjata nga aspekti të afatizimit, gjë që tregon një stabilizim gradual të mëtejshëm të pritjeve. Gjithsej kreditë u rritën për 5.7%, me kontributin më të madh të kredive ndaj popullatës, ndërkohë që lëvizin pozitivisht edhe në huadhënien ndaj sektorit të korporatave. Sistemi bankar ka ruajtur stabilitetin e tij, me likuiditet dhe kapitalizim solid, dhe një nivel të moderuar dhe të qëndrueshëm të plasmanëve jofunksionale me rreth 6%. Edhe në këtë vit, vazhduan përpjekjet për të përmirësuar rregulloret bankare dhe për të miratuar standardet e Bazelit në fushën e kërkesave të reja kapitale, që në mënyrë shtesë kontribuan në stabilitetin e sistemit bankar. Gjatë vitit të kaluar, BPRM ka vazhduar të forcojë kapacitetet institucionale përmes aktiviteteve të mëtejshme në fushën e adoptimit të standardeve në sfera të ndryshme të veprimit, duke përfshirë në fushën e statistikave, sistemit të pagesave, menaxhimin e rrezikut operacional, sigurinë e sistemit informativ. Për të shënuar realizimin e përmirësimit të sistemit të pagesave MIPS të BPRM për pagesat në euro, jashtë vendit, në vitin 2017, BPRM mori pjesë aktive në procesin e inicimit të reformave në ekonomi nëpërmjet hartimit të Propozimit të tre projekteve strategjive në fushën e menaxhimit dhe zgjidhjes së plasmanëve jofunksionale, duke reduktuar shkallën e euroizimit dhe reduktimin e mjeteve monetare në qarkullim, përmes të cilave përfshirja e institucioneve të tjera kompetente në zbatimin e strategjive, në të ardhmen priten përmirësime në këto fusha.

Në vitin 2017 kemi vazhduar me organizimin e konferencave të rregullta dhe ngjarjeve të tjera publike, si forma për përhapjen e njohurive dhe rritjen e ndërveprimit me publikun profesional vendas. Ne gjithashtu intensifikuam aktivitetet në fushën e edukimit financiar si një mënyrë për të përmirësuar nivelin e kulturës financiare në vend. Vazhduam me aktivitete për sforcimin e transparencës dhe forcimin e marrëdhënieve me publikun, përmes kanaleve të ndryshme të komunikimit dhe duke iu afruar publikut të gjerë.

Në vitin 2017 shënuam 25 vjetorin e pavarësisë monetare të Republikës së Maqedonisë dhe rikujtuam sfidat e shumta që tejkaluam në periudhën e krijimit të denarit të Maqedonisë si dhe sendërtimin e besimit në monedhën vendase. Dhe në vitet e fundit, janë shënuara paqëndrueshmëri politike, u ballafaquam me disa nga sfidat e epokës së re, të cilën me sukses u kapërcyen dhe kështu e forcuam më tej besimin në institucionin dhe valutën vendore. Në këtë kontekst, edhe në vitin 2017, kemi ruajtur stabilitetin e çmimeve, stabilitetin e denarit dhe forcuam stabilitetin financiar të ekonomisë. Përveç kësaj, ne kemi punuar në përmirësimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të sistemit financiar, si dhe forcimin e mëtejshëm të reputacionit ndërkombëtar të institucionit.

Tejkalimi i krizës së zgjatur politike dhe bazat e shëndosha të ekonomisë, duke përfshirë stabilitetin e qëndrueshëm makroekonomik, hapin perspektiva për rritje të mëtejshme të ekonomisë, nëpërmjet vazhdimin të politikave të shëndosha makroekonomike. Në suaza të këtilla, kontributi i bankës popullore është i padiskutueshëm. BPRM do të angazhohet për qëllimet e saja dhe në të ardhmen do të vazhdojë të punojë në forcimin e saj institucional si një parakusht për përballimin e sfidave të reja.

26 prill, viti 2018  
Shkup

Guverner  
dhe kryesuesi i Këshillit të BPRM  
Dimitar Bogov

## I. Politika monetare në vitin 2017

### 1.1. Qëllimet e politikës monetare

*Ruajtja e stabilitetit të çmimeve paraqet objektivin themelor ligjor të politikës monetare të Bankës popullore të Republikës së Maqedonisë (BPRM). Një objektiv tjetër i BPRM-së, në varësi të qëllimit kryesor, është të kontribuojë në mbajtjen e një sistemi të qëndrueshëm, konkurrues dhe financiar të orientuar drejt tregut. BPRM e mbështet politikën e përgjithshme ekonomike pa rrezikuar arritjen e qëllimit bazë dhe në përputhje me parimin e një ekonomie të tregut të hapur me konkurrencë të lirë. Në aspekt strategjik, në drejtim të arritjes së objektivave bazë, nga tetori i vitit 1995 e gjer më vitin 2001 BPRM e aplikon strategjinë e ruajtjes stabël të kursit të këmbimit nominal të denarit në raport me markën gjermane dhe më pas në raport me euron.*

BPRM edhe në vitin 2017 me sukses i realizoi objektivat e definuara ligjore. Kursi valutor i Denarit në raport me Euron ishte stabël, ndërsa rezervat valutore edhe mëtej janë në zonën komforte, sipas të gjitha treguesve të mjaftueshmërisë. Në aspekt të stabilitetit të çmimeve, në vitin 2017, është realizuar një rritje e vogël e çmimeve vendore, në kushtet të lëvizjes përpjetë të inflacionit bazë (pjesërisht për shkak të faktorëve të njëhershëm) dhe komponentit energjetik të inflacionit (në pajtueshmëri me lëvizjen e çmimeve botërore të energjisë). Në vitin 2017, u ruajt me sukses stabiliteti financiar, si mbështetje shtesë në arritjen e qëllimit kryesor. Në dy muajt e parë të vitit 2017, BPRM vazhdoi normalizimin e politikës monetare, duke zvogëluar normën e interesit në nivelin e para muajit maj të vitit 2016, kur si pasojë e përgjigjes së efekteve të krizës politike, norma e interesit është rritur. Normalizimi i politikës monetare ishte reflektimi stabilizimit të mjedisit dhe përmirësimit e perceptimeve të agjentëve ekonomikë, të cilët vazhdimisht ishin të pranishëm që nga mesi i vitit 2016, por edhe gjatë vitit 2017. Deri në fund të vitit nuk janë bërë ndryshime në pozicionimin e politikës monetare.


Gjatë vitit, treguesit referojnë për një bazë të shëndoshë ekonomike, mungesën e pabarazive, stabilizimin e ambientit dhe uljen e pasigurisë, por disa rreziqe vazhduan të jenë të pranishme. Kështu, gjatë gjysmës së parë të vitit, BPRM ndërhyri me shitjen neto të valutave në tregun valutor, pjesërisht si reflektimi daljeve më të mëdha në bazë të pagesës së dividendëve ndaj investitorët e huaj. Ndryshimet në strukturën valutore të kursimeve të reja, edhe pse kryesisht ishin në dobi të monedhës vendase, prapë prapë ishin relativisht të moderuara dhe referojnë për kohën e nevojshme për një stabilizim të qëndrueshëm të pritjeve. Kah mes të vitit, u shënuar një përmirësim i dukshëm në zhvillimin e tregun valutor, ku në kushtet e prurjeve valutore në vend, pritjet e mëtejshme të favorshme dhe pozicionit valutor solid në sistemin bankar, me çrast në gjysmën e dytë të vitit<sup>1</sup> BPRM ndërhyri me blerjen e valutës

---

<sup>1</sup> Tendencat e volitshme vazhduan edhe në fillimin e vitit 2018, me çrast në mars të vitit 2018 BPRM e zbuti politikën monetare dhe norma bazë e interesit u zvogëluar nga 3.25% në 3.00%.




Grafik 1  
Hendeku i prodhimit dhe inflacioni\*



Burimi: ESHS dhe BPRM.


\*\* Hendeku i prodhimit paraqet indikatorin për gjendjen ciklike të ekonomisë dhe përlogaritjet si raport në mes të shmangies së PBB së realizuar nga PBB potenciale dhe nivelit të PBB potencial, hendeku i [prodhimit=(PPB i realizuar-PBB potencial)/ PBB potencial]. Inflacioni i përgjithshëm bazë paraqet ndryshimin mesatar vjetor.

Grafik 2  
Rezervat valutore bruto




Burimi: BPRM.

Grafik 3  
Treguesit e mjaftueshmërisë së rezervave valutore



\*Vlera e borxhit afatshkurtër nuk e përfshinë vlerën e repo transakcioneve.  
Burimi: ESHS dhe BPRM.

Grafik 4  
Treguesit e zgjedhur për stabilitetin financiar (në %)



Burimi: BPRM.

\* Sipas rregullës së Grinspan dhe Gvidoti (Greenspan-Guidotti rule) është e nevojshme që vendi të ruaj mbulimin e plotë të borxhit afatshkurtër (maturimi rezidual) me rezervat valutore.

\*\* Aktivi likuid përbëhet nga aktivi me likuiditet më të lartë dhe depozitave afatshkurtra të afatizuara te bankat e huaja. Aktivi gjithsej nuk i inkorporon mjetet te bankat vendore.

\*\*\* Treguesi u referohet kredive kah sektorin financiar dhe jofinanciare, me çka të dhënat për vitin 2016 i përfshinë ndryshimet nga rregullatorëve.

Burimi: BPRM dhe ESHS

## 1.2. Pozicionimi i politikës monetare

Në fillimin e vitit 2017, BPRM vazhdoi me normalizimin e politikës monetare, e cila filloi në dhjetor të vitit 2016. Domethënë, në muajin janar dhe shkurt, BPRM në dy raste ka ulur normën bazë të interesit për 0.50 pikë përqindjeje, pra nga 3.75% në 3.25%. me këtë, norma e interesit u soll në nivelin e para muajit maj të vitit 2016, kur BPRM e shtrëngoi politikën monetare<sup>2</sup>. Gjer në fund të vitit, në kushte të raporteve ekonomike të shëndosha dhe në mungesë të joekuilibre në ekonomi, por me rreziqe ende të pranishme në segmente të caktuara të ekonomisë, BPRM nuk bërë ndryshime të mëtejshme në pozicionimin e politikës monetare.


Ambienti për zbatimin e politikës monetare në vitin 2017 ishte dukshëm më i favorshëm krahasuar me vitin paraprak, por me pasiguri të zgjatur nga konteksti politikës së

<sup>2</sup> BPRM në maj të vitit 2016 e rriti normën bazë të interesit prej 3.25% në 4.00%. Rritja e normës së interesit ishte një reflektim i presioneve në tregun valutor dhe depozitave në sistemin bankar si pasojë e përkeqësimit të situatës politike në vend. Në të njëjtën kohë, për të ruajtur qëndrueshmërinë e monedhës vendase, përveç ndërhyrjeve në tregun e këmbimit valutor me shitjet e valutave të huaj dhe ndryshimet në rezervën e detyrueshme, u ndërmorën masa shtesë jo standarde që ishin me karakter të përkohshme.

brendshme dhestabilizimi gradual i pritjeve ekonomike. Në tregun valutor, në gjysmën e parë të vitit, me rreziqe ende të pranishme dhe daljeve të rëndësishme për dividendët jashtë vendit, BPRM ndërhyr me shitjen neto të valutës së huaj. Në tregun valutor, në gjysmën e parë të vitit, me rreziqe ende të pranishme dhe daljeve të rëndësishme për dividendët jashtë vendit, BPRM ndërhyr me shitjen neto të valutës së huaj. Në mungesë të pabarazive në ekonomi dhe shkaqe të shëndosha ekonomike, zhvillimet në tregun e këmbimit valutor janë përmirësuar ndjeshëm në gjysmën e dytë të vitit. Në rrethana të tilla, BPRM gjer në fund të vitit ndërhyr me një blerje neto të valutës, e cila tejkalonte ndjeshëm vëllimin e valutës së huaj neto të shitur që nga fillimi i vitit. Pasiguria që ende ekzistonte kishte një efekt në kursimin e familjeve. Përkatesisht, gjatë vitit, kursimet e familjeve vazhduan të rriteshin, por me dinamikë të ndryshueshme dhe ndryshime në preferencat valutore të familjeve. Megjithatë, në fund të vitit, pati një përmirësim të dukshëm në këtë segment, në favor të depozitave në denarë.

Grafik 5

Çmimet botërore të produkteve primare, realizimet dhe revidimet, ndryshimet mesatare vjetore, në %




Pasiguria dhe ndryshueshmëria e zhvillimeve ishin karakteristikë edhe për ambientin e jashtëm, që kërkonte gjithashtu nevojën shtesë për të menaxhuar me kujdes politikën e brendshme monetare. Ndonëse ekonomia botërore vazhdoi të rimëkëmbej, rreziqet që kanë të bëjnë me tendencat globale të proteksionizmit, efektet daljes së Britanisë nga Bashkimi Evropian, rreziku i një shtrëngimi të papritur të kushteve financiare globale dhe tensioneve gjeopolitike ishin aktuale dhe vazhdimisht të pranishëm. Ndryshimi në çmimet botërore të produkteve primare, që ndikon në inflacionin e brendshëm dhe kushtet e shkëmbimit, ishte një veçori shtesë e mjedisit në vitin 2017. Gjatë vitit, parashikimet për çmimet botërore të naftës, metaleve dhe ushqimeve u korrigjuan në kahe të ndryshme, duke rritur pasigurinë dhe duke ndryshuar supozimet mbi të cilat bazohen pritshmëritë për ekonominë vendase.

Bankat qendrore kyçe, vazhduan të zbatojnë politika monetare divergjente<sup>3</sup>. Më pasato, në komunikimin e tyre me publikun, ata në mënyrë aktive përdorën instrumentin


<sup>3</sup>Më shumë informacione në lidhje me këtë pyetje janë të vendosura në pjesën që ka të bëjë me ambientin ndërkombëtar.

"Inkuadrimi i politikave" me qëllim të ruajtjes së kushteve të qëndrueshme në tregjet financiare, të cilat kontribuan në stabilitetin e indekseve të paqëndrueshmërisë në tregjet financiare.

Grafik 6  
Arritjet Rishikimet e rritjes ekonomike globale, ndryshimet vjetore (në %)




Grafik 7  
VIX indeks (indeksi i ndryshueshmërisë implicite të letrave me vlerë S&P500)



Politika fiskale edhe në vitin 2017 u vlerësua si e kujdesshme, me çka deficitit buxhetor në vitin 2017 mbeti në nivelin e vitit paraprak. Megjithatë, rreziqet që lidhen me dinamikën e arritjes së të ardhurave buxhetore të planifikuara dhe pasiguria e lidhur me strukturën e financimit të deficitit buxhetor kanë ndikuar në mjedisin në të cilin është zbatuar politika monetare. Kah mesi i vitit, është bërë një rebalanc të Buxhetit, me të cilin të ardhurat dhe shpenzimet buxhetore janë rishikuar duke u reduktuar, pa ndryshuar në treguesin e deficitit buxhetor në krahasim me planin fillestar (2.9% të PBB-së). Nga ana tjetër, me rebalancin e buxhetit është bërë një ndryshim në strukturën për financimin e deficitit. Kështu, ndryshe nga plani fillestar për financimin e kombinuar të deficitit buxhetor, pothuajse të barabartë të huamarrjes së brendshme dhe të jashtme, rebalanci i buxhetit parashikoi një shumë më të lartë të financimit të deficitit nga burimet e jashtme, me supozimin e ndarjes së një pjese të fondeve nga huazimi i ri si depozita në llogari te BPRM. Arritjet në vitin 2017 dallojnë nga buxheti fillestar dhe nga rebalanci. Pra deficitit buxhetor në fund të vitit shënonte 2.7% të PBB-së dhe ishte më i ulët nga ai i rebalancit për vitin 2017. Për më tepër, financimi i planifikuar i deficitit buxhetor nëpërmjet huamarrjes së jashtme të shtetit u zhvendos për në fillim të vitit 2018 dhe nevojat për financimin e deficitit u siguruan nga burime të brendshme, nëpërmjet lëshimit të letrave me vlerë të qeverisë dhe përdorimit të depozitave të qeverisë pranë BPRM.


Grafik 8

Ndryshime të tepricave buxhetore dhe struktura e financimit të deficitit (në milionë denarë)



Konteksti politik i brendshëm që krijoi pasiguri në 2017 ishte gjithashtu një faktor rreziku për projeksionet makroekonomike mbi të cilat bazohet vendimmarrja monetare. Pasiguria e vazhdueshme e mjedisit politik ndikoi në rritjen e PBB-së, projektimi i të cilit u rishikua në rënie gjatë vitit. Në vitin 2017, ekonomia u stagnua, duke reflektuar rënien e investimeve. Nga ana tjetër, konsumi privat vazhdon të rritet, por pa krijuar presione të mëdha mbi inflacionin apo pozicionin e jashtëm të ekonomisë. Krahas kësaj, në vitin 2017, një burim i rëndësishëm i rritjes ishte aktiviteti i eksportit, e mbështetur nga mjedisi i jashtëm dhe i aktiviteteve të kapaciteteve të reja prodhuese në pronësi të huaj. Trendet e favorshme në sektorin e eksportit kontribuan në një përmirësim të dukshëm në deficitin e llogarisë rrjedhëse, që ishte më e ulët se sa ajo pritëse.

Grafik 9  
Revidimi i projeksioneve makroekonomike



Burimi: BPRM dhe ESHS. Parashikimet për të gjithë treguesit ka të bëjë me parashikimet makroekonomike të BPRM.

Rezervat valutore gjatë vitit 2017 shënuan ulje, por gjatë vitit qëndruan në zonë komforte. Vrojtuar nga disa faktorë, ulja e rezervave valutore në masë të madhe u ndikua kryesisht nga daljet financiare të bazuara në transaksionet e shtetit. Përkatësisht, në mungesë të huamarrjes më të madhe të jashtme të shtetit (financimi u zhvendos në fillim të vitit 2018), ndërsa rikthimi i rregullt i detyrimeve të maturuara, transaksionet e vendit kontribuan në uljen e rezervave valutore në vitin 2017. Në reduktimin e rezervave kontribuan edhe depozitat në valutë të huaj të bankave të BPRM, të cilat matura plotësisht në tremujorin e tretë dhe nga rezervat zyrtare u shpërndanë në rritjen e potencialit të këmbimit valutor të bankave<sup>4</sup>. Nga ana tjetër, ndërhyrjet në valutë të BPRM kanë dhënë një kontribut pozitiv në ndryshimin e rezervës valutore. Kështu, në tregun valutor në vitin 2017, BPRM ka arritur blerjen neto të valutës në vlerë prej rreth 66 milionë euro.


Analizuar në aspekt të dinamikës, në gjysmën e dytë të vitit, zhvillimet në tregun valutor dukshëm u përmirësua, me stabilizimin e pritjeve vendore dhe të investitorëve dhe kreditorëve të huaj. Arritjet e këtilla, nga njëra anë e pasqyrojnë ndjeshmërinë e tregut valutor në periudhën kohore kur ka rritje të pasigurisë, ndërsa në anën tjetër, paraqet

<sup>4</sup> BPRM aplikoi ankandet e instrumenteve për depozitat në valutë të bankave në periudhën Maj-Tetor 2016. Në këtë periudhë, bankat patën mundësi të plasojnë depozita në valutë në BPRM me kushte më të favorshme sesa ato që mbizotëronin në tregjet financiare ndërkombëtare. Duke pasur parasysh afatizimet e ndryshme të depozitave në valutë, gjendja e tyre në gjysmën e parë të vitit 2017 gradualisht u zvogëlua dhe depozitat maturuan tërësisht në fillim të gushtit 2017.

tregues të qartë për stabilizim të shpejtë të zhvillimeve të këtij segmenti në kushte të raporteve të shëndosha ekonomike, mungesë së jo ekuilibre në ekonomi dhe potencialit solid të valutave në sistem.

Grafik 10

Intervenimet e BPRM në tregun valutor dhe depozitave valutore të bankave të plasura te BPRM (në milionë Euro)




Pas tre viteve të rënies, niveli i përgjithshëm i çmimeve në vitin 2017 shënoi një rritje mesatare vjetore prej 1.4%, e cila ishte pothuajse tërësisht si pasojë e rritjes së inflacionit bazë, me një kontribut neutral të çmimeve të ushqimeve dhe një kontribut minimal pozitiv nga çmimet e energjisë. Gjatë vitit, BPRM nuk bëri revidime të rëndësishme në projeksionin e inflacionit, ndërsa rezultatet e anketave mbi pritshmëritë e inflacionit nuk treguan ndonjë ndryshim domethënës në pritjet për dinamikën dhe rrugën e lëvizjes së normës së inflacionit. Inflacioni bazë (pa ushqim dhe energji) gjatë vitit pati një trend të moderuar të rritjes dhe ishte mesatarisht 2.3% për vitin 2017, pjesërisht i ndikuar nga faktorët e njehershëm (duke përfshirë akcizat mbi produktet e duhanit).

Dinamika e kursimeve të familjeve dhe struktura e saj e afatizues dhe valutore gjatë vitit u ndikuan pjesërisht nga ndryshimet në mjedisin vendor të brendshëm. Kështu, depozitat e familjeve kishin tendencë rritëse, me përjashtim të disa periudhave të caktuara të vitit në të cilat kishte pasiguri më të theksuar për shkak të ambientit politik të brendshëm. Në aspekt të strukturës së afatizimit të depozitave të familjeve, në vitin 2017 rritja e kursimeve afatgjata ishte pothuajse në vazhdimësi e pranishme, duke treguar pritshmëri të qëndrueshme të subjekteve ekonomike. Në përgjithësi, krahas rritjes së ngadaltë që nga fillimi i vitit, kursimet e familjeve u përshpejtuan ndjeshëm në gjysmën e dytë të vitit, me çka ky sektor në vitin 2017 ka dhënë kontributin më të madh në rritjen e depozitave totale.

Grafik11

Shkalla e Euroizimit, pjesëmarrja e depozitave valutore në gjithsej depozitat (me depozitat në para), si %




Burimi: BPRM.

bankave në rritjen e ofertës së kredive. Nga pikëpamja e dinamikës, në gjysmën e dytë të vitit u shënuua forcimi i aktivitetit të kredisë, me ndërrime të favorshme nga një aspekt sektorial, në gjysmën e dytë të vitit u shënuan me zvogëlimet rreziqeve nga mjedisi i brendshëm politik dhe i pritjeve të përmirësuara të bankave për aktivitetin e përgjithshëm ekonomik. Kështu, flukset e kredive në vitin 2017 shënuan rritje më të lartë krahasuar me vitin paraprak, duke tejkaluar kështu pritjet me parashikimet e tetorit<sup>5</sup>. Arritjet e këtilla ishin në përputhje me rezultatet e anketave për aktivitete kredituese, sipas të cilave normalizimi i kërkesës për kredi nga sektori i korporatës në vitin 2017, pas ngadalësimit të ndjeshëm të rritjes së tij në vitin paraprak, lehtësimi i mëtejshëm i kushteve të kreditimit dhe përmirësimit të perceptimeve për rrezikun te bankat.

Në mbështetje të kreditimit të sektorit korporativ, kontribuoi masa jo standarde e BPRM që ka të bëjë me rezervat e detyrueshme dhe në fund të vitit 2017 u vendos në periudhën e ardhshme të vazhdojë me zbatimin e saj<sup>6</sup>.

Grafik 12


Struktura e aktivitet të bankave – kontributi në ndryshim vjetor p.p.



Burimi: BPRM.

Grafik 13

Kontributi në ndryshim vjetor të gjithsej kredive, në p.p.




Burimi: BPRM.

<sup>5</sup> Bëhet fjalë për flukset e kredive të korigjuara për efektin e ndryshimeve rregullatore.

<sup>6</sup> Në seancën e rregullt të Këshillit të BPRM, e mbajtur më 21 dhjetor të vitit 2017, Këshilli vendosi të vazhdohet me aplikimin e masave jostandarde për zvogëlimin e bazës së rezervave të detyrueshme në denarë të bankave afariste për shumën e kredive të sapo aprovuara ndaj neto eksportuesve dhe prodhuesve vendor të energjisë elektrike për dy vite shtesë. Me këtë masë mundësohet zvogëlim të bazës për rezervat e detyrueshme në denarë të bankave me shumën e kredive të sapo aprovuara ndaj neto eksportuesve dhe prodhuesve vendor të energjisë elektrike dhe investimit të bankave në letra me vlerë të borxhit në valutë vendore pa klauzolë valutore të lëshuara nga neto eksportuesit dhe prodhuesit vendor të energjisë elektrike. Masa ka qen e sjellë në vitin 2012, ndërsa filloi të zbatohet në vitin 2013. Nga sjellja e masës, kjo është hera e tretë e vazhdimit të aplikimit të sajë për plus dy vite shtesë, përkatësisht gjer në fund të vitit 2019.


Grafik 14  
Kushtet e kreditimit dhe kërkesa për kredi \*



\* Te kushtet kredituese, neto-përqindja negative do të thotë lehtësimi i kushteve kredituese. Te kërkesa, neto-përqindja negative do të thotë zvogëlim të kërkesës.

Duke marrë parasysh zbatimin e kursit të këmbimit fiks të denarit ndaj euros, ndryshimet në normat e interesit në eurozonë, të tilla si ekonomi spirancë, kanë një rol të rëndësishëm në aspektin e pozicionimit të politikës monetare në vend. Në vitin 2017, Banka Qendrore Evropiane (BQE) nuk bëri ndryshime në normën bazë të interesit, e cila mbeti në nivelin historikisht më të ulët (0.00%). Megjithatë, në fillim të vitit BPRM uli normën bazë të interesit në dy raste, duke normalizuar atë në nivelin e para majit të vitit 2016, kur, si përgjigje të faktorëve të brendshëm të veçantë, norma e interesit është rritur. Si rezultat i këtyre ndryshimeve, diferenca midis normave bazë të interesit të dy bankave qendrore është ngushtuar, nga 3.75 p.p. në 3.25 p.p.. Për sa i përket normave të interesit të bankave në ekonominë vendore, diferenca midis normës së interesit në denarë dhe normës së interesit të depozitave në valutë në vitin 2017 kishte një tendencë rënëse dhe në fund të vitit ajo arriti në 1.3 p.p., e që ishte më e ulët në raport me atë të fundit të vitit të kaluar (1.5 p.p.). Kështu, në vitin 2017 vazhdoi trendi i ngushtimit i diferencës së normës së interesit, pasi u ndalua përkohësisht në vitin paraprak. Ngushtimi i shtrirje së normës së interesit në pjesën më të madhe rezultoi nga rënia e normës së interesit për depozitat në denarë (nga 2.5% në 2.1%), me një rënie më të vogël në normën e interesit për depozitat në valutë (nga 1.0% në 0.8%).

Grafik 15  
Shtrirja e normave bazë të interesit të BPRM dhe BQE, nëp.p.




Burimi: BPRM dhe BQE.

Norma bazë e interesit e BPRM: norma e interesit të bonove të thesarit të BPRM.

Norma bazë e interesit e BQE: norma e interesit të operacioneve bazë për rifinancim të BQE.

Grafik 16  
Shtrirja e normave të interesit të bankave në ekonominë vendore, nëp.p.



Burimi: BPRM.



## II. Ambienti ndërkombëtar<sup>7</sup>


Ambienti ekonomik global në vitin 2017 ishte i favorshëm, me një përshpejtim të moderuar të rritjes reale të PBB në një nivel global prej 3.6%, kundrejt 3.2% në vitin paraprak. Me këtë procesi i rikuperimit ciklik global vazhdoi gjatë këtij viti, mbështetur nga aktiviteti i investimeve dhe rritja e tregtisë, në kushte të favorshme financiare, pozicion monetar i përshtatshëm, rritje të mëtejshme të besimit në suaza globale dhe rritjen e çmimeve të produkteve primare. Rritja e vitit 2017 është relativisht i sinkronizuar, përkatësisht del nga rikuperimi edhe i ekonomive të zhvilluara dhe me rritje të përshpejtuar, ku ky konstatim në veçanti, i referohet aktivitetit të investimit. Sa i përket grupit të ekonomive të zhvilluara, pati një përmirësim të ndjeshëm në arritjet ekonomike në Shtetet e Bashkuara, ku PBB-ja reale u rrit me 2.2% (1.5% në 2016), mbështetur nga rritja e besimit të familjeve dhe bizneseve private. Rritje solide prej 2.1% në bazë vjetore shënoi Eurozona, që është rritja më e lartë në shtatë vitet e fundit, nën ndikimin e kërkesës së brendshme të sforcuar, me kushte të favorshme financiare dhe me rreziqe të reduktuara politike dhe në një farë mase nga eksportet neto të nxitur nga tendencat e favorshme në tregtinë globale. Në grupin e ekonomive me zhvillim të shpejtë dhe ekonomive në zhvillim, ka pasur një përshpejtim të moderuar të rritjes në 4.6% (nga 4.3% në 2016), por me ndryshime në ritmin e rimëkëmbjes midis vendeve të veçanta. Pavarësisht nga arritjet solide në afat të shkurtër, shikuar në periudhën afatmesme, ende ekzistojnë disa rreziqe të disfavorshme për rritjen globale, të lidhura me mundësinë e shtrëngimit të kushteve financiare, rritjes së proteksionizmit në tregti, pasigurisë në negociatat mbi marrëdhëniet e ardhshme midis Britanisë së Madhe dhe BE-së dhe rreziqeve të tjera gjeopolitike.

Norma mesatare vjetore e inflacionit në nivel botëror në vitin 2017 ishte 3.1%, e që flet për një përshpejtim të caktuar të inflacionit krahasuar me vitin paraprak kur ishte 2.8%. Përshpejtimi i inflacionit është veçanërisht i pranishëm në vendet e zhvilluara, ku norma e inflacionit u rrit nga 0.8% në vitin 2016 në 1.7% në vitin 2017, duke reflektuar më pas rimëkëmbjen e kërkesës totale dhe rritjen e çmimeve të produkteve primare. Kjo veçanërisht i dedikohet periudhës gusht-dhjetor, kur u ngritën rritje të mprehtë në çmimet e naftës, të cilat kontribuan në një rritje më të theksuar të inflacionit global. Nga ana tjetër, me ekonomitë me rritje të shpejtë në vitin 2017, norma e inflacionit ishte pothuajse e pandryshuar dhe shënonte 4.2% (4.3% në vitin 2016).


---

<sup>7</sup> Analiza bazohet në "Pasqyra ekonomike botërore" të FMN, tetor 2017 dhe janar të vitit 2018; "Perspektiva ekonomike globale" të Bankës botërore, janar të vitit 2018; raportet tremujore të BPRM.


Grafik 17  
Rritja ekonomike globale (në %)



Grafik 18  
Rritja e PBB te vendet e zhvilluara (në %)




Grafik 19  
Rritja vjetore e tregtisë globale (në %)



Burimi: Pasqyra ekonomike botërore, tetorviti 2017 dhe i azhurnuar janar viti 2018, FMN.


Sa i përket treguesve konkret sasiorë që pasqyrojnë mjedisin e jashtëm të ekonomisë së Maqedonisë, kërkesa e huaj efektive dhe inflacioni efektiv i huaj në vitin 2017 shënoi përshpejtimin e rritjes. Gjegjesisht, kërkesa efektive e huaj u rrit me 2.3% (2.1% në vitin 2016), me çka vazhdoi rikuperimin graduale. Ekonomitë e Gjermanisë, Bullgarisë dhe Serbisë kanë pasur kontributin më të madh pozitiv në realizimet vjetore, ndërsa vendet tjera kanë pasur një kontribut pozitiv por më të moderuar. Çmimet efektive të huaja në vitin 2017 shënuan rritje mesatare prej 1.9%, pavarësisht pandryshueshmërisë së tyre në vitin 2016. Shikuar nga aspekti i vendeve të veçanta, çmimet në Gjermani dhe Serbi kishin kontribut më pozitiv, ndërsa vendet e tjera kishin një kontribut pozitiv por më të moderuar.

Grafik 20  
Kërkesa e huaj efektive



Burimi: Përlogaritjet e BPRM<sup>8</sup>.

Grafik 21  
Inflacioni i huaj efektiv



Në tregjet e produkteve primare, në vitin 2017, çmimet e energjisë dhe metaleve shënuan një rritje të ndjeshme, ndërkohë që çmimet e produkteve ushqimore në, mënyrë të moderuar u ulën. Shikuar për vitin 2017 në tërësi, çmimi mesatar i naftës ishte më i lartë për 21.1% nga çmimi mesatar në vitin 2016, duke arritur në 54 dollarë për fuçi. Shikuar sipas dinamikës, çmimet e naftës shënuan një rritje gjatë gjithë vitit, e reflektuar në masë të madhe nga rritja e kërkesës globale, nivelin i ulët i stoqeve<sup>9</sup> dhe vazhdimin e marrëveshjes së OPEC dhe Rusisë për reduktimin e prodhimit të naftës<sup>10</sup>. Çmimi i metaleve në vitin 2017 shënoi një rritje të theksuar prej 21.5% krahasuar me çmimin e vitit 2016. Shikuar nga dinamika, çmimet e metaleve u rritën gjatë gjithë vitit, me rritje më të theksuar në nëntë muajt e parë të vitit 2017. Rritja e çmimeve në masë të madhe i dedikohet rritjes së kërkesës nga ana e Kinës dhe SHBA. Nga ana tjetër, çmimet e ushqimeve në vitin 2017 shënuan një rënie të lehtë prej 2.0%.


<sup>8</sup> Kërkesa e huaj efektive llogaritet si shumë e indekseve të ponderuar të prodhimit të brendshëm bruto të partnerëve më të rëndësishëm tregtarë të Republikës së Maqedonisë. Në llogaritjen e indeksit janë të përfshira: Gjermania, Greqia, Italia, Holanda, Belgjika, Spanja, Serbia, Kroacia, Sllovenia dhe Bullgaria. Panderët janë llogaritur në bazë të pjesëmarrjes së eksportit ndaj këtyre vendeve në eksportin e përgjithshëm. Inflacioni i huaj paraqet një shumë të ponderuar të indekseve të çmimeve të konsumit të vendeve, partnerë më të rëndësishëm të Republikës së Maqedonisë në sferën e importit të mallrave për konsumin e gjerë. Struktura e ponderuar bazohet në pjesëmarrjen e normalizuar të importit nominal nga secili vend në importet e përgjithshme nominale në periudhën 2013 – tremujori i tret i vitit 2016. Në llogaritjen e këtij treguesi janë përfshirë: Bullgaria, Gjermania, Greqia, Franca, Italia, Austria, Sllovenia, Kroacia dhe Serbia.

<sup>9</sup> Në gjysmën e parë të dhjetorit, që mbyllur njëri nga naftësujellit kryesorë në Detin e Veriut për shkak të një shkatërrimi. Riparimi zgjati rreth tre javë, duke shkaktuar ndërprerjen e furnizimit me rreth 10 milionë fuçi naftë.

<sup>10</sup> Vendet anëtare të OPEC së bashku me Rusinë për gjatë vitit 2017 dy herë vazhduan marrëveshjen për reduktimin e prodhimit të naftës. Përkatesisht, më 25.5.2017, u soll një vendim nga shtetet anëtare të OPEC-ut për të vazhduar kontratën e reduktimit të prodhimit të naftës për nëntë muaj të tjerë (mars 2018), dhe më pas marrëveshja e njëjtë më 30.11.2017 u zgjat deri në fund të vitit 2018. Kjo marrëveshje synonte të kontribuonte në zvogëlimin e sasive të kësaj lënde djegëse në nivel global. Marrëveshja u mbështet gjithashtu edhe nga vendet prodhues të naftës që nuk janë anëtare të OPEC, duke përfshirë Rusinë, me çka u reduktua prodhimi i naftës për 1.8 milion fuçi më pak në ditë deri në dhjetor 2018. Gjithashtu, në nëntor 2017 masës iu bashkua edhe Nigeri dhe Libi, vende që nuk ishin më parë pjesë e marrëveshjes.


Grafik 22

Lëvizja mujore e çmimeve të produkteve primare energjetike dhe joenergjetike (Euro, indeks: 2005=100)



Grafik 23

Lëvizja mujore e çmimeve të naftës së papërpunuar, metaleve<sup>11</sup> dhe ushqimeve (Euro, indeks: 2005=100)



Burimi: Baza e të dhënave të Bankës botërore për çmimet e produkteve primare.

Në vitin 2017, Bankat qendrore të vendeve të zhvilluara kanë zbatuar politika monetare divergjente. Në SHBA, në kushtet e arritjeve solide të ekonomisë, FED vazhdoi të normalizonte politikën monetare. Kështu, në 2017, FED ngriti tri herë normën e interesit, e cila në fund të vitit 2017 ishte më e lartë për 0.75 p.p. në raport me vitin 2016, përkatësisht ajo shtrihet nga 1.25 gjer në 1.5%. Rritja e normës së interesit në masë të madhe i dedikohet vlerësimeve të FED-it për përmirësimin e kushteve në tregun e punës, përshejtimin e rritjes ekonomike dhe si dhe presioneve të mundshme inflacioniste në të ardhmen. Gjatë vitit 2017 ndryshime në politikën monetare gjithashtu bëri edhe Banka Qendrore të Anglisë. Përkatësisht, në takimin e nëntorit, Banka e Anglisë ngriti normën bazë të interesit me 0.25 pikë përqindjeje, për herë të parë që nga korriku i vitit 2007, me çrast në fund të vitit 2017 ajo ishte 0.5%. Rritja e normës së interesit është reflektimi pritjeve të Bankës së Anglisë për një rritje të inflacionit gjatë periudhës së ardhshme mbi shënjestrimin prej 2%. Nga ana tjetër, BQE vendosi të vazhdojë programin për lehtësimin kuantitativ deri në shtator të vitit 2018, por në një masë më të vogël dhe pa një datë të definuar për ndërprerjen e plotë të udhëzimeve për mbajtjen e ulët të normave preferenciale të interesit për një periudhë më të gjatë në të ardhmen deri në përshtatshmërinë e qëndrueshëm të inflacionit drejtë inflacionit të synuar.


<sup>11</sup> Indeksi i metaleve është indeks kompozitë që përfshinë çmimet e bakrit, aluminit, xeheve të hekurit, fletëzave metalike, nikelit, zingut, plumbit dhe uranimit.

### III. Zhvillimet makroekonomike në vitin 2017


#### 3.1. PBB dhe inflacioni

Pas periudhës së pandërprerë katërvjeçare të rritjes së ekonomisë nacionale të Republikës së Maqedonisë, në vitin 2017 u shënuar stagnimi i aktivitetit ekonomik. Vazhdimësia e pasigurisë politike ndikoi në ciklin investues, dhe shkaktoi që edhe pranë rritjes stabël të konsumit privat dhe përforcimit të sektorit të eksportit, totali i aktivitetit në suaza të ekonomisë nacionale të mos shënojë ndryshime. Shikuar sipas dinamikës, në gjysmën e parë të vitit është shënuar rënie e PBB, ndërsa në gjysmën e dytë të vitit u shënuar shëndetësim i aktivitetit ekonomik vendor, duke realizuar rritje për 0.7% në bazë vjetore.

Grafik 24  
PBB dhe kërkesa efektive e jashtme  
(shkalla vjetore e ndryshimit real, në %)



Grafik 25  
PBB (rritje reale, në %) dhe komponentët  
shpenzuese të PBB (kontribut në rritje, në p.p.)




Burimi: Enti Shtetërorë Statistikorë dhe Eurostat, përlloraritje të BPRM, Janë shfrytëzuar të dhëna paraprake të PBB për vitin 2016 ndërsa për vitin 2017 janë shfrytëzuar të dhëna të vlerësuara

Në vitin 2017 pjesë më e madhe e sektorëve ekonomik, shikuar për tërë vitin, kontribuuan në mënyrë negative në ndryshimin e aktivitetit ekonomik. Në rastin konkret, rënie më e lartë e aktivitetit është shënuar në sektorin e ndërtimtarisë, sektor ky që për vite me radhë ishte bartësi kryesor i rritjes. Krahas ambientit jo të volitshëm, ndryshimet në sektorin e ndërtimtarisë pjesërisht rezultojnë edhe nga baza shumë e lartë krahasuese nga vitit paraprak, vit ky në të cilën u realizuan më shumë projekte infrastrukturore të financuara me para publike në lëmin e ndërtimeve të ulëta. Krahas ndërtimtarisë, gjatë vitit 2017 rënie e vlerës së shtuar u shënuar edhe në sektorin e industrisë, si dhe në pjesën më të madhe të sektorit të shërbimeve.<sup>12</sup> Por, edhe pranë trendëve të pavolitshëm në fjalë, gjatë vitit 2017 u shënuar rritje e aktivitetit në sektorët e tregtisë, transportit dhe hotelerisë, informatave dhe komunikimeve, dhe në bujqësi.


<sup>12</sup>Në suaza të sektorit të shërbimeve, vlerë e shtuar më e vogël në vitin 2017 është shënuar te veprimtaritë financiare dhe veprimtaritë e sigurimeve, veprimtaritë që kanë të bëjnë me patundëshmëritë, veprimtaritë profesionale, shkencore dhe teknike, administrative dhe ndihmëse, veprimtaritë në lëmin e menaxhimit publik dhe mbrojtjes, sigurimit social, arsimit dhe mbrojtjes shëndetësore dhe sociale dhe veprimtaritë në lëmin e artit, zbavitjes dhe rekreacionit dhe veprimtaritë tjera shërbuese.

Posaçërisht e rëndësishme ishte rritja e vlerës së shtuar në tregti, zhvendosje kjo që shikuar sipas të dhënave të vlerës së qarkullimit, kryesisht rezulton nga lëvizjet në tregtinë me sasi më të mëdha<sup>13</sup> të mallrave, ndërsa është shënuar rënie e tregtisë së vogël.

Grafik 26  
Kontribut në rritjen vjetore të PBB  
(në pikë përqindjeje)



Grafik 27  
PBB, industria dhe shfrytëzimi i kapaciteteve



Burimi: Enti Shtetërorë Statistikorë dhe kalkulime të BPRM.

Janë shfrytëzuar të dhëna paraprake të PBB për vitin 2016 ndërsa për vitin 2017 janë shfrytëzuar të dhëna të estimuara.


Shikuar sipas anës kreditore të PBB, në vitin 2017 u shënuar zvogëlim i konsiderueshëm i kontributit pozitiv të konsumit vendor, kryesisht nën trysni të rënies së kërkesës investuese. Pasiguria dhe lëvizjet e disfavorshme në gjysmën e parë të vitit, për herë të parë pas periudhës gjashtëvjeçare të rritjes së pandërprerë, rezultuan me zvogëlim të investimeve bruto. Nga ana tjetër, rritja e pagave reale dhe e punësimit, rritja e pensioneve si dhe kreditimi solin e popullsisë pozitivisht ndikuan në rritjen e konsumit gjatë tërë rrjedhës së vitit. Në pjesën e kërkesës neto-eksportuese, edhe në vitin 2017 është shënuar rritje e aktivitetit eksportues, rritje kjo që në masë më të madhe ndërlidhet me funksionimit e kapaciteteve të reja prodhuese me orientim eksportues, por me atë që ndikim pozitiv pati lëvizja e volitshme e faktorëve të mjedisit të jashtëm. Konkretisht, eksporti edhe më tej vazhdon të jetë komponenti me shkallën më të lartë të rritjes dhe të kontributit në PBB. Paralelisht me zhvendosjet e theksuara në pjesën e eksportit, është shënuar edhe rritje e importit të mallrave dhe shërbimeve, me atë që eksporti-neto në vitin 2017 ka pasur ndikim të butë negative.

Në vitin 2017, për herë të parë pas periudhës trevjeçare të rënies permanente, çmimet e konsumit në Republikën e Maqedonisë shënuan rritje, edhe atë për 1.4%, që është pasojë e zhvendosjeve të tre komponentët e inflacionit. Në fakt, ndryshimet në çmimet botërore të produkteve primare në vitin 2017 reflektuan edhe në çmimet vendore të energjisë dhe ushqimit, ku u shënuar edhe ngushtim i kontributit negative. Njëkohësisht, erdhi në përshpejtim të rritjes së inflacionit bazë (komponentës çmimore, në përjashtim të ushqimit dhe energjisë), duke reflektuar kështu efekte nga ndikimi i faktorëve të njëhershëm (akcizat dhe produktet e duhanit), rritja e çmimeve të shërbimeve telefonike, efekte të caktuara sekondare nga dinamika e komponentës energjetike dhe ushqimore mbi çmimet tjera, në kushte të presioneve të vogla nga ana e kërkesës (në kushte të jazit pozitiv prodhues dhe rritjes së kostove të punës për njësi produkti).

<sup>13</sup>Analiza e lëvizjeve në tregti është bërë në bazë të dhënave për qarkullim në tregti.(ESHHS).

Grafik 28


Inflacioni vendor dhe inflacioni i huaj efektiv, shkallë vjetore të rritjes (në %)



Burim: ESSH, Eurostat dhe përlogaritje të BPRM.

Grafik 29

Komponenti i ndryshueshëm (ushqim dhe energji) dhe afatgjatë i inflacionit (kontribute vjetore, në pikë përqindjeje)



Kontribut më të lartë pozitiv në inflacionin e shënuar në vitin 2017 ka pasur komponenti bazik ( rritje prej 2.3% dhe kontribut prej 1.2 p.p. në totalin e inflacionit). Zhvendosjet në këtë komponentë ishin kryesisht nën ndikimin e çmimeve të rritura të duhanit<sup>14</sup> dhe shërbimeve<sup>15</sup>. Në vitin 2017, rritje kanë shënuar edhe çmimet vendore të energjisë ( rritje për 2.4% dhe kontribut prej 0.2 p.p.), për herë të parë pas një periudhe trevjeçare të rënies së vazhdueshme, që në masë më të madhe mundet ti përshkruhet rritjes së çmimeve vendore të derivateve të naftës, duke pasur parasysh rritjen e lartë vjetore të naftës në bursat botërore<sup>16</sup>. Te çmimet e ushqimeve, gjatë vitit janë shënuar lëvizje divergjente të llojet e caktuara të produkteve ushqimore, por shikuar në tërësi, gjatë vitit 2017 komponenti i inflacionit që ka të bërë me çmimet e produkteve ushqimore ka mbetur i pandryshuar.

<sup>14</sup>Rritja e çmimeve të duhanit është kombinim i rritjes së çmimit të një lloji të caktuar të cigareve në prill dhe në qershor të vitit 2017. Në korrik të vitit 2017 u bë zmadhimi i akcizës së cigareve ( nga 1.Korrik.2017 e deri më 1.Korrik.2023, lartësia e akcizës çdo vit do të rritet për 0.2 denarë), por ndryshimet mujore dhe tremujore të çmimeve të duhanit nuk dëshmojnë korrigjim të çmimit.


<sup>15</sup>Në pjesën e shërbimeve, kontribut pozitiv më të lartë në rritje kishin çmimet e trafikut ajror, shërbimeve të komunikimit dhe çmimet e shërbimeve hotelerike.

<sup>16</sup>Në vitin 2017, çmimi i naftës "brent", i shprehur në euro, shënoi rritje mesatare vjetore prej 21%, në krahasim me çmimin mesatar të naftës në vitin 2016.

## 3.2. Tregu i punës


Në vitin 2017, pjesa më e madhe e treguesve të tregut të punës dëshmojnë vazhdimësi të trendëve të volitshme<sup>17</sup>, edhe pranë impulsive më të buta nga sektori real. Krahas kësaj, edhe në vitin 2017 vazhdoi zbatimi i masave aktive për punësim<sup>18</sup>, si përkrahje shitesë për rritjen e punësimit. Numri i të punësuarve në vitin 2017 shënoi rritje për 2.4%, që është rritje gati identike me rritjen e shënuar në vitin 2016. Njëkohësisht shkalla e punësimit shënoi rritje për 1 p.p. duke arritur kështu në nivel prej 44.1%. Analizuar sipas sektorëve, ngjashëm si në vitin 2016, rritja e punësimit në masë më të madhe rrjedhon nga shërbimet, në suaza të cilëve, rritje e konsiderueshme e punësimit është shënuar te tregtia dhe të veprimtaria "objekte për bujtje dhe veprimtari shërbyese me ushqim". Në vitin 2017 vazhdoi rritja e punësimit edhe te industria, duke reflektuar kështu në masë më të madhe zhvendosjet pozitive te industria përpunuese. Njëkohësisht, pas rënies dyvjeçare, numri i personave të punësuar në bujqësi në vitin 2017 mbeti gati i pandryshuar në krahasim me vitin 2016.

Grafik 30  
Disa tregues të tregut të punës  
(në %)



Burimi: Enti shtetërorë i statistikave dhe kalkulime të BPRM

Grafik 31  
Shkalla e papunësisë sipas grup moshave  
(në %)



Ngjashëm si në anën e kërkesës për fuqi punëtore, gjatë vitit u shënuar edhe një përshtatje e butë rritëse edhe në anën e ofertës së fuqisë punëtore. Në fakt, totali i popullsisë aktive shënoi rritje prej 0.6%, që në kushte të rënies paralele për 0.6% në popullsisë joaktive, rezultoi me një zhvendosje të vogël rritëse të shkallës së aktivitetit (për 0.3 p.p.), duke arritur nivelin prej 56.8%. Lëvizjet pozitive si në anën e ofertës ashtu edhe në anën e kërkesës së fuqisë punëtore, rezultuan me rënie të papunësisë, në ç'rast shkalla e papunësisë në vitin 2017 rra në 22.4% (zvogëlim për 1.4 p.p.). Shikuar sipas grup-moshave, zvogëlimi e shkallës së përgjithshme të papunësisë, rezulton nga ulja e papunësisë te të gjitha grup-moshat e veçanta.


<sup>17</sup>Analiza e tregut të punës është realizuar përmes shfrytëzimit të anketave tremujore të fuqisë punëtore, përkatësisht treguesit vjetorë për vitin 2017 janë nxjerrë në formë të mesatares së të dhënave të publikuara tremujore.

<sup>18</sup>Edhe gjatë vitit 2017, Qeveria e Republikës së Maqedonisë përmes Ministrisë për punë dhe politikë sociale dhe Agjencinë për punësim, vazhdoi me implementimin e programeve dhe masave aktive për të stimuluar shkallën e punësimit.




Zmadhimi i pagave mesatare vazhdoi edhe në vitin 2017, por me një intensitet më të lartë në krahasim me vitin paraprak, që pjesërisht rezulton nga norma ligjore për zmadhim të pagës minimale<sup>19</sup>, normë kjo implementimi i së cilës filloi në tremujorin e fundit të vitit. Kështu pagat nominale neto dhe bruto<sup>20</sup>, shënuan rritje vjetore për 2.6% (kundrejt 2.0% përkatësisht në vitin 2016). Korigjim rritës i pagave neto është shënuar te gati të gjithë sektorët e veprimtarive<sup>21</sup>, me atë që rritje posaçërisht e lartë është shënuar te sektori "xehetari dhe ekstraktim i gurit" (10.5%), te industria përpunuese (5.9%) dhe te sektori "informata dhe komunikime" (5.2%). Krahas kësaj, për të katërtin vit në radhë është shënuar edhe rritje reale e pagave. Në rastin konkret, në kushte të rritjes së matur të çmimeve të konsumit, pagat neto dhe bruto shënuan rritje identike prej rreth 1.2%.

Grafik 32  
Bruto dhe neto paga vjetore mesatare  
(ndryshime vjetore, në %)



Burimi: Enti shtetërorë i statistikave dhe kalkulime të BPRM.

Grafik 33  
Neto paga mesatare sipas sektorëve  
(Ndryshime vjetore, në %)



Në vitin 2017 është shënuar përkeqësim i treguesve të konkurrencshmërisë<sup>22</sup>. Në fakt, gjatë vitit është shënuar trend negative i produktivitetit të punës, e cila në vitin 2017 është me e ulët për 3.1%, që korrespondon me realizimet më të dobëta në aktivitetin ekonomik. Shikuar sipas sektorëve, kontribut më të lartë në rënie ka shënuar sektori i shërbimeve, si sektor në të cilin është shënuar edhe zvogëlimi më i madh e vlerës së shtuar në kushtet të ngadalësimit të rritjes së punësimit. Kostot e punës për njësi produkti në vitin 2016 shënuan rritje më intensive (6.3%), në kushte të rritjes së shënuar të kostove të tre sektorët, nga të cilët kontribut më të lartë kanë sektori i shërbimeve dhe industria, ndërsa te bujqësia, kostot e punës për njësi produkti shënojnë rritje minimale, pas periudhës trevjeçare të rënies së vazhdueshme.


<sup>19</sup>Më 19.Shtator.2017, Parlamenti i Republikës së Maqedonisë i votoi ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për Pagë minimale në Republikën e Maqedonisë. Në përputhshmëri me ndryshimet dhe plotësimet në fjalë, paga minimale në Republikën e Maqedonisë për muajin shtator të vitit 2017, për të gjithë sektorët e ekonomisë nacionale u fiksua në nivelin 17.300 denarë bruto, përkatësisht 12.000 denarë neto.

<sup>20</sup>Bruto paga e përgjithshme e paguar përfshin: neto pagat e paguara për muajin përkatës, tatim personal i paguar dhe kontribute të paguara (për sigurim pensional dhe invalidor, për sigurim shëndetësorë, për punësim, për sëmundje profesionale dhe për ekonominë e ujërave). Të dhënat e mësipërme kanë të bëjnë me pagat e paguara. .


<sup>21</sup>Paga më të ulëta janë paguar te sektori "ndërtimtari"

<sup>22</sup>Produktiviteti dhe kostot e punës për njësi produkti në nivel të ekonomisë nacionale janë kalkuluar në bazë të dhënave për PBB, numrin e përgjithshëm të punësuarve, Anketës për fuqinë punëtore të Enti Statistikorë të Republikës së Maqedonisë si dhe të dhënave për bruto-pagat mesatare. Produktiviteti i përgjithshëm përllogaritet si shumë e ponderuar e produktivitetit të kalkuluar në nivel të sektorëve individual. Në suaza të sektorëve individual produktiviteti përllogaritet si raport në mes vlerës së shtuar në sektorin përkatës dhe numrit të punësuarve.

Grafik 34  
Produktiviteti i punës  
(kontribut në rritjen vjetore, në p.p.)



Grafik 35  
Kostoja e punës për njësi produkti  
(kontribut në rritjen vjetore, në p.p.)




Burimi: Enti shtetërorë i statistikave dhe kalkulime të BPRM.

### 3.3. Financat publike

Totali i deficitit buxhetorë edhe në vitin 2017 mbeti i pandryshuar në krahasim me vitin paraprak duke qëndruar në nivelin 2.7% të PBB. Participimi i totalit të hyrave buxhetore në PBB në vitin 2017 ishte në nivelin 29% duke realizuar kështu një rritje të butë na krahasim me vitin paraprak. Një zhvendosje të butë të lartë në bazë vjetore kanë shënuar edhe të dalat buxhetore, duke arritur nivelin 31.7% të PBB, në kushte të stanjimit të shpenzimeve rrjedhëse dhe zmadhimit të pjesëmarrjes së shpenzimeve kapitale.

Grafik 36  
Totali i të hyrave dhe të dalave buxhetore dhe komponentët e tyre  
(% të PBB)




Burimi: Ministria e Financave e Republikës së Maqedonisë dhe përlogaritje të BPRM.

Deficiti buxhetorë i realizuar në vitin 2017 është më i ulët në krahasim me buxhetin fillimisht të planifikuar (18.607 milionë denarë respektivisht 2.9% të PBB). Në fakt ky deficit është më i ulët edhe në krahasim me planet komfor rebalancit të buxhetit të bërë në korrik

të vitit 2017 (18.567 milionë denarë, respektivisht 2.9% të PBB)<sup>23</sup>. Në fakt, edhe pranë realizimit më të ulët të hyrave buxhetore në krahasim me rebalancin (97.3%), të dalat buxhetore shënuan zhvendosje më të shprehur rënëse, si rezultat i lëvizjeve të shpenzimit kapitale, por edhe të shpenzimit rrjedhës. Lëvizje të caktuara janë shënuar edhe të struktura e financimit, duke pasur parasysh se financimi i jashtëm i planifikuar i deficitit buxhetor për vitin 2017 u zhvendos për në fillim të vitit 2018, kështu që nevojat për financim u mbuluan përmes shfrytëzimit më të madh të mjeteve nga depozitat në Bankën Popullore sesa që ishte planifikuar më herët.

Ndryshimet të deficitit rrjedhës buxhetor<sup>24</sup> dhe të deficitit primar<sup>25</sup> në vitin 2017 janë të ngjashme me ndryshimet e shënuara në totalin e deficitit. Kështu, deficitin rrjedhës buxhetor në vitin 2017 ka qenë 0.9% të PBB, pra ka mbetur në të njëjtin nivel si në vitin paraprak, ndërsa deficitin primar buxhetor në fund të vitit 2017 është 1.4% të PBB, duke shënuar rënie minimale në krahasim me vitin paraprak (1.5 të PBB).

Grafik 37  
Tregues fiskal  
(% të PBB)



Burimi: Ministria e Financave e Republikës së Maqedonisë dhe përlogaritje të BPRM.

Saldoja buxhetore e përshtatur në mënyrë ciklike (saldoja strukturore) në vitin 2017 ka vazhduar të ngushtohet, për të tretin vit në radhë, duke sinjalizuar kështu konsolidim të financave publike përmes komponentit diskrecional. Kështu, impulse fiskal, që paraqet dallim në mes saldosh të përshtatur në mënyrë ciklike për vitin aktual dhe vitin paraprak, në vitin 2017 ka shënuar vlerë negative, në kushte të deficitit strukturor<sup>26</sup> më të ulët (3.4% të PBB, kundrejt 4.1% të PBB në vitin 2016). Lëvizje të ngjashme vërehen edhe të impulse fiskal primar edhe të deficitit primar strukturor.

<sup>23</sup>Me rebalancin e buxhetit të bërë në korrik të vitit 2017, u bë zvogëlimi i barabartë i totalit të ardhurave dhe të dalave buxhetore (për 2867 milion denarë dhe 2907 milion denarë, respektivisht), me çka deficitin buxhetorë (18567 milion denarë) nuk shënoi ndonjë ndryshim të konsiderueshëm në krahasim me shumën e planifikuar. Me rebalancin e realizuar u bënë ndryshime edhe në burimet e mjeteve për financim të deficitit buxhetor, respektivisht u planifikua huazim më i lartë i jashtëm dhe i brendshëm, në ç'rast për dallim nga buxheti paraprak, u parapa që pjesë nga mjetet e siguruar të shndërrohen në depozite në llogari të BPRM.


<sup>24</sup>Saldoja rrjedhëse buxhetore paraqet dallimin në mes të ardhurave rrjedhëse (të ardhura nga kontribute tatimore si dhe të ardhura jotatimore) dhe të dalat rrjedhëse buxhetore (për paga dhe kontribute, për mallra dhe shërbime, transfere dhe norma të interesit)

<sup>25</sup>Saldoja primare buxhetore paraqet dallim në mes të ardhurave të përgjithshme buxhetore dhe të dalurave të përgjithshme buxhetore, të zvogëluara për nivelin e pagesës së obligimeve rrjedhëse në bazë të borxheve të marra (norma të interesit). Ky tregues fiskal konsiderohet të jetë më adekuat gjatë analizës së kursit aktual të politikës, meqë ai integron shpenzimet fiskale që rrjedhojnë nga menaxhimi i kaluar i politikës fiskale në pjesën e borxhit publik.

<sup>26</sup>Deficiti i përgjithshëm strukturor fitohet poqese nga deficiti faktik buxhetor largohet komponenti ciklike buxhetore. Ai kalkullohet si dallim në mes të ardhurave të përgjithshme buxhetore të përshtatura sipas efektit të dallimit në mes PBB potencial dhe faktit me koeficient të elasticitetit 1 dhe të dalurave reale buxhetore të përshtatura sipas efektit të dallimit në mes PBB potencial dhe faktit me koeficient të elasticitetit 0. Deficiti primar strukturor kalkullohet ashtu që nga deficiti i përgjithshëm strukturorë minusohet efekti i kostove për norma të interesit.

Grafik 38

Saldoja ciklike e përshtatur buxhetore dhe impulsi fiskal




Burimi: Ministria e Financave e Republikës së Maqedonisë dhe përlogaritje të BPRM.

Deficiti buxhetor në vitin 2017 u financua nga burime të brendshme, përmes emetimit neto të letrave shtetërore me vlerë dhe përmes shfrytëzimit të depozitave të shtetit të BPRM. Në rastin konkret, përfshirja e këtyre dy burime vendore varronte gjatë rrjedhës së vitit. Në fakt, gjatë gjysmës së parë të vitit 2017, deficit buxhetor në masë më të madhe u financua përmes shfrytëzimit të depozitave të shtetit në BPRM, ndërsa në pjesën e dytë të vitit më i shprehur ishte financimi i deficitit përmes emetimit të letrave të reja me vlerë në tregun vendor.

Grafik 39

Struktura e financimit të saldove buxhetore (në milionë denarë)



Burimi: Ministria e Financave e Republikës së Maqedonisë dhe përlogaritje të BPRM.


Gjatë vitit 2017 u bë publikimi i letrave të reja shtetërore me vlerë në total prej 11.214 milionë denarë, që është një huazim i brendshëm më i lartë në bazë neto, në krahasim me vitin paraprak kur kjo shumë arriti në 3037 milionë denarë. Gjatë vitit 2017, emetimet e reja të letrave shtetërore me vlerë në masë më të madhe kishin afat më të gjatë të maturimit, kundrejt maturimit dymbëdhjetë mujorë, kornizë kjo së cilës i përkasin pjesa më e madhe e bonove shtetërore. Me këtë, edhe gjatë vitit 2017 vazhdoi trendi i orientimit të obligimeve në bazë të letrave me vlerë të maturuara drejt letrave me vlerë me afate më të gjata të maturimit, që rezultoi me zgjatje të afatit mesatar të maturimit të letrave shtetërore me vlerë.

Shikuar sipas afatit të maturimit, në vitin 2017 zmadhimi i totalit të vlerës së letrave shtetërore me vlerë në tërësi rezultoi nga rritja e gjendjes së fletë obligacioneve shtetërore, ndërsa gjendja e bonove shtetërore ka shënuar rënie në bazë vjetore. Nga këndvështrimi i

strukturës valutore të borxhit shtetërorë të brendshëm, në vitin 2017, është shënuar rritje e matur e portofolit të letrave shtetërore me vlerë e që kanë klauzolë valutore. Por, edhe pranë kësaj, edhe më tutje në totalin e letrave shtetërore me vlerë më shumë të pranishme janë letrat shtetërore me vlerë në valutë vendore. Në vitin 2017, Ministria e financave bëri zvogëlimin e normave të interesit të letrave shtetërore me vlerë, për tërë gjatësinë e lakores së kthimit, për maturimin e letrave me vlerë që u ofruan në shitje gjatë vitit.


Grafik 40

Normat e interesit të letrave shtetërore me vlerë (në %)



Grafik 41

Struktura maturuese e letrave shtetërore me vlerë (në milionë denarë)



Burimi: Ministria e Financave e Republikës së Maqedonisë dhe BPRM.

Në fund të vitit 2017, borxhi i pushtetit qendrorë<sup>27</sup> ishte 3.958,5 milionë euro,që paraqet rritje për 2.8% në bazë vjetore, në kushte të zvogëlimit të pjesëmarrjes së tij në PBB, nga 39.6% në 39.3% në bazë vjetore. Paralelisht me këtë është shënuar zmadhim i borxhit të brendshëm (nga 14.4% në 15.7% të PBB), në kushte të zvogëlimit të borxhit të jashtëm të shtetit (nga 25.2% në 23.6% të PBB).<sup>28</sup> Totali i borxhit publik<sup>29</sup> në fund të vitit ishte 4787 milionë euro duke qenë kështu për 1.6% më i lartë në bazë vjetore, me atë që është zvogëluar pjesëtarja e tij në PBB në bazë vjetore nga 48.5% në 47.6%, Rritja vjetore e totalit të borxhit publik në tërësi rrjedhin nga rritja e borxhit shtetërorë<sup>30</sup> (në kushte të rritjes së borxhit të brendshëm të pushtetit qendrorë), derisa borxhi i garantuar i ndërmarrjeve publike dhe shoqërive aksionare në pronësi shtetërore ka shënuar një rënie të butë. Për rrjedhojë, pjesëtarja e borxhit të garantuar në totalin e borxhit publik u zvogëlu nga 18.3% në vitin 2016 në 17.3% në vitin 2017, me atë që është zvogëluar edhe pjesëtarja e tij në PBB nga 8.8% në 8.2% në bazë vjetore. Analizuar nga aspekti i strukturës së borxhit publik sipas rezidencës, në vitin 2017 janë shënuar lëvizje divergjente te të dy komponentët kyç. Në fakt, pjesëmarrja e borxhit publik të jashtëm në PBB shënoi rënie për 2.1 p.p. në bazë vjetore duke rënë në 31.7% të PBB. Nga ana tjetër, pjesëmarrja e borxhit të brendshëm shënoi rritje për 1.2 p.p. duke arritur nivelin 15.9% të PBB.

<sup>27</sup>Ka të bëjë me borxhin e pushtetit qendrorë duke përfshirë këtu fondet publike, por duke përjashtuar komunat


<sup>28</sup>Gjatë korrikut të vitit 2017 maturuan dhe u paguan obligimet e shtetit në bazë të borxhit financiar afatgjatë nga Dojçe Banka (në total prej 77 milion euro) si dhe obligimet në bazë të normave të interesit për eurobondit e tretë dhe të pestë (në total 45 milion euro)

<sup>29</sup>Borxhi publik është i definuar me ligjin për borxhin publik („Gazeta zyrtare e RM“ nr. 165/14), sipas së cilit ai paraqet shumën e borxhit shtetërorë dhe borxhit të ndërmarrjeve publike të themeluara nga ana e shtetit ose komunave, komunat në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit, si dhe ndërmarrjet tregtare te të cilat shteti ose komunat, komunat në qytetin e Shkupit ose qyteti i Shkupit paraqiten si pronar kryesor ose i vetëm, e për të cilat shteti ka dhënë garancinë shtetërore.

<sup>30</sup>Borxhi shtetërorë përfshin shumën e borxheve të qeverisë qendrore dhe pushteteve lokale (komfor ligjit për borxh publik)

Grafik 42

Borxhi i pushtetit qendrorë dhe totali i borxhit publik




Burimi: Ministria e Financave e Republikës së Maqedonisë dhe përllogaritje të BPRM.

### 3.4. Bilanci i pagesave, PIN dhe borxhi i jashtëm

Analiza e lëvizjeve në bilancin e pagesave për vitin 2017 sinjalizon mbajtjen e një niveli të matur të deficitit në llogarinë rrjedhëse, në kushte të ndryshimeve të mëtejme strukturore në sektorin eksportues, pasigurisë së zvogëluar dhe besimit të rritur si dhe mungesës së disbalanseve. Deficiti në llogarinë rrjedhëse ishte 1.3% të PBB, duke u ngushtuar në bazë vjetore për 1.4 p.p. të PBB. Përmirësimi i dukshëm në pjesën e transaksioneve rrjedhëse reflekton deficitin e zvogëluar në këmbimin e mallrave dhe të shërbimeve, të plotësuar me të hyrat e rritura në bazë të ardhurave sekondare. Shikuar nga këndvështrimi i rrjedhave financiare, në vitin 2017 nuk është shënuar rritje e konsiderueshme e borxhit të jashtëm të ekonomisë, ndërsa efektet pozitive nga të derdhurat e investimeve të huaja të drejtpërdrejta janë neutralizuar me të dalat neto të një pjesë e rrjedhave financiare afatshkurta. Në rrethana të tilla, një pjesë e deficitit në llogarinë vjetore u financua përmes rezervave devizore, të cilat në vitin 2017 u zvogëluan në bazë vjetore, por edhe më tej mbetën në nivel adekuat.

Grafik 43


Llogaria rrjedhëse, kapitale dhe financiare dhe ndryshimi i rezervave devizore (në milionë euro)



Burimi: BPRM.

Grafik 44


Participimi i komponentëve të veçanta në ndryshimin vjetor të llogarisë rrjedhëse (në pikë përqindje të PBB)



Analiza e këmbimit të jashtëm tregtar në vitin 2017 sinjalizon një rritje solide të dyja komponentëve kryesore, në kushte të rritjes pakëz më të shprehur të eksportit në krahasim me rritjen e importit të mallrave. Në vitin 2017, forcë lëvizëse e realizimeve pozitive të eksporti ishte aktiviteti eksportues i kapaciteteve të reja industriale në pronësi të huaj, e që në pjesë të madhe erdhi në shprehje përmes rritjes së shprehur të eksportit të makinave dhe mjeteve transportuese. Krahas kësaj, kontribut pozitiv në rritjen e eksportit kanë pasur edhe një pjesë e sektorëve tradicional, e në veçanti eksporti nga industria për përpunim të metaleve, për dallim nga pesë vitet paraprake kur kjo degë shënonte norma negative të rritjes. Realizimet në pjesën e eksportit, reflektuan edhe në anën importuese, në çrast komponenti i lëndës së parë për industrinë e përpunimit të metaleve dhe për kapacitete e reja të huaja ishte faktori më ndikim më të madh në rritjen e importit. Kontribut shtesë në rritjen e importit kishte edhe importi investues, importi i dedikuar për konsum personal si dhe importi energjetik kryesisht për shkak të rritjes më të lartë nominale të derivateve të naftës, të shkaktuar nga rritja e çmimeve të naftës në bursat botërore, e në kushte të rënies së sasive të importuara.

Grafik 45


Kontribut në ndryshimin vjetor të eksportit (në p.p.)



Burimi: BPRM.

Grafik 46


Kontribut në ndryshimin vjetor të importit (në p.p.)



Analiza e treguesve të konkurrencshmërisë çmimore të ekonomisë nacionale të Republikës së Maqedonisë<sup>31</sup> tregon një përmirësim të matur në krahasim me vitin paraprak. Kursi real efektiv i këmbimit (KREK) i përlogaritur sipas kostove të jetesës ka shënuar deprecim për 0.5% ndërsa KREK i deflacionuar me çmimet e prodhuesve të produkteve industriale ka shënuar deprecim më të shprehur prej 3.1%. Ndryshimet e tilla vjetore në masë më të madhe rezultojnë nga lëvizjet e volitshme të çmimit relative, ndërsa ndryshimi i kursit nominal efektiv i këmbimit, ndikoi në drejtim të kundërt, përkatësisht në drejtim të aprecimit të KREK, kryesisht për shkak të deprecimit të lirës turke dhe Stërligut britanike.

Grafik 47


KKEN и KREK, (Kalkuluar sipas indeksit të shpenzimeve për jetesë dhe çmimeve të prodhuesve, 2010=100)



Burimi: BPRM.

Grafik 48

Çmime relative (2010=100)



Saldoja pozitive në këmbim me shërbime kontribuoi për një ngushtim të deficitit të llogarisë rrjedhëse për 0.4 p.p. të PBB gjatë vitit 2017. Zvogëlimi i matur i të dalave neto në suaza të shërbimeve në ndërtimtari dhe kompensimeve për shfrytëzim të pronësisë intelektuale, si dhe suficiti i rritur të shërbimeve turistike, paraqesin mbartës kryesorë të ndryshimeve të volitshme vjetore. Komponenti më i rëndësishëm për financim të deficitit tregtar, të hyrat sekondare, shënuan rritje të pjesëmarrjes në PBB për 0.5 p.p. për herë të parë në periudhën e fundit pesëvjeçare. Suficiti i rritur kryesisht rezulton nga të hyrat neto më të larta nga transferet private, që janë refleksion i rritjes së blerjes së efektivës nga tregu i këmbimit (e dhënë që shfrytëzohet për të vlerësuar transferet private në para të gatshme), në kushte të stabilizimit të pritjeve dhe zmadhimit të besimit të subjekteve ekonomike pas jostabilitetit politik të vitit të kaluar. Nga ana tjetër deficit të hyrat primare u rrit për 0.3 p.p. të PBB, por që paraqet një rritje më të matur në krahasim me realizimet në dy vitet paraprake. Në fakt, të dalat të ardhurat nga investimet, të kushtëzuara nga fitimi më i lartë i projektuar i kompanive me kapital të huaj, shënuan rritje të ngadalësuar dhe në mënyrë shtesë u zbutën nga derdhjet në bazë të kompensimeve për të punësuar në suaza të kategorisë "të ardhura primare".


Në vitin 2017, llogaria financiare e bilancit të pagesave karakterizohet me neto pozitë neutral. Në kushte të mungesës së huazimit të jashtëm më dinamik, burim kryesor i të hyrave në llogarinë financiare janë investimet e huaja të drejtpërdrejta. Investimet e drejtpërdrejta në vitin 2017 ishin në nivelin 2.3% të PBB që parqet rënie në krahasim me vitin 2016 (3.3% të PBB). Shikuar nga aspekti strukturor, në vitin 2017 janë shënuar derdhje

<sup>31</sup>Analiza e treguesve për kompetitivitetin çmimor është e bazuar në indekset e RKEK, të kalkuluar me ponder të bazuar në këmbimin me jashtë pa produkte primare. Produktet primare që mbeten të papërfshira në përlogaritje janë: nafta dhe derivatet e naftës, çeliku dhe hekuri, mineralet dhe lëndët e para të importuara për kapacitetet e reja prodhuese në zonat e lira ekonomike .




në bazë të fitimit të reinvestuar dhe të kapitalit aksionar, ndërsa të dalat neto janë realizuar në bazë të borxhit në mes kompanive<sup>32</sup>. Shikuar sipas veprimtarive, investimet e investitorëve të drejtpërdrejtë ishin kryesisht të orientuar drejt sektorit të shërbimeve (aktivitete në lidhje me patundshmëri dhe tregti) dhe drejt xehetarisë<sup>33</sup>. Huazimi i sektorëve tjerë të ekonomisë (bankat dhe sektori korporativ) në formë të borxheve afatgjata kishte ndikim të pakonsiderueshëm në rrjedhat financiare, që reflekton financimin më të maturë të projekteve infrastrukturore të ndërmarrjeve publike dhe zvogëlimin e neto krijimit të borxheve të institucionet depozituese. Efektet nga huazimi i jashtëm i shtetit në vitin 2017 në llogarinë vjetore janë negative, për dallim nga viti paraprak, kur ky faktor paraqiste burimin kryesor të ardhurave financiare. Në fakt, në bazë të huazimeve financiare afatgjate është realizuar pagesë e borxheve (0.5% të PBB), që rezulton nga shfrytëzimet më të dobëta dhe pagesat e realizuara të obligimeve të rregullta të maturuara ndaj kreditorëve të huaj<sup>34</sup>. Komponentët afatshkurta dhe të ndryshueshëm të llogarisë financiare shënuan lëvizje divergjente, kështu që obligimet neto të akumuluar në bazë të kredive tregtare mundësuan përkrahje të llogarisë financiare. Nga ana tjetër, valutat dhe depozitat edhe më tutje janë kategoria më e shprehur dalëse, që reflekton të dalat e larta ndaj segmentit "sektorë tjerë të ekonomisë", pjesërisht të zbutura përmes të hyrave neto të institucionet depozituese.

Grafik 49  
Llogaria financiare  
(% e PBB)



Burimi: BPRM.

Grafik 50  
Investime të drejtpërdrejta  
(% e PBB)




Pozita investuese ndërkombëtare e Republikës së Maqedonisë (PIN) në fund të vitit 2017 ishte negative dhe kapte shumën prej 6021.6 milionë euro, respektivisht 59.8% të PBB. Në krahasim me vitin paraprak PIN ka shënuar zgjerim për 2.5 p.p. të PBB. Ndryshimi i realizuar vjetorë është refleksion i mjeteve më të vogla ndërkombëtare, por edhe i zmadhimit të obligimeve ndërkombëtare (për 1.9 p.p. dhe 0.6 p.p. të PBB përkatësisht).

<sup>32</sup>Huazimi në mes kompanive ishte negative në bazë neto, si pasojë e rritjes më të shprehur të mjeteve-kredive të miratuara, në krahasim me rritjen e obligimeve-kredi të pranuar.

<sup>33</sup>Ky konstatim duhet komentuar me një dozë të kujdesit, për shkak se është e bazuar në të dhëna paraprake për lëvizjet e investimeve të drejtpërdrejta për vitin 2017. Në përputhshmëri me metodologjinë dhe politikën e publikimit të dhënave në fjalë, në periudhën e përpilimit të raportit vjetorë nuk ndodhen në qasje të dhëna mbi shpërndarjen sipas veprimtarive për një pjesë të investimeve të drejtpërdrejta, e që janë në formë të fitimit të reinvestuar dhe pjesë e instrumenteve huamarëse.


<sup>34</sup>Në korrik të vitit 2017 është realizuar pagesë e rregullt e një pjesë të kredisë ndaj "Dojçe Bankës" në vlerë prej 75 milion euro.

Grafik 51  
Pozita ndërkombëtare investuese  
(% e PBB)



Burimi: BPRM.


Grafik 52  
Pozita ndërkombëtare investuese sipas sektorëve  
(% e PBB)



Analiza e pozitës investuese ndërkombëtare sipas sektorëve të ekonomisë tregon se ndryshimet negative në tërësi rezultojnë nga pozita neto e bankës qendrore, si pasojë e rënies së rezervave devizore, derisa sektorët tjerë kontribuojnë në drejtim të një përmirësimi të matur të totalit të neto pozitës së jashtme. Kështu sektori "institucione depozituese" shënon ndryshime pozitive si rezultat i pagesës së borxheve përmes borxheve afatgjata, ndërsa pozita neto e përmirësuar e sektorit "shtet" është rezultat i zvogëlimit të obligimeve neto në bazë të borxheve tjera afatgjata (para së gjithash për shkak të pagesës së kredisë ndaj Dojçe Bank në vlerë prej 77.3 milionë euro). Lëvizjet e volitshme të "sektorët tjerë" janë më të matura dhe në masë të madhe rezultojnë nga rritja pak më e madhe e mjeteve, në krahasim me rritjen e obligimeve.

Borxhi i jashtëm neto në fund të vitit 2017 është 7403.4 milionë euro, respektivisht 73.6% të PBB, që paraqet zvogëlim për 0.7 p.p. të PBB në krahasim me fundin e vitit 2016. Borxhi bruto i jashtëm më i ulët sipas treguesve relative, në tërësi rezultojnë nga zvogëlimi vjetor i borxhit publik, në kushte të rritjes së butë të borxhit të sektorit privat. Në rastin konkret, në suaza të borxhit publik, zvogëlimi i përshkruhet borxheve më të vogla afatgjata të pushtetit qendrorë, ndërsa rritja e borxhit privat në masë më të madhe rezultojnë nga zmadhimi i borxhit në mes kompanive si rezultat i rritjes së obligimeve ndaj investitorëve të drejtpërdrejtë.

Grafik 53  
Borxhi i jashtëm bruto, klasifikim sipas huazuesve dhe sektorëve institucional (% e PBB)



Burimi: BPRM.

Shikuar në përgjithësi, treguesit e huazimit të jashtëm të ekonomisë vendore edhe më tutje dëshmojnë se borxhi i jashtëm bruto ndodhet në "zonën e sigurtë". Në rastin konkret, sipas treguesit të pjesëmarrjes së borxhit të jashtëm bruto në PBB, në fund të vitit 2017, ekonomia edhe më tutje vazhdon të klasifikohet në kategorinë e vendeve me shkallë të lartë të borxhit, derisa treguesit tjerë tregojnë një huazim të ulët. Megjithatë, duhet theksuar se në strukturën e totalit të borxhit të jashtëm bruto edhe më tutje mbizotërojnë obligimet në bazë të borxhit në mes kompanive (borxh në mes subjekteve të ndërlidhura) dhe në bazë të kredive tregtare, që sinjalizon burime më stabël dhe më pak të lëndueshme të financimit. Analiza e dinamikës së huazimit të jashtëm tregon zhvendosje vjetore të pavolitshme te gati të gjithë treguesit e solventitetit, me përjashtim të treguesit për pjesëmarrje të pagesës së normës së interesit në importin e mallrave dhe shërbimeve dhe të hyra tjera ku shënohet një përkeqësim i butë në bazë vjetore. Përkeqësim i butë vjetorë është shënuar edhe te treguesit e likuiditetit.

Në fund të vitit 2017, borxhi i jashtëm neto, si një tregues shtesë për pozitën e jashtme të ekonomisë, është 2880.8 milionë euro ose 28.6% të PBB. Në krahasim me gjendjen në fund të vitit paraprak, borxhi i jashtëm neto shënon rritje prej 1.6 p.p. të PBB. Borxhi më i lartë i jashtëm neto është pasojë e rritjes së borxhit të jashtëm neto, në kushte të rënies së borxhit neto të sektorit privat.

Tabela 1  
Tregues të stokut të borxhit të jashtëm

	<b>Solventiteti</b>				<b>Likuiditeti</b>		
	Pagesa e interesit / Eksporti i mallrave dhe shërbimeve dhe të hyra tjera	Bruto-Borxh/ Eksporti i mallrave dhe shërbimeve dhe të hyra tjera	Bruto-Borxh/ PBB	Pagesa e borxhit/ Eksporti i mallrave dhe shërbimeve dhe të hyra tjera	Rezervat valutore/ Borxhi afatshkurtër	Rezervat valutore/ Borxhi afatshkurtër, me maturim të mbetur*	Borxhi afat shkurtër/ Gjithsej borxhi
	në %				raport	raport	në %
31.12.2004	2.41	129.3	47.3	12.4	1.14	0.89	30.27
31.12.2005	2.66	147.0	54.2	11.1	1.67	1.04	26.67
31.12.2006	3.44	131.3	49.8	21.7	1.95	1.34	28.98
31.12.2007	2.78	119.3	51.3	19.4	1.35	1.08	39.82
31.12.2008	2.66	116.9	54.1	10.2	1.29	0.95	35.19
31.12.2009	2.43	131.0	57.8	11.8	1.29	0.94	32.86
31.12.2010	3.22	140.4	59.7	13.9	1.49	0.99	27.93
31.12.2011	3.12	148.4	64.6	16.8	1.78	1.18	25.22
31.12.2012	2.92	142.1	67.6	13.1	1.64	1.03	26.66
31.12.2013	2.51	137.3	67.3	15.8	1.64	1.08	23.31
31.12.2014	3.01	149.1	74.0	17.2	1.82	1.13	22.32
31.12.2015	2.68	143.8	73.2	20.0	1.69	1.13	21.32
31.12.2016	2.38	149.9	79.1	14.9	1.65	1.16	21.93
31.12.2017	2.69	140.1	77.0	12.7	1.31	0.89	24.03
<i>Kriteriumet për ngarkesë të moderuar me borxh</i>	<i>12 - 20%</i>	<i>165 - 275%</i>	<i>30 - 50%</i>	<i>18 - 30%</i>	<i>1.00</i>		

\* Kriteri i ngarkesës së moderuar me borxh është matur sipas metodologjisë së Bankës Botërore për përpunimin e treguesve të huazimit, e cila nënkupton shfrytëzimin e proceseve tre vjeçare lëvizëse të PBB dhe eksportit të mallrave dhe shërbimeve si dhe prurjeve tjera si emërues të përbashkët të përlogaritjeve të këtyre treguesve.

Sipas parimeve të Grinspan dhe Gvidoti, e nevojshme është që vendi të ruaj mbulim të plotë të borxhit afatshkurtë (maturimi i pjesës së ngelur) me rezerva valutore.

Burimi: BPRM.


### 3.5. Agregatet monetarë dhe kreditorë

#### 3.5.1. Agregatet monetarë

Edhe pranë prezencës së pasigurisë dhe stanjimit të ekonomisë, stabilizimi gradual i pritjeve në vitin 2017 siguroi rritje të mëtejme të masës monetare dhe të totalit të depozitave në sistemin bankar, por me një intensitet më të butë në krahasim me vitin paraprak. Rritja e monedhizimit në ekonomi është në pajtueshmëri me vazhdimësinë e


zhvendosjeve të volitshme në tregun e punës, si dhe me pozitën relativisht të volitshme të jashtme të ekonomisë në vitin 2017. Gjatë vitit, dinamika e ndryshimit të depozitave nuk ishte e njëtrajtshme. Në pjesën e parë të vitit u shënuar rënie e bazës depozituese, në kushte të rënies së depozitave korporative dhe të zvogëlimit të aktivitetit ekonomik, dhe të masës më të lartë të daljeve monetare në bazë të dividendëve jashtë ekonomisë. Paralelisht me këtë, e matur ishte edhe ritmi i rritjes së kursimit të popullsisë, në kushte të prezencës së pasigurisë politike. Në gjysmën e dytë të vitit, u shënuar shëndetësim i dukshëm i bazës depozituese të bankave, duke reflektuar ambientin më stabil, rritjen e aktivitetit ekonomik, por edhe kreditimin e intensifikuar, që në mënyrë shtesë ndikoi në rritjen e depozitave.

Grafik 54  
Masa monetare M4 dhe totali i depozitave



Burimi: BPRM.

Grafik 55  
Masa monetare M4, pjesëmarrje në PBB




Masa më e madhe monetare, e matur sipas agregatit monetar M4, në vitin 2017 shënoi rritje për 5.3%, rritje kjo me një intensitet diç më të ulët në krahasim me vitin paraprak (6.1%). Megjithatë, participimi i këtij agregati monetar në PBB, vazhdoi të rritet dhe në fund të vitit arriti nivelin prej 59.7%. Shikuar nga aspekti strukturor, rritja e M4, ngjashëm si në tre vitet e fundit, rezultoi nga paratë e depozituara, me gjasë që pjesërisht të ketë rezultuar edhe nga zvogëlimi i të ardhurave nga kursimet. Një kontribut pozitiv dhe dukshëm më të rëndësishëm në krahasim me dy vitet paraprake kanë dhënë depozitat afatgjata. Nga komponentët tjerë të këtij agregati monetar, kontributi i parave të gatshme në qarkullim ishte pozitiv, ndërsa depozitat afatshkurta kishin ndikim të pakonsiderueshëm negativ në ndryshimin e masës monetare. Në përputhshmëri me realizimet, treguesi i pjesëmarrjes së ndryshimit vjetor të masës monetare në relacion me PBB në fund të vitit ishte 3.0% dhe shënoi një ngadalësim të butë në bazë vjetore.

Tabela 2  
Komponentë të masës monetare – gjendje dhe ndryshime

	Gjendja			Ndryshimet vjetore		
	2015	2016	2017	2015	2016	2017
	Në milionë denarë					
Paratë e gatshme nëqarkullim	26.300	28.193	29.968	13,3	7,2	6,3
Paratë në depozitë	74.978	83.156	93.240	20,3	10,9	12,1
<b>M1</b>	101.278	111.349	123.208	18,4	9,9	10,7
Depozitat afatshkurta në denar	53.557	51.592	48.534	-6,3	-3,7	-5,9
Depozitat afatshkurta në valutë të huaja	96.514	103.836	105.864	6,1	7,6	2,0
<b>M2</b>	251.349	266.776	277.607	7,6	6,1	4,1
Depozitat afatgjata në denar	53.518	55.834	61.006	3,6	4,3	9,3
Depozitat afatgjata në valutë të huaja	26.140	28.612	31.269	6,6	9,5	9,3
<b>Gjithsej depozitat*</b>	229.728	239.873	246.674	2,4	4,4	2,8
<b>Gjithsej depozitat</b>	304.706	323.029	339.914	6,3	6,0	5,2
<b>M4</b>	331.007	351.222	369.882	6,8	6,1	5,3

\*pa para depozitare  
Burimi: BPRM.


Grafik 56  
Masa monetare, ndryshim vjetor dhe strukturë



Totali i depozitave në sistemin bankar në vitin 2017 shënuan rritje për 5.4%, rritje kjo pak më e ulët në krahasim me vitin paraprak. Analiza e depozitave nga aspekti sektorial dëshmon se bartës të rritjes janë depozitat e familjeve, derisa kontributi e depozitave të ndërmarrjeve ndonëse pozitiv është shumë më i ulët. Shikuar nga aspekti valutor, totali i rritjes depozitare në vitin 2017 kryesisht rezultoi nga depozitat në denarë (me para depozitare të përfshira), ndërsa rritje, por në shkallë më të ulët kanë shënuar depozitat devizore. Realizimet e tilla e reflektojnë stabilizimin gradual dhe të mëtejme të pritjeve, trende këto të sinjalizuara edhe ndryshimet në aspekt të strukturës maturuese të bazës depozitare, me një kontribut të mëtejme të kontributit të depozitave afatgjata.


Grafik 57

Totali i depozitave (me para depozitare), ndryshim vjetor dhe kontributi në ndryshim shikuar në aspekt sektorial




Grafik 58

Totali i depozitave të familjeve, ndryshimi vjetor dhe kontributi në ndryshim sipas strukturës maturuese dhe valutore



Grafik 59

Totali i depozitave të familjeve, ndryshim vjetor dhe kontribut në strukturën maturuese dhe valutore




Burimi: BPRM.

Depozitat e familjeve<sup>35</sup> në vitin 2017 shënuan rritje prej 6.1%, që paraqet një përshpejtim të konsiderueshëm në krahasim me rritjen e shënuar në vitin paraprak (2.5%), kur nën ndikim të krizës politike erdhi deri në tërheqje të një pjesë të depozitave në gjysmën e parë të vitit. Analizuar nga aspekti strukturor, rritja në masë më të madhe rezulton nga zmadhimi i parave të depozituara dhe nga kursimi afatgjatë. Njëherit, për dallim nga viti paraprak, kur kursimi afatshkurtër shënoi rënie, në vitin 2017 një lëvizje e butë pozitive u shënuar edhe te ky segment. Edhe pranë oscilimeve gjatë vitit, gjatë tërë vitit 2017 u shënuar zhvendosje pozitive edhe në aspekt valutor. Kështu, depozitat në denarë (me para të depozituara) kishin kontribut më të madh në rritjen vjetore të depozitave të familjeve. Depozitet e sektorit korporativ në vitin 2017 shënuan rritje vjetore prej 2,1%, në

<sup>35</sup>Të dhënat mbi depozitat i përfshinë edhe paratë depozituese.

ç'rast shikuar në strukturë, rritja në masë më të madhe mundet ti përshkruhet parave të depozituara, si dhe depozitave afatgjata. Shikuar nga aspekti valutor, paratë e depozituara në suaza të depozitave në denarë në tërësi e sqarojnë rritjen e totalit të depozitave të ndërmarrjeve. Duke pasur parasysh realizimet e kësaj natyre, shkalla e euroizimit, e matur përmes participimit të depozitave me komponentë devizore në totalin e depozitave, në vitin 2017 shënoi një rënie të butë prej 41.1% në 40.4%. Zhvendosje e tillë e këtij treguesi është shënuar edhe te totali i depozitave të familjeve.

Grafik 60  
Shkalla e euroizimit të depozitave



Burimi: BPRM.

### 3.5.2. Aktiviteti kreditues

Edhe në vitin 2017 aktiviteti kreditues i bankave shënoi rritje solide. Shkalla vjetore e rritjes në fund të vitit ishte 5.7%<sup>36</sup>. Rritja e përkrahjes kreditore të ekonomisë ishte refleksion edhe i ofertës së rritur edhe të zmadhimit të kërkesës për kredi. Kështu, në vitin 2017 në kushte të pritjeve më stabël, pozitës së shëndetshme likuide dhe solvente dhe konkurrencës në rritje, bankat vazhduan me lehtësimin e kushteve kredituese, si për sektorin korporativ ashtu edhe për familjet. Rritje të mëtejme shënoi dhe kërkesa për kredi, në veçanti të sektori korporativ, rritja e së cilit u përshpejtua në gjysmën e dytë të vitit. Në një kontekst të tillë, edhe pranë faktit se në rrjedhat e reja kreditore dominonte kreditimi i familjeve, u shënuar edhe rritje e kontributit të kreditimit korporativ.


<sup>36</sup> Më 17.12.2015, Këshilli i Bankës Kombëtare miratoi Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për administrimin e rrezikut të kredisë, sipas të cilit, jo më vonë se 30 qershor, 2016 bankat janë të detyruara të shlyejnë (dhe edhe më tej të vazhdojnë me shlyerjen) të gjitha pretendimet të cilat janë rezervuar plotësisht për më shumë se dy vjet, dmth., në të cilën, të paktën dy vjet më parë, banka ka përcaktuar dhe mbuluar plotësisht rrezikun e kredisë nga mospagesa. Pavarësisht heqjes së këtyre kërkesave, përkatësisht transferimin e tyre në evidencë jashtëbilancore, bankat rezervojnë të drejtën për të mbledhur ato. Efektet nga transferimi i një pjesë të kërkesave të dyshimta dhe diskutabile të bankave në evidencën jashtëbilancore u ndjenë në masë më të madhe në tremujorin e dytë të vitit 2016.

Grafik 61  
Totali i kredive




Burimi: BPRM.

Grafik 62  
Totali i kredive, pjesëmarrje në PBB




Analizuar sipas sektorëve, kontribut më të madh për rritjen e përgjithshme kreditore kishin kreditë e miratuara për sektorin "familje" (kontribut prej 4.2 p.p.), ndërsa kontributi i kredive të ndërmarrjeve ishte më i vogël (1.5 p.p.), kontribut ky më i madh krahasuar me dy vitet paraprake. Me qëllim të përkrahjes së mëtejme të kreditimit të sektorit korporativ, BPRM në fund të vitit 2017 vazhdoi me zbatimin e masës jostandarde të rezerva e detyrueshme<sup>37</sup>. Në përputhshmëri me realizimet, participimi i kredive në PBB në fund të vitit ishte 48.2%. Treguesi i pjesëmarrjes së rritjes vjetore të totalit të kredive në PBB në fund të vitit ishte 2.6 p.p..

Grafik 63  
Totali i kredive, ndryshimi vjetor dhe struktura sektoriale



Burimi: BPRM.


Grafik 64  
Totali i kredive për familjet, ndryshimi vjetor dhe struktura sipas dedikimit



\*Në gjithsej kreditë e popullatës nuk janë inkuorporuar kreditë e personave që realizojnë aktivitetet të pavarura-vetëpunësim.


<sup>37</sup>Me këtë masë pa klauzolë valutore e emituar nga neto eksportuesit dhe prodhuesit vendor të energjisë elektrike mundëson zvogëlimin e bazës së rezervave të detyrueshme të bankave për vlerën e kredive të reja të lejuara të eksportuesve neto dhe prodhuesve vendor të energjisë elektrike dhe për investimet e bankave në letra me vlerë të borxhit me prejardhje vendore. Masa u inkuorporua në fund të vitit 2012 dhe filloi të zbatohet nga viti 2013. Që nga futja e masës, aplikimi i tij u shtri në dy raste, dmth deri në fund të vitit 2017.

**Grafik 65**  
Oferta dhe kërkesa (neto-përqindje)\*



\* Te kushtet e kreditimit, neto-përqindja negative nënkupton lehtësim të kushteve të kreditimit. Të kërkesa, neto-përqindja negative nënkupton ulje të kërkesës.  
Të dhëna më të hollësishme mbi aktivitetin kreditues mundet të gjenden në faqen zyrtare të BPRM.  
Burimi: Anketa mbi aktivitetin kreditues, BPRM.

**Grafik 66**  
Analiza të riskut nga ana e bankave (neto-përqindje)\*



\* Te familjet është paraqitur mesatarja e neto-përqindjeve të faktorëve të riskut të cilat ndikojnë mbi kushtet e kreditimit gjatë miratimit të kredive banesore dhe atyre të konsumit.  
Të dhëna më të hollësishme mbi aktivitetin kreditues mundet të gjenden në faqen zyrtare të BPRM.



## **IV. Mjedisi makroekonomik dhe politika monetare në vitin 2018 dhe 2019<sup>38</sup>**

Në përputhje me dispozitat ligjore, politika monetare e BPRM-së edhe në periudhën e ardhshme do të synojë ruajtjen e stabilitetit të çmimeve, si një objektiv bazë monetar. Për këtë qëllim, BPRM do të vazhdojë të kontribuojë për një sektor bankar të qëndrueshëm dhe konkurrues dhe të mbështesë politikat e përgjithshme ekonomike, pa rrezikuar arritjen e qëllimit kryesor. Në aspekt të strategjisë monetare, BPRM do të vazhdojë me aplikimin e strategjisë së shënjestrimit të një kursi të këmbimit valutor të qëndrueshme nominal të denarit ndaj euros, si një spirancë nominale, në përputhje me karakteristikat e ekonomisë së vendit, si një ekonomi e vogël, e hapur, dhe shumë e varur nga importi. Në kushte të tilla, stabiliteti i kursit të këmbimit valutor kontribuon në ruajtjen e stabilitetit të çmimeve dhe pritjeve të qëndrueshme të inflacionit të subjekteve ekonomike. Korniza operative e politikës monetare, si edhe më parë, do të vendoset në një bazë fleksibile, që do të mundësojë menaxhim efikas me likuiditetin e sistemit bankar dhe për të ruajtur ekuilibrin në tregun e këmbimeve valutore. Kështu, politika monetare do të vazhdojë të kontribuojë në stabilitetin e përgjithshëm makroekonomik, si një faktor kyç në krijimin e një mjedisi të favorshëm për një rritje të qëndrueshme ekonomike.

Domethënë, pritet shterje e rreziqeve të brendshme karakteristike për dy vitet e mëparshme, në lidhje me mjedisin politik të brendshëm, por në prani të mëtejshme të disa rreziqeve të jashtme. Me parashikimet e fundit të BPRM nga tetori 2017, në dy vitet e ardhshme pritet të përshpejtim i rritjes ekonomisë, e ndikuar kryesisht nga eksportet dhe investimet. Pritet që rezervat në valutë të huaj të mbahen në zonën e komfortit, dhe inflacioni do të jetë i moderuar dhe do të lëvizë brenda kufijve të kontrolluar, rreth mesatares historike prej 2%. Duke pritur një mjedis të favorshëm ekonomik, BPRM në periudhën e ardhshme do të vazhdojë të jetë e orientuar drejt ndjekjes së arritjes të objektivave monetare, si dhe rreziqet e mundshme të identifikuar, për shkak të rregullimit në kohë të politikës monetare.

Pavarësisht mjedisit të pritshëm të favorshëm ekonomik globale, pritet që realizimi i kuadrit të projektuar makroekonomik të shoqërohet me rreziqe, të cilat në afat të mesëm janë të lidhura me pasiguri të lartë që rrjedhën nga zbatimi i politikave të reja në SHBA, futjen e mundshme të barrierave tregtare në nivel global, shtrëngimin e mundshëm të kushteve financiare globale, efektet e krijimit të marrëdhënieve të reja midis BE-së dhe Mbretërisë së Bashkuar, si dhe zhvillimet turbulente në skenën gjeopolitike. Realizimi i mundshëm i rreziqeve të përmendura do të nënkuptojë gjithashtu ndryshimin e mjedisit për zbatimin e politikës monetare, krahasuar me pritjet e përfshira në projeksionet aktuale.

Në periudhën e ardhshme pritet rritje graduale dhe e moderuar e normës së inflacionit, e cila, sipas projeksioneve të muajit tetor do të mbahet në nivel prej 2% në vitin 2018 dhe 2019. Për vitin 2018 pritet që rritja e çmimeve të stimulohet kryesisht nga komponenti ushqimor i inflacionit. Disa efekte të moderuara në inflacion priten nga rritja e inflacionit bazë, e cila është e lidhur me një rritje të mëtejshme të kërkesës së brendshme. Në aspekt të çmimeve të energjisë, pritet që ata do të shënojnë rënie, në kushte të stabilizimit të çmimeve të naftës në tregjet botërore, pas rritjes së konsiderueshme në vitin 2017. Kështu, komponenti energjetik i inflacionit do të ketë një kontribut negativ në inflacionin e përgjithshëm në vitin 2018. Për 2019, pritet që inflacioni të mbajë nivelin prej 2%, në kushte të forcimit të mëtejshëm të aktivitetit ekonomik të brendshëm dhe çmimeve

<sup>38</sup> Bazuar në parashikimet e BPRM-së nga tetori 2017.

ushqimore botërore. Pasiguria lidhur me dinamikën e ardhshme të çmimeve të tregut të produkteve primare është një faktor kryesor i rrezikut në drejtim të inflacionit të projektuar, ku veçanërisht e rëndësishme është pasiguria në lidhje me ndryshimet në çmimet e naftës, duke pasur parasysh rritjen e tensioneve gjeopolitike kohëve të fundit dhe ndikimin e tyre të mundshëm mbi ofertën dhe çmimet në nivel global.

Për dy vitet e ardhshme, pritet që përshpejtimi i rritjes ekonomike të vijë nga eksportet dhe investimet. Në kushte të pritjeve të një mjedisi të favorshëm të jashtëm, a parasëgjithash forcimin e aktivitetit ekonomik te partnerët më të rëndësishëm tregtarë të shtetit, pritet rritje e aktivitetit e kompanive të eksportit në zonat e lira ekonomike dhe kthimi i kapaciteteve tradicionale të eksportit. Gjithashtu, pritet që rimëkëmbja e kërkesës së huaj efektive dhe rritja e çmimeve të metaleve do të ketë një ndikim pozitiv në kompanitë e eksportit të brendshme në industrinë e metaleve. Përveç kërkesës për eksport, bartës të rritjes do të ishin edhe kërkesa personale edhe kërkesa për investime. Gjegjësisht, dy vitet e lartpërmendura, pritet rimëkëmbje e aktivitetit të investimit të brendshëm, në përputhje me stabilizimin e situatës politike në vend dhe pritshmëritë për prirje më të madhe të investimeve të sektorit privat. Lëvizje të tilla do të kishin një efekt pozitiv edhe në tregun e punës, gjë që do të kontribuonte gjithashtu në rritjen e konsumit personal. Për mbështetje të mëtejshme të kërkesës së brendshme do të kontribuonte edhe rritja e aktivitetit të kredisë. Në kushte të tilla, pritet një rritje e PBB-së prej 3.2% në vitin 2018 dhe një rritje shtesë prej 3.5% në vitin 2019.

Në kushtet e likuiditetit të dhe aftësinë paguese të bankave solide, mjedis më të qëndrueshëm dhe më të sigurt të brendshme, pritet që rritja e potencialit të depozitave të bankave dhe masat e marra nga autoritetet monetare do të kontribuojnë për mbështetje më të madhe financiare për ekonominë e vendit përmes sektorit bankar. Rritja e parashikuar e totalit të kredive në vitin 2018 dhe 2019 prej rreth 7% do të mbështesë rritjen e investimeve dhe konsumit të brendshëm, me mbështetje më të madhe të kredisë për ekonominë familjare dhe sektorin e korporatës. Vlerësohet se rritja e të ardhurave të disponueshme dhe perceptimet më pozitive të rrezikut do të mbështesin më tej kërkesën për kredi. Gjithashtu, supozohet një rritje e potencialit dhe prirjes për kursim në banka, dhe kështu edhe përshpejtim në rritjen e bazës së depozitave për të arritur rreth 6.0% në vitin 2018 dhe 2019. Rreziqet në rënie rreth parashikimit të rritjes së kredisë dhe depozitave janë mundësitë për rimëkëmbje më të dobët ekonomike se sa pritjet, si dhe pasiguria e vazhdueshme rreth faktorëve të rrezikut të brendshëm, që mund të çojë në një prirje më të ulët për të kursyer, kufizim të burimeve të financimit për bankat, përkeqësim i perceptimeve për rrezikun dhe gatishmëri më e dobët për të huazuar të sektorit privat.

Projeksionet për vitin 2018 dhe 2019 tregojnë një pozicion të jashtëm që siguron mirëmbajtjen e mëtejshme të rezervave në valutë të huaj në nivelin e duhur. Pritet që deficitin i llogarisë rrjedhëse të jetë relativisht më i ulët dhe do të jetë mesatarisht rreth 1.8% e PBB-së. Për më tepër, në bilancin e mallrave dhe shërbimeve pritet ngushtim i moderuar i deficitit për shkak të përmirësimit të shkëmbimit të e shërbimeve, duke mos ndryshuar bilancin nga shkëmbimi i mallrave. Teprica e të ardhurave dytësore nuk priten ndryshime të rëndësishme, ndërsa tek deficitin i të ardhurave primare, pritet zgjerim në të dy vitet, si rezultat i vlerësimeve për rritjen e mëtejshme të fitimit të kompanive që janë në pronësi të huaj. Deficitin i llogarisë rrjedhëse, edhe në të ardhmen, do të financohen përmes flukseve financiare në formën e investimeve të huaja direkte dhe përmes huamarrjes nga sektori publik, të cilat do të sigurojnë rritjen e mëtejshme të rezervave në valutë të huaj dhe mirëmbajtjen e tyre në zonën e sigurt. Rreziqet kryesore rreth pozitës së jashtme të ekonomisë në periudhën e ardhshme vazhdojnë të lindin nga dinamika e rimëkëmbjes globale, lëvizjes së çmimeve botërore dhe mjedisit politik të brendshëm.

Në dy vitet e ardhshme pritet që politika e kujdesshme fiskale të vazhdojë, me konsolidimin e mëtejshëm të deficitit buxhetor dhe një nivel relativisht të qëndrueshëm të borxhit publik<sup>39</sup>. Politika fiskale është një faktor i rëndësishëm që ndikon në politikën monetare, dhe koordinimi e duhur i këtyre politikave është një faktor kyç në arritjen e qëndrueshmërisë së pozicionit të jashtëm të vendit dhe ruajtjen e stabilitetit makroekonomik. Investimet publike mbeten edhe mëtej një objektivi prioritar i politikës fiskale. Deficiti buxhetor do të financohet në kombinim, edhe nga burimet e brendshme, përmes emetimit të letrave me vlerë të qeverisë, si dhe nga burimet e jashtme, me çka depozitat qeveritare në BPRM do të ishin rritur. Korniza fiskale e përcaktuar në këtë mënyrë parashikon një rritje të moderuar të borxhit publik në periudhën e ardhshme, gjë që nuk do të rrezikojë qëndrueshmërinë e financave publike. Politika fiskale e përcaktuar është e shoqëruar me rreziqe, të cilat, si edhe me politikën monetare, rezultojnë nga ambienti i brendshëm, por edhe nga mjedisi i jashtëm dhe ndikimi i tyre në aktivitetin ekonomik të brendshëm, si dhe aftësinë për të hyrë në tregjet e huaja financiare.

Si edhe më parë, BPRM-ja edhe mëtej do të monitorojë rregullisht lëvizjet në ekonomi dhe realizimin e rreziqeve të identifikuar dhe në përputhje me këtë, do të vlerësojë dhe rregullojë strukturën e politikës monetare.

---

<sup>39</sup>Konstatimet në pjesën e politikës fiskale janë realizuar në bazë të Buxhetit për vitin 2018 dhe Strategjisë Fiskale të Republikës së Maqedonisë 2018-2020.

## V. Instrumentet monetare

***Mjedisi në të cilin u zbatua politika monetare në vitin 2017 ishte relativisht e favorshme, por edhe me sfida që kryesisht buronin nga pasiguria rreth situatës politike në vend. Këto rrethana kanë krijuar një nevojë për kujdes në zbatimin e politikës monetare, por edhe shkallëzueshmërinë e instrumenteve monetare, për menaxhimin efikas të likuiditetit të sektorit bankar, mbështetje të mëtejshëm të aktivitetit të kreditimit dhe forcimin e bazës së depozitave të bankave. Për më tepër, në fillim të vitit u ul norma bazë e interesit të BPRM në nivel prej 3.25%, e cila është aplikuar më parë në maj të vitit 2016. Ky ndryshim ishte reflektim i stabilizimit gradual të pritjeve të popullsisë të dukshme nga mungesa e trendëve negative të bazës së depozitave të bankave, si dhe zhvillimet e favorshme në tregun e këmbimit valutor. Një sfidë shtesë për zbatimin e politikës monetare ishte menaxhimi i suficitit strukturor të likuiditetit në sistemin bankar. Në rrethana të tilla, BPRM-ja në mënyrë aktive e përshtati shumën e instrumentit bazë në përputhje me ndryshimet në potencialin e likuiditetit të bankave, duke krijuar një bazë për udhëheqjen e fondeve të tepërta në sektorin privat.***

Në vitin 2017, politika monetare është zbatuar në një mjedis i cili është karakterizuar me stabilitet në bazat e ekonomisë së vendit, përmirësimin e mëtejshëm gradual në pritjet e agjentëve ekonomikë dhe pozicionin kryesisht të lartë të likuiditetit të bankave. Sinjalet për optimizëm të rritur të publikut kryesisht erdhën nga tregu i këmbimit valutor, ku oferta vazhdimisht më e lartë e valutës së huaj nga personat fizik dhe këmbimoret udhëzonte drejt reduktimit të mëtejshëm të prirjes së popullsisë për të pasur në dispozicion valuta të huaja dhe shterimin e efekteve nga goditja në prill/maj të vitit 2016, të kushtëzuar nga paqëndrueshmëria politike. Rrethana të tilla, të cilat ishin të shoqëruara nga ndërhyrjet e BPRM-së në tregun e këmbimit valutor për blerjen e valutës së huaj të tepërt nga bankat në gjysmën e dytë të vitit 2016, mundësuan vazhdimin e ciklit të normalizimit të politikës monetare në fillim të vitit 2017, e cila filloi në dhjetor të vitit 2016. Kështu, në tremujorin e parë të vitit 2017, BPRM-ja e ka ulur dy herë normën e interesit për bonot e thesarit për një total prej 0.50 pikë përqindjeje, nga 3.75% në 3,25%<sup>40</sup>. Këto ndryshime kanë kontribuar në normalizimin e normës bazë të interesit në nivelin e para majit të vitit 2016. Deri në fund të vitit, norma e interesit në bono ishte në nivel të pandryshuar, për të cilat u vlerësua se kontribuon në menaxhimin efikas të likuiditetit dhe realizim të objektivave të politikës monetare, pa rrezikuar lëvizjet në e tregut të këmbimit valutor dhe stabilitetin e kursit të këmbimit. Si rezultat i rënies së normave të interesit për bonot e thesarit, zbatohet një normë më e ulët e interesit edhe në ankandet repo për krijimin e likuiditetit<sup>41</sup> dhe në kreditë në dispozicion njëditore<sup>42</sup>. Normat e interesit për depozitat njëditore të disponueshme dhe maturitetin shtatë ditor<sup>43</sup> u mbajtën në nivel të ulët prej 0.25% dhe 0.5% respektivisht.


<sup>40</sup>Në ankandet e bonove të thesarit, të cilat u mbajtën në ditën e parë të periudhës së rezervës së detyrueshme, u aplikua një tender me shumë (shumë e kufizuar e ofertës dhe norma fikse e përcaktuar e interesit).

<sup>41</sup>Ankandet për sigurimin e likuiditetit për shtatë ditë kryhen një herë në javë, domethënë çdo të premte. Norma e interesit e këtij instrumenti është e barabartë me normën e interesit të bonove të thesarit.


<sup>42</sup> Norma e interesit për kreditë në dispozicion njëditore është më e lartë për 0.5 pikë përqindjeje krahasuar me normën e interesit të bonove të thesarit.

<sup>43</sup>Depozitat e disponueshme njëditore janë në dispozicion të bankave çdo ditë, dhe mundësi për të vendosur aktivet likuide në depozita me afat maturimi prej shtatë ditësh bankat kanë çdo të mërkurë.


Grafik 67  
Korridori i normave të interesit



Grafik 68  
Bonot e thesarit dhe potenciali i likuiditetit të bankave para ankandeve të rregullta mujore të bonove të thesarit<sup>44</sup>




Grafik 69  
Rrjedha e likuiditetit nga faktorë të pavarur



\* FTA – Faktorë të tjerë autonom.  
Burimi: BPRM.

Grafik 70  
Gjendja e instrumenteve monetare për tërheqjen e likuiditetit në denarë



**Në zbatimin e politikës monetare, në vitin 2017 BPRM ka menaxhuar në mënyrë aktive me tepriçën strukturore të likuiditetit, nëpërmjet përshtatjes së shumës së ofruar të bonove të thesarit<sup>45</sup>.** Kështu, menjëherë pas rritjes relativisht të lartë të tepriçës së mjeteve likuide në denarë të bankave në fund të vitit 2016, që rezultoi nga ndërhyrjet e BPRM për blerjen e valutës së huaj, në janar bonot e thesarit janë rritur për 2.000 milionë denarë, duke arritur në 25,000 milionë denarë. Trendi rritës i burimeve të lira të bankave vazhdoi edhe në tremujorin e parë të vitit 2017, për çka kontribuoi kërkesa më e ulët sezonale e popullsisë për para të gatshme në denarë. Për shkak të këtyre ndryshimeve, gjatë kërkesës së kufizuar të instrumenteve financiare afatgjata të brendshme dhe kërkesë të ulët të kredive në sektorin privat, bankat kanë zhvendosur fondet e tyre të tepërta për të depozituar në BPRM, kryesisht në depozitat e disponueshme me afat maturimi prej shtatë ditësh. Depozitat e disponueshme shtatë-ditore, aplikimi i së cilave është për shkak të neutralizimit të luhatjeve afatshkurtra të likuiditetit në sistemin bankar, në fillim të

<sup>44</sup> Potenciali i likuiditetit të bankave i referohet ditës së parë të periudhës së rezervës së detyrueshme kur mbahet ankand i bonove të thesarit dhe përfaqëson shumën totale të fondeve në llogaritë e rregullta të bankave në Bankën Popullore, shumën e detyrimit të bonove të thesarit dhe depozitat në dispozicion në BPRM dhe kërkesat nga tregu i parasë, të zvogëluara për detyrimet e tregut të parasë dhe shumën e rezervës së detyrueshme për periudhën e ardhshme.

<sup>45</sup> Për shkak të mbështetjes së mëtejshme të procesit afatgjatë të denarizimit të detyrimeve të bankave, sasia e ofruar e bonove të thesarit është alokuar sipas pjesëmarrjes individuale të bankave në totalin e detyrimeve në valutën vendase pa klauzolë valutore. Në shumicën e ankandeve, të gjitha bankat kishin kërkesë ë nivel të shumës së ofruar, e cila konfirmon përshtatjen e duhur të ofertës në përputhje me potencialin e likuiditetit të bankave.

vitit 2017 kanë arritur nivelin më të lartë në dy vitet e fundit (rreth 14,100 milionë denarë). Duke pasur parasysh se këto lëvizje ishin të pranishme disa muaj radhazi, në mars të vitit 2017 BPRM përsëri e rriti ofertën e bonove të thesarit për 5,000 milionë denarë, në nivelin prej 30,000 milionë denarë. Ky ndryshim ka mundësuar nëpërmjet instrumentit kryesor monetarë të tërhiqet pjesë nga fondet e tepërta e cila mori karakterin e tepricës strukturor të likuiditetit, ashtu që përfaqësimi i bonove në potencialin e likuiditetit të bankave është mbajtur rreth mesatares pesë-vjeçare (75%).

Në fillim të gjysmës së dytë të vitit, BPRM dy herë e rregulloi shumën në zvogëlim të bonove të thesarit për gjithsej 5,000 milionë denarë, që ishte ekuivalente me reduktimin e potencialit të likuiditetit të bankave në qershor dhe korrik. Dinamika rënëse e likuiditetit të bankave në këtë periudhë ishte rezultat i financimit të sforcuar të qeverisë për tregun e brendshëm, si dhe ndërhyrjet e BPRM për të siguruar valutë të huaj për bankat, për të plotësuar kërkesën sezonale më të lartë nga kompanitë për operacionet e rregullta, pagesat e dividendëve për personat juridikë në një pronësi kryesisht të huaj dhe shlyerje e borxhit të sektorit privat për jashtë vendit (shtojca Tregu i këmbimit valutor). Gjithashtu, duke përshtatur ofertën e bonove të thesarit u mundësua stabilizimi i fondeve të tepërta afatshkurtër të vendosura në depozita shtatë-ditore në nivel prej rreth 8,000 milionë denarë, që është vlerësuar si një bazë e fortë për mbështetjen e kredisë për sektorin privat dhe për të kapërcyer ndryshimet afat-shkurtër në likuiditet. Në periudhën e mbetur, tendencat relativisht të favorshme në tregun e këmbimeve valutore, të cila mundësuan blerje të rregullt dhe relativisht të lartë të tepricës të tregut të valutës së huaj nga ana e BPRM (gjithsej 110.4 milionë euro në periudhën nga gushti deri në dhjetor), në njërin anë dhe tërheqje e fondeve nga qeveria që janë të lidhura me rritjen e huamarrjes në tregun e brendshëm, në anën tjetër, kanë kontribuar në stabilizimin e fondeve të lira në llogaritë e bankave në BPRM. Në rrethana të tilla, banka qendrore e ka ruajtur gjendjen e bonove të thesarit në nivelin e 25,000 milionë denarë, ndërsa fondet afat-shkurtër të tepërta të cilat bankat i kanë investuar në depozita shtatë-ditore ishte rreth 8,500 milionë denarë<sup>46</sup>.

---


<sup>46</sup>Në fund të vitit, për shkak të rritjes së fortë të aseteve në llogaritë e bankave të shkaktuara nga shpenzimet më të larta të shtetit dhe ndërhyrjet e BPRM në tregun e këmbimeve valutore, shuma e depozitave shtatë-ditore arriti në 9,897 milion denarë.

## Shtojca 1. Zhvillimet në tregun e këmbimit valutor dhe ndërhyrjet e BPRM-së

Në vitin 2017, tregu i këmbimit valutor<sup>47</sup> akoma mbeti segmenti më i rëndësishëm i tregjeve financiare vendase, meqë qarkullimi i përgjithshëm arriti në 8,449 milionë euro, ose 84% e PBB-së. Lëvizjet në tregun e këmbimit valutor në Republikën e Maqedonisë, edhe pse udhëzon për stabilizim të pritjeve të popullatës, janë karakterizuar edhe me rritjen e kërkesës për valutë të huaj nga sektori privat i korporatave, andaj në transaksionet me të gjithë klientët bankat shitën 360 milionë euro në bazë-neto ose më shumë për 84 milionë euro në bazë vjetore. Në këtë mënyrë, bankat në transaksionet me persona fizik dhe këmbimoret në vitin 2017 në mënyrë të vazhdueshme realizuan blerje-neto të valutës së huaj, që arriti 1,094 milionë euro dhe ishte më e lartë për 106 milionë euro në krahasim me vitin 2016. Ky trend është theksuar veçanërisht në gjysmën e dytë të vitit, duke treguar vazhdimisht stabilizim të pritjeve të personave fizik dhe reduktim të pasigurisë lidhur me situatën politike në vend. Hyrjet e likuiditetit të këmbimit valutor të bankave nga transaksionet me këta klientë u përdorën kryesisht për të plotësuar kërkesën më të lartë për valutë të huaj nga kompanitë dhe jorezidentët. Në transaksionet me kompanitë, bankat në vitin 2017 në bazë neto kanë shitur sasi relativisht të lartë të valutës së huaj (rritje për 166 milionë euro në baza vjetore), e cila ishte rezultat i rritjes më të fortë të kërkesës në raport me rritjen e ofertës së valutës së huaj. Në anën e ofertës së valutës së huaj, efekti i pafavorshëm i stagnimit të investimeve në projektet e infrastrukturës është kapërcyer tërësisht nga rritja e ofertës nga ana e kompanive të reja të veprimtarisë prodhuese të automjeteve dhe pajisjeve për automjete dhe tregtisë me kompjuterë dhe teknologjisë kompjuterike, që i referohet efektit pozitiv të ndryshimeve strukturore në ekonominë vendase të tregut të këmbimit valutor. Nga ana tjetër, rritja e kërkesës për valutë të huaj pavarësisht nga kompanitë për prodhimin dhe tregtimin e ushqimit dhe pijeve për blerjen e naftës dhe të derivateve të naftës, të cilat janë më të përfaqësuara në strukturën e importeve të mallrave, erdhi edhe nga sektori i energjisë dhe i telekomunikacionit. Kërkesa më e lartë për valutë të huaj nga këto dy sektorë, si dhe nga jorezidentët lidhet me shlyerjen e borxhit të sektorit privat jashtë vendit dhe pagesat e dividendëve për kompanitë-mëmë të huaja, që si një trend është zakonisht karakteristike nga mesi i vitit. Bankat e kompensuan kërkesën më të lartë për valutë të huaj në këtë periudhë të vitit, përveç fondeve të veta dhe përmes tregtimit në valutë të huaj në tregun ndërbankar, dhe nga BPRM, e cila në tremujorin e dytë të vitit ndërhyri duke shitur valutë të huaj bankave mbështetëse. Në periudhën e mbetur të vitit, zhvillimet relativisht të favorshme në tregun e këmbimit valutor kanë mundësuar praninë e vazhdueshme të BPRM-së në këtë segment të tregut me ndërhyrjet për blerjen e likuiditetit të tepërt në valutë të huaj të bankave. Prandaj, pavarësisht nga pagesat relativisht të larta vjetore të sektorit privat jashtë vendit, BPRM në tregun e këmbimit valutor në bazë neto në vitin 2017 bleu shumën më të lartë të valutës së huaj (65.5 milionë euro) në pesë vitet e fundit. Gjatë vitit, bankat aktivisht tregtuan edhe në tregun ndërbankar të këmbimit valutor, ku vazhdoi tregtia më e fortë. Për sa i përket strukturës së tregtimit ndërbankar, për vitin 2017 është karakteristike rritja më tej e tregtisë në mes bankave mbështetëse dhe bankave të tjera, që tregon thellimin e rolit të bankave mbështetëse në këtë segment të tregut.


Grafik 71

Ndryshimet vjetore në ofertën neto të valutës së huaj me klientët individual




Grafik 72

Oferta e këmbimit valutor në tregun e këmbimit




<sup>47</sup> Tregu i këmbimit valutor në kuadër të kësaj analize i përfshinë transaksionet ndërmjet bankave dhe klientëve të tyre, tregtinë ndërbankare, si dhe transaksionet midis BPRM-së dhe bankave mbështetëse.

**Grafik 73**  
Ndërhyrjet e BPRM-së në tregun e këmbimit valutor



Burimi: BPRM

**Grafik 74**  
Qarkullimi në tregun ndërbankar të këmbimit valutor, sipas segmenteve



**Menjëherë pas plotësimit të kërkesës për likuiditet në tregjet e parash, bankat vendosën pjesë të mjeteve të tepërta afat-shkurtër mbi rezervën e detyrueshme dhe në depozitat e disponueshme njëditore.** Një sasi e konsiderueshme e këtij instrumenti, gjendja e përditshme e të cilit mesatarisht është mbajtur në nivel relativisht të qëndrueshëm (rreth 1,100 milionë denarë), edhe mëtej është përdorur në fund të periudhave të rezervave të detyrueshme, të gjitha në mënyrë që të sjellë fondet mesatare të tepërta mbi rezervën e detyrueshme në një nivel minimal.

**Gjatë vitit 2017, duke pasur parasysh pozicionin e fortë të likuiditetit, bankat nuk kanë përdorur mjete nga BPRM nëpërmjet kredive njëditore në dispozicion dhe operacioneve repo për krijimin e likuiditetit në sistemin bankar.**

**Për të arritur qëllimet e politikës monetare, në menaxhimin e likuiditetit, autoriteti monetar edhe në vitin 2017 ka përdorur rezervën e detyrueshme.** Banka qendrore nuk bëri ndryshime në normat dhe bazën e rezervës së detyrueshme<sup>48</sup>, kështu që ky instrument, përveç funksionit themelor - menaxhimin e ofertës së parave, vazhdoi të ketë karakter makroprudente. Gjegjësisht, aplikimi i normave të diferencuara të rezervës së detyrueshme në aspekt të valutës dhe maturimit ishin baza të forta për vazhdimin e procesit të denarizimit dhe kursimeve afatgjata, ndërsa masat jo-standarde për të stimuluar aktivitetet e kreditimit të sektorëve me rëndësi sistemore ishte mbështetja për kreditimin e sektorit të korporatave.

Stabilizimi gradual i pritjeve të agentëve ekonomikë, kombinuar me aplikimin e normave më të ulëta të rezervës së detyrueshme për depozitat në denarë në vitet e fundit, ndikoi në mënyrë të favorshme në strukturën valutore të detyrimeve të bankave, ku përfaqësimi i depozitave në denarë në totalit të detyrimeve në fund të vitit arriti një nivel që ishte karakteristik para majit të vitit 2016<sup>49</sup>. Ndryshime të tilla kryesisht ishin të udhëhequra nga ekonomitë familjare, veçanërisht në gjysmën e dytë të vitit, të cilat kishin një prirje më të lartë për të kursyer në monedhën vendase krahasuar me kursimet në valutë të huaj. Nga ana tjetër, sektori i korporatave, i cili në vitin e kaluar kryesoi rritjen e detyrimeve edhe në denarë edhe në valutë të huaj, në vitin 2017 për shkak të shlyerjeve të borxhit jashtë vendit, ka pasur një kontribut modest në rritjen e detyrimeve të bankave (për më shumë

<sup>48</sup>Në shtator të vitit 2017 për përmbushjen e rezervës së detyrueshme në denarë u përfshinë edhe mjetet e bankave në fondin e garancisë së rezervës. Ky ndryshim është aplikuar menjëherë pas formimit të një fondi garancie rezervë si një bazë për përmbushjen e obligimeve në sistemin e pagesave KIBS (nga ana e shtëpisë klerimit "Sistemet Ndërbankar të Klerimit" SHA Shkup), objektivi i të cilit është zbatimi i duhur i Parimeve ndërkombëtare për infrastrukturën e tregjeve financiare, të cilat parashikojnë nevojën për sistemet e pagesave të mbajnë burime të mjaftueshme likuide për shlyerjen e detyrimeve të pagesës.

<sup>49</sup> Analiza e trendeve të detyrimeve të bankave bazohet në të dhënat mbi detyrimet e bankave të përfshira në bazën e llogaritjes së rezervës së detyrueshme.




detaje për ndryshimet në bazën e depozitave të bankave në pjesën për agregatet monetarë). Gjatë vitit 2017 BPRM përgatiti një Draft strategji për deeuroizim, e cila përfshin marrjen më shumë masave dhe përfshirjen e institucioneve të ndryshme, me qëllim të uljes së mëtejshme të euroizimit në ekonomi.

**Në vitin 2017, BPRM ka vazhduar zbatimin e rezervës së detyrueshme për të stimuluar mbështetjen për kredi të bankave për sektorët me rëndësi sistemore<sup>50</sup>.** Në periudhën e analizuar, përmbajtja nga kreditimi i sektorit të korporatave, lidhur me vëzhgimet e mëtejshme të bankave për rrezikun në këtë segment, në mënyrë të përshtatshme u reflektua me ngadalësimin edhe të mbështetjes për kreditin të neto-eksportuesve. Megjithatë, përkundër trendëve të tilla, masa jo standarde, për të dytin vit radhazi, kishte një efekt stimulues duke kontribuar në rritjen e mbështetjes së kreditit të prodhuesve të energjisë elektrike. Duke marrë parasysh efektet që masa i ka në kreditimin e përgjithshëm në sektorin e korporatës gjatë gjithë periudhës së aplikimit (nga viti 2013), si dhe për të ruajtur një sinjal pozitiv për sistemin bankar për mbështetje të kredisë të mëtejshme për sektorët me rëndësi sistemore, BPRM në fund të vitit 2017 e vazhdoi afatin e saj edhe për dy vite të tjera.

Efekti i kombinuar i ndryshimeve në detyrimet në denarë dhe në valutë të huaj të bankave dhe zbatimi i masave jo-standarde kontribuoi në rritjen vjetore të rezervës së detyrueshme për 1,433 milionë denarë, në nivelin prej 19,840 milionë denarë. Rritja e më e fortë e detyrimeve në valutën vendase, kryesisht obligimet afatshkurtra për ekonomitë familjare, kishte kontributin më të madh drejt rezervës së detyrueshme më të lartë në denarë (me efekt prej rreth 1,245 milionë denarë), ndërsa rritja e detyrimeve në valutë të huaj në vitin 2017 ka pasur ndikim minimal në ndryshimin e rezervës së detyrueshme në denarë<sup>51</sup>. Rritja relativisht më e ulët e detyrimeve në valutë të huaj të bankave ka kontribuar në rritjen e ngadalshme të rezervave të detyrueshme në euro, e cila në vitin 2017 ishte më e lartë për 769 milionë denarë (në kundërvlerë), ashtu që në fund të vitit arriti në 14,080 milionë.


Grafik 75

Kontributi në rritjen vjetore të depozitave nga pikëpamja e valutës



Grafik 76


Kontributi në rritjen vjetore të detyrimeve në denarë të bankave, nga baza për rezervën e detyrueshme



<sup>50</sup> Ajo i referohet neto-eksportuesve dhe prodhuesve vendas të energjisë elektrike.


<sup>51</sup> 30% e shumës së rezervës së detyrueshme të përcaktuar në bazë të detyrimeve të bankave në valutë të huaj banlat e plotësojnë në denarë.

Grafik 77  
Faktorët e ndryshimit në rezervën e detyrueshme në denarë



\*Efekti i masave monetare i referohet efektit të ndryshimit të normave për përcaktimin e rezervës së detyrueshme dhe zbatimit të masave jo-standarde.  
Burimi: BPRM.

Grafik 78  
Efekti i përmblodhur i masave jo-standarde mbi rezervën e detyrueshme




## Shtojca 2. Zhvillimet në tregun e parasë<sup>52</sup>

Në vitin 2017, veprimtaria tregtare e bankave në tregjet e parasë, pavarësisht rënies së lehtë (për rreth 5% në bazë vjetore), është mbajtur në nivel të lartë vjetor (58,838 milionë denarë), e cila megjithatë ka një pjesë relativisht të ulët në PBB prej vetëm 9,5%. Për dallim nga viti i kaluar, kur rritja ishte kryesisht rezultat i nevojës për të kompensuar mungesën e likuiditetit gjatë periudhës së goditjes nga kriza politike, në vitin 2017 qarkullimi i këtij tregu është i lidhur parasëgjithash me nevojën për të kompensuar nevojat e përkohshme, afatshkurtër të likuiditetit të bankave. Rritja e aktivitetit tregtar të këtij segmenti ishte veçanërisht karakteristike nga mesi i vitit, kur faktorët autonome kontribuan për tërheqjen e mjeteve likuide nga sistemi bankar.


Tregu ndërbankar për depozitat e pasiguruara tradicionalisht mbetet motori më i madh i qarkullimit në tregjet e parasë, me pjesëmarrje për 45,872 milionë denarë, ose 78% të qarkullimit gjithsej. Sipas maturimeve të veçanta, në vitin 2017 bankat pjesë më të madhe të mjeteve të nevojshme i siguronin përmes blerjes së depozitave me afat maturimi deri në një javë, të cilat përbënin 52% të qarkullimit gjithsej dhe për herë të parë e kanë tejkaluar shumën e huave me afat maturimi njëditorë (përfaqësimi i të cilit në 9 vitet e kaluara ishte më e lartë për rreth 75% në tregtinë totale). Tregtimi i rritur me depozita ndërbankare të pasiguruara në vitin 2017 sugjeron në besimin e mëtejshëm relativisht të lartë në mes bankave, ndërsa një kontribut të rëndësishëm në ndryshimin e strukturës së maturimit të transaksioneve në këtë segment kishin edhe përpjekjet e bankave për të zvogëluar shpenzimet që lidhen me realizimin e transaksioneve të përditshme në këtë segment. Në strukturën e tregtimit në këtë segment të tregut, bankat e mesme mbizotëruan në anën e kërkesës për likuiditet, i cili kryesisht ishte i shërbyer nga bankat e mëdha dhe të vogla, duke ndikuar pozitivisht në përqendrimin e tregut, që u reduktua në nivelin historikisht më të ulët.

<sup>52</sup>Analiza e tregut të parasë në Maqedoni i referohet segmenteve në vijim: tregu i depozitave të pasiguruara, tregun sekondar të letrave me vlerë afatshkurtër dhe letrave me vlerë afatgjatë të qeverisë (me përjashtim të obligacioneve strukturore), tregun e depozitave të siguruara (tregu-repo).


**Grafik 79**  
Qarkullimi i tregut të parasë



**Grafik 80**  
Qarkullimi në tregun ndërbankar të depozitave të pasiguruara




**Grafik 81**  
Përqendrimi i tregut në tregun ndërbankar\*



\* Top 3 i referohet shumës së pjesëmarrjes së tre bankave më të përfaqësuara në anën e ofertës/kërkesës për depozita.  
Burimi: BPRM

**Grafik 82**  
Qarkullimi në tregun sekondar



Bankat ofruan një pjesë të mjeteve të nevojshme likuide edhe në tregun sekondar, nëpërmjet shitblerjes së letrave me vlerë. Qarkullimi i këtij segmenti të tregut në vitin 2017 ka vazhduar prirjen rritëse, duke regjistruar një rritje prej 22.3%, të udhëhequr kryesisht nga repo-transaksionet ndërbankare me letrat me vlerë, që parasëgjithash shpjegohet nga nevoja për të kompensuar mungesat e përkohshme të likuiditetit me kosto më të ulët. Tregtia e bonove të thesarit ishte gjithashtu relativisht e lartë (me 45.8% në qarkullimin e tregut sekondar). Edhe pse me volumin të reduktuar (rënie për 12.3% në bazë vjetore), tregtimi me këto letra me vlerë shpjegohet me faktin se bankat në ankandet e bonove të thesarit kanë marrë pjesë me shumatat maksimale të përcaktuara, dhe më vonë në periudhën e rezervës së detyrueshme janë financuar nëpërmjet shitjes përfundimtare të bonove të thesarit bankave tjera. Sa i përket tregtimit të letrave me vlerë të qeverisë, në vitin 2017 ka vazhduar trendi i zgjatjes së maturimit mesatar të letrave me vlerë të qeverisë të emetuara dhe diversifikimi i strukturës së pronësisë kontribuoi në ndryshime në strukturën e tregtimit në këto letra me vlerë. Këto ndryshime u reflektuan edhe në tregtimin në tregun sekondar të letrave me vlerë, që vërehet nga vëllimi më i ulët i tregtimit të bonove të thesarit në gjashtë vitet e fundit, duke forcuar njëkohësisht tregtimin e obligacioneve të qeverisë, e cila arriti nivelin historikisht më të lartë (1.396 milionë denarë).

## VI. Menaxhimi dhe investimi i rezervave valutore

*Në kushte të mjedisit të pafavorshëm dhe të ndryshueshmërisë së lartë në tregjet financiare ndërkombëtare, BPRM edhe gjatë vitit 2017 u përball me sfida në menaxhimin dhe investimin e rezervave valutore të Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejshëm: rezerva valutore). Gjegjësisht, kthimet e obligacioneve të qeverisë shënuan rritje, në kushte të rritjes së normave të interesit nga ana e FED-it dhe perceptimin e përforcuar për mundësinë e shtrëngimit monetar edhe nga ana e BQE. Gjithashtu, në kushte të rrezikut politik të reduktuar dhe forcimit të ekonomisë në eurozonë, euro-ja shënoi mbivlerësim ndaj dollarit amerikan. Për më tepër, gjatë gjysmës së dytë të vitit, perceptimet e investitorëve për hapin e ardhshëm të BQE-së si një bankë qendrore që do të përfundojë me stimulimin monetar deri në fund të vitit 2018 shkaktoi një ndryshueshmëri më të fortë në tregjet financiare ndërkombëtare, në krahasim me pritjet për rritje të mëtejshme në normat e interesit të FED-it. Në rrethana të tilla, korniza për investime të rezervave valutore u zgjerua me mundësi të tjera për investime që mundësojnë kthime pozitive dhe nivel të pranueshëm të kredisë dhe riskut të tregut. Të gjitha vendimet e investimeve gjatë vitit janë bërë në përputhje me objektivat themelore të investimeve për ruajtje të sigurisë dhe likuiditetit të rezervave valutore.*

### 6.1. Drejtimit themelore të menaxhimit me rezervat valutore

Alokimi taktik për vitin 2017<sup>53</sup> është bazuar në pritjet për rritjen e mëtejshme të normës së interesit të referencës nga FED, si dhe paralajmërimeve për normalizimin gradual të politikës monetare të BQE. Këto supozime udhëzojnë për një rritje të gjasës për një rënie të mëtejshme të vlerës së tregut të investimeve në instrumente financiare me të ardhura fikse në të dy valutat, për shkak të pritjeve për të rritur kthimet. Duke i pasur parasysh pritjet për të njëjtin drejtim të politikës monetare të dy bankave qendrore më me ndikim, është projektuar dhe raport relativisht i qëndrueshëm i EUR/Dollar amerikan. Këto kushtet e tregut kanë kufizuar mundësitë e investimeve në instrumentet e denominuara në euro, në raport me mundësitë e investimeve në dollarë amerikanë. Si pasojë, struktura taktike valutore e rezervave valutore për vitin 2017 parashikoi një rritje të investimeve në dollarë amerikanë në nivel prej 40.4% të rezervave valutore (me përjashtim të arit) në llogari të reduktimit të pozicioneve në euro në 59.3%. Domethënë, ishte parashikuar një rritje e konsiderueshme e aktiveve likuide në kuadër të portofolit të likuiditetit në dollarë amerikanë, si dhe rritje të moderuar në portofolin e investimeve deri në maturim në dollarë amerikanë gjatë tremujorit të parë të vitit, kur edhe ishin bërë adaptime për shpërndarjen e re taktike. Në të njëjtën kohë, në rrethana të tilla, është parashikuar reduktimi i ekspozimit ndaj rrezikut të normës së interesit të portofolave të rezervave valutore.

**Për shkak të menaxhimit më fleksibël të rrezikut të normës së interesit në muajin maj u ekzekutua rishikimi i Rregullave për menaxhimin dhe investimin e rezervave valutore, me çka në mënyrë të detajuar u rregulluan kushtet shtesë nën të cilat Banka popullore mund të lidh dhe të shlyhej transaksione-kontrata të së ardhmes me banka komerciale/ndërmjetës të autorizuar të bursave respektive. Ky ndryshim mundësoi deri në fund të tremujorit të tretë të vitit 2017**

<sup>53</sup> Alokimi taktik i rezervave valutore kryhet para fillimit të çdo viti në përputhje me Politikën dhe Rregullat për menaxhimin dhe investimin e rezervave valutore. Gjatë vitit, nëse për shkak të kushteve të tregut në zhvillim ekziston nevoja, vendoset një alokim i ri taktik i rezervave valutore. Kjo qasje dinamike zbatohet nga shumica e bankave qendrore në botë, e cila siguron përshtatjen e shpejtë të kushteve të tregut dhe mbrojtjen e vlerës së rezervave valutore.

plotësisht të përfundohet procesi i futjes së kontratave të së ardhmes në kuadër të portofolit të rezervave valutore. Për më tepër, në tetor është lidhur transaksioni i parë me kontrata e së ardhmes të normave të interesit, pas së cilës u vazhdua me kontraktime të transaksioneve në përputhje me pozitën aktuale dhe pritjet për zhvillimet e ardhshme në tregjet financiare ndërkombëtare.

**Gjatë korrikut, në kushte të një trendi të vazhdueshme të zhvlerësimit të dollarit amerikan kundrejt euros, dhe me qëllim për të minimizuar rreziqet valutore në kushte të pasigurisë për lëvizjen e mëtejshme të raportit të këtij çifti valutor, filluan ndryshime strukturën valutore taktike, me çka u zvogëluar pjesëmarrja e dollarit amerikan në rezervat valutore.** Fillimisht u parashikua ulja e pjesëmarrjes së dollarit amerikan rreth strukturës themelore valutore<sup>54</sup>, pra në nivel prej 22% të rezervave valutore (me përjashtim të arit). Me zhvlerësimin e mëtejshëm të dollarit amerikan, u parashikua reduktim shtesë i pjesëmarrjes së valutës amerikane, në nivel më të ulët se struktura themelore valutore (deri në nivel prej 15% të rezervave valutore, me përjashtim të arit). Rrjedhimisht, ekspozimi ndaj rrezikut valutor ka rënë dukshëm, në përputhje me vlerësimet e rezervave të mbetura të rivlerësuara me diferencat e kursit të këmbimit. Reduktimi në pjesëmarrjen e dollarit amerikan u zhvillua fillimisht përmes konvertimit të mjeteve nga portofoli i likuiditetit dhe investimeve për tregtim, dhe pastaj edhe transformimin e portofolit me të cilën menaxhon Banka Botërore nga dollarë amerikanë në euro. Këto konvertime nuk janë përfshirë portofolin në dollarë amerikan deri në maturim, ku ka një përcaktim të fortë për mbajtjen e letrave me vlerë, por edhe për të ruajtur një diversifikim të caktuar në kuadër të rezervave valutore.

### **Shtojca 3. Aktivitetet lidhur me përmirësimin e kapacitetit institucional në menaxhimin e rezervave valutore**

Gjatë vitit 2017, vazhduan aktivitetet e BPRM-së në kuadër të bashkëpunimit me Bankën Botërore (RAMP - Programi Këshillimor për Menaxhimin e Rezervave Valutore).

Gjatë tremujorit të parë, u zhvillua një takim pune me ekspertët e Bankës Botërore, me qëllim të rishikimit dhe përmirësimit të menaxhimit të rrezikut të kredisë. Mandej, është zhvilluar modelimi i rrezikut të kredisë, bazuar në kriteret e Bazelit dhe ishin vendosur themelet për matjen e rrezikut të kredisë të investimeve në rezervat valutore, nëpërmjet përpunimit të burimit të rrezikut të kredisë në kuadër të rezervave valutore dhe përcaktimit të kthimit të instrumenteve të veçanta ndaj totalit të rrezikut të kredisë në raport me nivelin e pranueshëm të rrezikut. Parashikohet që mjeti për matjen e rrezikut të kredisë, pas përshtatjes së tij për portofolat përkatëse, të bëhet një pjesë integrale e menaxhimit të rregullt të rrezikut të kredisë të rezervave valutore.

Në shtator, është organizuar një vizitë e misionit të Bankës Botërore përkushtuar përgatitjes së BPRM-së në zbatimin e standardit të ri të SNRF9. Qëllimi i misionit ishte krijimi i proceseve të vendim-marrjes lidhur me klasifikimin e aktiveve financiare përmes vlerësimit adekuat të modeleve të biznesit, ndërsa ofroi edhe mbështetje profesionale për matjen e korrigjimit të vlerës së aktiveve financiare të bazuara në modelin e humbjes së pritshme të kredisë. Bazuar në udhëzimet në standardet ndërkombëtare të kontabilitetit, diskutimet gjatë misionit të Bankës Botërore, si dhe konsultime shtesë me bankat e tjera qendrore dhe ekspertë nga Banka Botërore që kanë specializuar në rrezikun e kredisë, Banka popullore përpunoi modelin e vet për të llogaritur humbjen e pritshme të kredisë të mjeteve financiare. Në fillim të vitit 2018, modeli u aplikua në portofolat aktuale të rezervave valutore.

Në të njëjtën kohë, u vazhdua me avancimin e njohurive dhe ndërtimin e kapaciteteve institucionale në BPRM, përmes vizitave të punonjësve të përfshirë në procesin e investimit të


<sup>54</sup> Struktura themelore e valutës së rezervave valutore është në përputhje me strukturën valutore të ndërhyrjeve në tregun e brendshëm valutor, detyrimeve të shtetit për jashtë vendit, tregtisë së jashtme të Republikës së Maqedonisë dhe nevojat e tjera të likuiditetit, dhe parashikon 80% euro, 19.7% dollar amerikan dhe 0,3% e valutave të tjera.

rezervave valutore në seminare të specializuara të organizuara nga Banka Botërore. Gjithashtu, u realizua një vizitë pune dyjavore në Bankën Botërore, për të marrë njohuri dhe shkathtësi praktike në fushën e menaxhimit të portofolit të rezervave valutore. Të gjitha vizitat në punëtori profesionale janë përdorur edhe për shkëmbimin e përvojave me ekspertë të Bankës Botërore, ashtu edhe me përfaqësuesit e bankave qendrore në nivel global, dhe që janë anëtarë të programit të Bankës Botërore, që është shumë e rëndësishme për të mbajtur një nivel të lartë të efikasitetit, profesionalizmit dhe cilësisë së burimeve njerëzore të angazhuar në procesin e menaxhimit të rezervave valutore.


## 6.2. Kushtet për investime në tregjet financiare ndërkombëtare në vitin 2017

**Në vitin 2017, zhvillimet në tregjet financiare ndërkombëtare u karakterizuan nga ndryshueshmëria, por kryesisht ishin të ndikuara nga sinjalet pozitive të rritjes së aktivitetit ekonomik në nivel globale.** Mandej, çmimet e aksioneve kanë arritur nivel të lartë rekord, në kushte të bazave të favorshme ekonomike dhe prirje relativisht të lartë të investitorëve për të marrë rreziqe, që nga ana tjetër, çoi deri në kërkesë më të ulët për instrumente me të ardhura fikse dhe rritje të kthimeve, që ishte më e theksuar në tregjet amerikane. Kjo ishte për shkak të normalizimit të mëtejshëm të politikës monetare nga banka qendrore amerikane. Gjegjësisht, në kushte të performancës së favorshme ekonomike të ekonomisë amerikane, FED-i vazhdoi me shtrëngimin e politikës monetare, duke rritur gamën e objektivit për normat e interesit në tri raste (në nivel prej 1.25% deri në 1.5%)<sup>55</sup>. Gjithashtu, në tetor FED-i ndaloi me riinvestimet në shumat e maturuara nga portofoli i letrave me vlerë, të blera në kuadër të programeve të lehtësimit sasior, me çka ka filluar në fazën e fundit të normalizimit të politikës monetare nëpërmjet zvogëlimit të bilancit të saj<sup>56</sup>.

Grafik 83  
Lëvizja e aksioneve  
(në pikë)



Grafik 84  
Lëvizja e kthimeve mbi obligacionet qeveritare  
(në%)



**Lakorja afatshkurtër dhe afatmesëm e kthimit të letrave me vlerë të qeverive amerikane përjetuan një korrigjim rritës.** Nga ana tjetër, për shkak të përpjekjes së dështuar e presidentit amerikan për të fituar mbështetje për zbatimin e reformës së planifikuar të sistemit shëndetësor dhe rritja e trazirave politike në SHBA<sup>57</sup>,

<sup>55</sup> Këto vendime u morën në takimet e Fed-it në mars, qershor dhe dhjetor të vitit 2017.


<sup>56</sup> Në kushtet e udhëheqjes së Fed-it, duke pasur parasysh se mandati i presidentes aktuale skadon në vitin 2018, presidenti i SHBA caktoi një president të ardhshëm, duke treguar për vazhdimin e politikave të kujdeshme të Fed-it.

<sup>57</sup> Kah mesi i tremujorit të dytë të vitit 2017, u rrit pasiguria politike në SHBA, pas informacionit të publikuar në lidhje me ndërhyrjen e pretenduar të hetimit të e FBI-së nga ana e presidentit amerikan dhe ndarjen e informacioneve konfidenciale me Rusinë.


kthimet në segmentin e gjatë të lakores së letrave me vlerë të qeverisë kanë lëvizur në drejtim të kundërt.

**Lëvizja e kthimeve në eurozonë gjithashtu u kushtëzua nga tendencat e favorshme ekonomike, të cilat kanë kontribuar në rritjen e pritjeve për të normalizuar politikën monetare të BQE-së.** Përveç kësaj, pas një periudhe më të gjatë të rënies, në vitin 2017 kthimet e obligacioneve qeveritare në eurozonë shënuan rritje. Kthimet e obligacioneve të qeverisë u rritën në mënyrë të konsiderueshme në gjysmën e parë të vitit, ku rritje e veçantë u vu re në segmentin 5-vjeçar, për shkak të pritjeve të rritura të inflacionit të investitorëve. Përveç kësaj, rreziqet e reduktuara politike mundësuan një rënie të kthimeve të obligacioneve të qeverisë në ekonomitë periferike, me një kërkesë në rritje për obligacione qeveritare me kthim më të lartë. Mandej, hendeku midis obligacioneve qeveritare 10-vjeçare të Francës dhe Gjermanisë ka pasur një trend të ngushtimit, dhe trend të njëjtë, ose ngushtim të konsiderueshëm të hendekut, është vërejtur edhe midis kthimeve të të gjitha instrumenteve të tjera të kreditit në raport me obligacionet më të sigurta qeveritare në eurozonë.

Grafik 85  
Ndryshimi vjetor i kthimeve të obligacioneve qeveritare (në pikë përqindjeje)



Grafik 86  
Ndryshimi tremujor në kthimeve të obligacioneve qeveritare në eurozonë (në pikë përqindjeje)



**Në tremujorin e tretë, si rezultat i rritjes së pasigurisë politike në eurozonë<sup>58</sup> dhe rritja e tensioneve gjeopolitike në mes SHBA-së dhe Koresë së Veriut, u rrit kërkesa për instrumenteve financiare të sigurta, të cilat çuan në një rënie të kthimeve të obligacioneve qeveritare.** Në tremujorin e fundit të vitit, kthimet në segmentin afatshkurtër të lakores janë rritur duke pasur parasysh që në mbledhjen e 26 tetorit, BQE njoftoi një reduktim të blerjes mujore në kuadër të programit për blerjen e letrave me vlerë, duke filluar nga janari i vitit 2018. Megjithatë, presionet e ulëta të çmimeve kontribuan në reagimin e kundërt të kthimeve në segmentin e gjatë të lakores.

**Në tregjet valutore, lëvizjet u ndikuan nga vlerësimi për konvergencën e politikave monetare të bankave qendrore globale<sup>59</sup>, por edhe nën ndikimin e lajmeve gjeopolitike dhe perceptimeve të rrezikut.** Në gjysmën e parë të vitit,

<sup>58</sup> Në shtator, pasi që Parlamenti rajonal i Katalonjës sjelli vendim të mbahet një referendum për pavarësi nga Spanja, vijoi edhe shpallja e njëanshme të pavarësisë, e cila ishte shpallur si jokushtetuese nga ana e autoriteteve spanjolle. Por, pavarësisht nga zhvillimet politike në Spanjë, primi i rrezikut për obligacionet e qeverisë spanjolle ka mbetur mjaft i qëndrueshëm, ndërsa hendeku në mes të obligacioneve qeveritare të Spanjës dhe Gjermanisë është ngushtuar. Përveç kësaj, për rritjen e pasigurisë politike në eurozonë kanë kontribuar edhe zhvillimet politike në ekonominë më të madhe të eurozonës, Gjermania, ku u mbajtën zgjedhjet federale, pas rezultatit të së cilës pritëshin bisedime për formimin e një koalicioni.

<sup>59</sup> Gjatë vitit 2017, Fed, Banka e Anglisë dhe Banka Qendrore e Kanadasë i rritën normat e interesit të referencës.


rreziqet politike në eurozonë u zvogëluan, ndërsa BQE<sup>60</sup> dhe bankat e tjera të mëdha qendrore vunë në dukje një shtrëngim të politikës monetare. Rezultatet e zgjedhjeve presidenciale të Francës ishin një sinjal për të reduktuar lëvizjet euroskeptike në Evropë, të cilat tregjet i kanë ndjekur me vëmendje të veçantë pas referendum në Mbretërinë e Bashkuar për dalje nga BE-ja në vitin 2016. Këta faktorë kanë kontribuar në forcimin e vlerës së valutës së përbashkët në eurozonë, ndërkohë që zhvillimet e ngadalta të ngjarjeve në raport me masat e parashikuara për reformën e tatimeve në SHBA<sup>61</sup>, kanë kontribuar për vlerë më të dobët të valutës amerikane.

**Në kushte të tilla, euroja në fund të vitit ka arritur një nivel prej 1.2005 dollarë amerikan për euro, apo e ka rritur vlerën për 14% kundrejt dollarit amerikan në bazë vjetore, që paraqet zhvlerësim vjetore më të lartë të dollarit amerikan që nga viti 2003 e këndej.**

Në kushte të rënies së vlerës së dollarit amerikan gjatë tërë vitit, tensione të rritura politike në Gadishullin Korean<sup>62</sup> dhe pasiguritë politike në zonën e euros në fillim të tremujorit të fundit të vitit, çmimi i arit u rrit nga 1,159 dollarë amerikan për ons në fund të vitit 2016 në 1,296.5 dollarë amerikan për ons në fund të vitit 2017. Gjatë vitit, kërkesa për arin nga banka qendrore ishte më e ulët për 5% krahasuar me një vit më parë, kështu që bankat qendrore bleu 371.4 ton në bazë neto. Ndër bankat që blenë ar në shumat më të mëdha ishin banka qendrore e Turqisë dhe Rusisë<sup>63</sup>.

Grafik 87

Lëvizja e çiftit valutoreuro/dollar amerikan dhe çmimi i arit në vitin 2017



### 6.3. Investimi i rezervave valutore

#### 6.3.1. Shpërndarja e investimeve sipas portofoleve

**Gjatë alokimit të rezervave valutore në portofolat konsiderohen detyrimet dhe qëllimet e caktuara të rezervave valutore në periudha të ndryshme kohore.** Në këtë kuptim, rezervat valutore janë alokuar në portofolin operacional, të likuiditetit dhe të investimeve. Kjo mënyrë e menaxhimit të likuiditetit lejoi BPRM në mënyrë efektive t'u përgjigjet nevojave për përdorimin e rezervave valutore gjatë vitit.

Niveli i rezervave valutore shënoi rënie për 277 milionë euro (nga 2,613 milionë euro në fund të vitit 2016 në 2,336 milionë euro në fund të vitit 2017), kryesisht për shkak të transaksioneve të qeverisë në shumën neto prej 206 milionë euro, mandej për të reduktuar

<sup>60</sup> Kryetari i BQE, në Forumin e BQE për sistem Qendror Bankar në Sintra, Portugali, shprehu optimizëm në lidhje me rimëkëmbjen e ekonomisë së eurozonës, e cila tregoi se BQE-ja do të rregullojë politikën monetare me kujdes dhe gradualisht.

<sup>61</sup> Senati dhe Dhoma e Përfaqësuesve të SHBA-së e votuan reformën e tatimeve deri në fund të vitit 2017. Me reformën e tatimeve, norma e tatimit të korporatës do të jetë 21% (në vend të 35%), dhe norma e tatimit mbi të ardhurat për personat privatë me të ardhura më të larta u ul nga 39.6% në 37%.

<sup>62</sup> Në shtator, Koreja e Veriut testoi një raketë balistike ndërkontinentale, që kaloi mbi ishullin japonez Hokaido para se të binte në oqean të hapur.


<sup>63</sup> World Gold Council, Gold Demand Trends Full Year 2017, 6 Feb. 2018.



vlerën e tregut (në kushte të dallimeve negative të llogaritura të kursit të këmbimit), dhe në një masë më të vogël për shkak të reduktimit të depozitave në valutë të huaj të bankave. Nga ana tjetër, derdhja nga rezervat valutores pjesërisht u kompensuar nga ndërhyrjet e BPRM me bankat mbështetëse për blerjen e valutës së huaj (66 milionë euro), rrjedhjen e mjeteve nga bankat e vendit në bazë të rezervave të detyrueshme dhe burimeve në SPNM për ekzekutimin e pagesave në euro në TARGET2, si dhe të ardhurat nga investimi në rezervat valutores.

Grafik 88


Faktorët e ndryshimit të rezervave valutores në vitin 2017 (sipas tremujorëve dhe kumulative) në milionë euro



Burimi: BPRM.

Grafik 89

Portfolio e rezervave valutores niveli mesatar, në milionë euro




**Gjatë tre tremujorëve të parë të vitit 2017 rezervat valutores kanë pasur një prirje rënëse, duke pasur parasysh ndikimin negativ të të gjithë faktorëve të ndryshimit.** Mandej, rënia e konsiderueshme në asetet ishte për shkak të transakcioneve në llogari të shtetit, ndikuar kryesisht nga shlyerja e kredive të matura dhe pagesave e kuponëve të euro-obligacioneve të emetuara në tremujorin e tretë. Ulja më e lartë në vlerën e tregut e rezervave valutores është vërejtur në tremujorin e dytë dhe të tretë për shkak të llogaritjes së dallimeve negative të kursit të këmbimit gjatë zhvlerësimit të dollarit amerikan në kushte të pasigurisë politike në SHBA. Daljet e fondeve nga rezervat valutores ishin edhe për shkak të pagesës së depozitave në valutë të huaj matura të bankave mbështetëse në BPRM, në tremujorin e parë, si dhe ndërhyrjet për shitjen e valutës së huaj me bankat mbështetëse në tregun e këmbimit valutor, në tremujorin e dytë të vitit. Për të rritur rezervat valutores kanë kontribuar fluksi i mjeteve nga bankat e vendit në bazë të rezervës së detyrueshme dhe mjeteve në SPNM për ekzekutimin e pagesave në euro në TARGET2.

**Në kundërshtim me lëvizjet e tre tremujorëve të parë të vitit, gjatë tremujorit të katërt të vitit, rezervat valutores janë rritur për shkak të ndërhyrjeve të BPRM me bankat mbështetëse për blerjen e valutës së huaj, andaj portofolat individuale janë mbajtur në nivele të përshtatshëm të qëllimit të tyre.** Gjegjësisht, ndërhyrjet në tregun valutor për të blerë kontribuan në ruajtjen e nivelit të portofolit operacional në përpunje me daljet e projektuara të rezervave valutores, dhe mjetet që maturan në portofolin deri në maturim në dollarë amerikanë janë ridrejtuar në portofol të likuiditetit dhe janë investuar në depozita afatshkurtra, për të u siguruar fleksibilitet më i madh në menaxhimin e tyre.

### 6.3.2. Ekspozimi i kredisë dhe instrumentet

**Sigurie e investimeve në rezerva valutore ka në rëndësi të lartë gjatë përpilimit të strategjisë investuese të BPRM.** Në përputhje me kornizën e parashikuar të investimeve, pjesa më e madhe e rezervave valutore ose mesatarisht rreth 56% janë investuar në instrumente financiare me vlerësimet më të larta të kredisë (nga "AAA" në "AA-"), dmth me ekspozimin më të ulët ndaj rrezikut të kredisë. Krahasuar me vitin e kaluar, kjo kategori shënoi një rënie të moderuar, kryesisht për shkak të reduktimit të investimeve në letrat me vlerë të SHBA-ve që mbajnë rejtingun nga "AAA" gjatë tremujorit të parë të vitit 2017, për shkak të vendimit për uljen e rrezikut të interesit për tregti në portofol në dollarë amerikanë. Për të balancuar me parimin e ruajtjes së vlerave në kushtet e rendimenteve të ulëta dhe negative, pjesa më e madhe e investimeve në rezervat valutore ishin drejtuar edhe në instrumente me vlerësim të rejtingut kreditues nga "A +" në "A-", të cilat karakterizohen gjithashtu me një nivel të lartë të sigurisë, duke mundësuar një kthim të moderuar pozitiv mbi aktivet. Një pjesë e kufizuar e investimeve brenda portofolit likuid në euro u drejtoheshin vendeve dhe instrumenteve që mbajnë një rejting të ulët të kredisë, por më të larta se rejtingu minimal investiv. Në këtë mënyrë, në përputhje me parimin e sigurisë, BPRM kërkon të arrijë një kthim optimal të investimit nëpërmjet një menaxhimi aktiv të kujdesshëm dhe të njëkohshëm të rezervave valutore, në kushte të një kontrole të rreptë të rrezikut të kredisë.


Grafik 90  
Struktura mesatare vjetore e investimeve sipas vlerësimit të kredisë



\*në kategorinë të tjera klasifikohen FMN, BIS

Burimi: BPRM.

Grafik 91  
Struktura gjeografike mesatare vjetore e investimeve



\*IFI dhe MRB - institucionet financiare ndërkombëtare dhe bankat multilaterale të zhvillimit


**Gjeografikisht, një pjesë e konsiderueshme e investimeve të rezervave valutore janë të orientuara drejt ekonomive nga thelbi i eurozonës, por kthimet negative në tregjet evropiane të instrumenteve me të ardhurave fikse dhe nevoja për të kërkuar kthime kushtëzojnë ekspozim të moderuar më të lartë dhe drejt ekonomive të tjera në eurozonë dhe nga Unioni Evropian.** Në këtë kontekst, edhe investimet në kategorinë "të tjera" regjistrojnë rritje të konsiderueshme, në krahasim me vitin e kaluar, kryesisht për shkak të rritjes së investimeve në instrumente afatshkurtër në tregun e pasur (letrave me vlerë dhe depozitat) në bankat me cilësi të lartë komerciale nga rajoni aziatik (Kina, Japonia dhe Singapori).

**Fokusimi në parimin e sigurisë së investimeve të rezervës valutore, e kombinuar me mbajtjen e një niveli adekuat të likuiditetit, është gjithashtu i dukshëm në strukturën e instrumenteve financiare.** Në fakt, duke qenë se letrat me vlerë janë të përfaqësuara si në investime, ashtu edhe në portofol likuiditeti, këto instrumente financiare, me një pjesëmarrje mesatare prej 78%, janë më të përfaqësuara në

kuadër të strukturës së rezervave valutore sipas instrumenteve. Megjithatë, te letrat me vlerë, rënie e moderuar është regjistruar në investime në letra me vlerë të qeverisë dhe letra me vlerë me një garanci shtetërore, të cilat përbënin 62.7%, mesatarisht, në investimet e rezervave valutore në letra me vlerë (më pak për 7.8 p.p. krahasuar me vitin 2016). Kjo rënie është kryesisht për shkak të rënies së investimeve në dollarë amerikanë, ku letrat me vlerë më të shitura janë pikërisht letra me vlerë të qeverisë. Me qëllim që të mbajë rrezikun e normës së interesit në kuadrin e parashikuar, në portofolat në euro, investime më afatgjata në letra me vlerë të qeverisë janë kombinuar me investimet në letrat komerciale afatshkurtër dhe certifikatat e depozitave të emetuara nga bankat e huaja komerciale të klasit të parë, të cilat ofrojnë fleksibilitet në kushtet e nevojës për likuiditeti, ku kjo kategori kishte pjesëmarrje mesatare prej 13.7% në strukturën sipas letrave me vlerë. Pjesëmarrje më të konsiderueshme (10.1%) kishin edhe investimet në letra me vlerë, me mbështetjen e prituri të shtetit, të cilat pavarësisht nivelit të lartë të sigurisë, sigurojnë edhe kthim më të lartë në krahasim me vlerë të qeverisë. Pjesë e moderuar e investimeve ishte drejtuar në letra me vlerë të emetuara nga organizatat multilaterale<sup>64</sup> me një përqindje mesatare prej 3.7% në letra me vlerë dhe në letrat me vlerë të emetuara nga qeveritë rajonale të Gjermanisë, Australisë dhe Kanadës (me një pjesëmarrje mesatare prej 8.4%).


**Një pjesë e rezervave valutore janë ruajtur në llogaritë rrjedhëse (mesatarisht rreth 7.3%), ku në fakt janë aktivet e portofolit operativ.** Për të optimizuar kostot, përveç llogarive me bankat qendrore, një pjesë e fondeve mbahen edhe në llogaritë rrjedhëse në bankat e huaja tregtare. Në bankat komerciale të huaja janë të vendosura edhe depozitat<sup>65</sup>, në kuadër të portofolave të likuiditetit dhe të investimeve, ku pjesëmarrja e tyre rënie të lehtë (nga një mesatare prej 4.8% në vitin 2016 në 4% në vitin 2017), kryesisht për shkak të vendosjes së disa prej depozitave të maturuara në instrumente të tjera të tregut të parasë (certifikata për depozita, bono komerciale dhe qeveritare).

Grafik 92  
Struktura e investimeve sipas instrumenteve, mesatarisht në vit



Burimi: BPRM.

Grafik 93  
Struktura sipas llojeve të LV, mesatarisht në vit



**Ari, i cili zakonisht është një instrument financiar me rendiment më të ulët të tregut, gjatë këtij viti është plasuar në depozita afatshkurtra te bankat e huaja tregtare të klasit të parë.** Gjatë vitit, janë kontraktuar suop transaksione me arë me një maturim afatshkurtër, që mundësuan realizimin e të ardhurave shtesë nga menaxhimi i

<sup>64</sup> Banka Evropiane e Investimeve (EIB), Banka për Zhvillim të Këshillit të Evropës (COE), Kompania Evropian për financimin e hekurudhave (EUROFIMA), Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC), Banka e Investimeve Nordike (NIB), Bankës për Zhvillim Aziatik (ADB), Bankës Ndër-Amerikane për Zhvillim (IADB).


<sup>65</sup> Investimet në depozita në kuadër të portofolit të investimeve janë të kufizuara në maturim më së shumti deri në një vit.

rezervave valutore<sup>66</sup>. Brenda strukturës së rezervave valutore, pjesëmarrja mesatare e arit nuk shënoi ndryshime dhe dhe shënonte 10.3% nga rezervat valutore. **Nga transaksionet e tjera me rezervat valutore, BPRM ka vazhduar të përdorë operacionet e huadhënies së letrave me vlerë duke kontraktuar njëkohësisht repo dhe transaksionet e anasjella të repo transaksioneve.** Për të rimbursuar një pjesë të shpenzimeve që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen e llogarive me palët kontraktuese dhe depozituesit e letrave me vlerë, u vazhdua shfrytëzimi i shërbimeve të depozituesve për tërheqjen automatike të letrave me vlerë nga portofoli i BPRM-së i mbajtur me depozitarin përkatës.

### 6.3.3. Struktura valutore<sup>67</sup>


**Alokimi i rezervave valutore sipas valutave është kryer në përputhje me udhëzimet e dhëna nga rishpërndarja taktike e rezervave valutore, si dhe me funksionin parësor për disponimin e fondeve për mbështetjen e strategjisë monetare të shënjestrimit të kursit të këmbimit.** Nga këtu, mjetet e investuara në instrumentet financiare të shprehura në euro janë më të përfaqësuara në nivel të rezervave valutore, me një peshë mesatare prej rreth 71.1%. Megjithatë, duke pasur parasysh kushtet e pafavorshme të tregjeve në tregjet evropiane, dhe në përputhje me rishpërndarjen taktike të investimeve, një pjesë e konsiderueshme e rezervave valutore u investuan në instrumente financiare të shprehura në dollarë amerikanë. Pjesëmarrja e këtyre investimeve në strukturën valutore ishte mesatarisht 28.4% gjatë vitit 2017 dhe u zvogëlua për rreth 9.7 pikë përqindjeje krahasuar me vitin 2016. Kjo rënie është e justifikuar duke pasur parasysh trendin e zhvlerësimit të monedhës amerikane dhe rritjes së rreziqeve valutore.

Grafik 94  
Struktura valutore e rezervave valutore, mesatarja vjetore



Burimi: BPRM-së.

Grafik 95  
Ndryshimet në strukturën valutore (për tremujoret, gjendja mesatare)



\*Të gjitha nuancat e katërta ose pjesa e poshtme e secilës kolonë tregojnë euro.

Parë sipas dinamikës, struktura valutore e rezervave valutore (pa ar) në gjysmën e parë të vitit korrespondonte plotësisht me strukturën taktike valutore të rezervave valutore

<sup>66</sup>Në transaksionet suop, plasohen dollarët amerikanë dhe në të njëjtën kohë pranohet ari si kolateral (me datën e vendimit të suopit), me një detyrim për të kryer një transaksion të kundërt në datën e maturimit të kontratës së derivuar. Ari i marrë si kolateral plasohet në një depozitë të një nga palët kontraktuese me cilësi të lartë, për të njëjtën periudhë që plasohet dollari amerikan. Në këtë mënyrë mundësohet realizimi i të ardhurave nga kreditë në dollarë amerikanë dhe plasmani i arit.

<sup>67</sup>Struktura valutore është e analizuar në raport me gjendjen e rezervave devizore të zvogëluara për shumën e arit.

për vitin 2017, ku euro arriti në një pjesëmarrje mesatare prej 60% dhe dollari amerikan me një pjesëmarrje prej 40% të rezervave valutore. Megjithatë, tremujori i dytë u karakterizua nga një lëvizje e pafavorshme e dollarit amerikan dhe në bazë të analizave të perspektivave të valutës amerikane u morën parasysh mundësitë për uljen e ekspozimit ndaj rrezikut valutor. Si rrjedhojë, në fillim të tremujorit të tretë, u bë një ndryshim në strukturën taktike valutore të rezervave valutore. Në të vërtetë, duke pasur parasysh zhvillimet e tregut, struktura e re taktike valutore dha instruksione për të rritur pjesëmarrjen e euros nga 59% në 85% të rezervave valutore, duke ulur pjesën e dollarit amerikan nga 41% në 15% të rezervave valutore. Rregullimi në strukturën valutore taktike u krye në gjysmën e dytë të korrikut dhe fillimin e gushtit 2017, ku në fund të shtatorit pjesëmarrja e dollarit amerikan arriti deri në 15% të rezervave valutore.

Gjatë tremujorit të katërt, struktura valutore e rezervave valutore ndryshoi si rezultat i diversifikimit të rezervave valutore në dollarë australianë dhe të Zelandës së Re për shkak të shfrytëzimit të normave më të larta të interesit. Megjithatë, si rezultat i rritjes së paqëndrueshmërisë së lëvizjeve të këtyre monedhave, pozicionet u mbyllën dhe fondet u konvertuan në dollarë amerikanë, për shkak të rritjes graduale të ekspozimit të rezervave valutore në strukturën valutore strategjike. Në rrethana të tilla, shumica e dollarëve amerikanë në rezervat valutore pati një rritje të vogël, por duke marrë parasysh hyrjet në euro gjatë tremujorit të fundit, pjesëmarrja e dollarit amerikan në strukturën valutore në fund të vitit ishte relativisht e pandryshuar.

#### 6.3.4. Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit dhe rezultatet nga investimi i rezervave valutore

**Në kushte të pritshmërive për lëvizje të tregjeve të ndryshueshme gjatë vitit dhe rritjes së gjasave për rritje të të ardhurave, në veçanti në eurozonën, në vitin 2017 ishte paraparë zvogëlim i ekspozimit ndaj rrezikut të normës së interesit e të gjitha portofoliove të rezervave valutore.** Gjegjësisht, plasimi dhe investimi në rezervat valutore është kryesisht në letra me vlerë të cilat sjellin të ardhura nga interesi dhe kuponët, por janë të ekspozuara edhe ndaj ndryshimeve të çmimit të tyre të tregut, respektivisht të ardhurave rrjedhëse. Ky ekspozim ndaj rrezikut të normës së interesit kontrollohet përmes vërtetimit të përshtatjes themelore të kohëzgjatjes dhe ruajtjes të një pjese të letrave me vlerë deri në maturim. Menaxhimi me rrezikun e normës së interesit, përveç përmes rregullimit të kohëzgjatjes, vijon edhe në raport me kufizimin e një niveli të pranueshëm të rrezikut të normës së interesit<sup>68</sup>, e cila përgjatë vitit u mbajt në korniza të përcaktuara, që udhëzon në rregullim adekuat të strategjisë së investimeve.

**Zvogëlimi i rrezikut të normës së interesit filloi në tremujorin e parë të vitit, përmes shitjes së letrave me vlerë afatgjate dhe riorientimi i plasmanit ndaj instrumenteve afatshkurta.** Trendi i këtillë vazhdoi edhe në periudhën e ardhshme, në kushte të vëzhgimit për tërheqjen e masave për përkrahje monetare nga ana e BQE në vitin 2018, respektivisht për rritje të pritshme të të ardhurave të obliguesve shtetërorë të eurozonës, në veçanti në segmentin e mesëm dhe të gjatë të lakores së të ardhurave-rendimenteve. Të ardhurat për zvogëlimin e ekspozimit ndaj normave të interesit nënkupton rregullim kohor taktik më të ulët, i cili solli deri te zvogëlimi i ekspozimit të rrezikut të normave të interesit të portfoliove referuese, të cilat bashkë me mënyrën e zgjedhjes së instrumenteve shkakton zvogëlim të vazhdueshëm të rrezikut aktiv të normave të interesit.

**Duke pasur parasysh fillimin e tremujorit të katërt që filloi me zbatimin e kontratave-fjuçërs gjatë formulimit të strategjive investuese, menaxhimi me**


<sup>68</sup>Niveli i pranueshëm i rrezikut kamator sipas politikës për menaxhimin dhe investimin e rezervave devizore është e kufizuar me gjasat për zvogëlimin e vlerës tregtare të rezervave devizore deri 1% në nivel të besueshmërisë prej 95% përgjatë periudhës investuese të një viti.

**rezikun e normave të interesit ishe më fleksibël, ndërsa rregullimi i kohëzgjatjes së portfoliove në pajtim me ndryshimet e parapara tregtare bëheshin më shpejtë dhe në mënyrë më efikase.** Për më tepër, shumica e investimeve ishin tashmë të drejtuara drejt tregjeve evropiane, ku investimet në afat të shkurtër ishin pa përjashtim negative. Në mënyrë që të ruhet vlera e investimeve dhe në të njëjtën kohë të zvogëlohet ekspozimi ndaj normës së interesit, në tremujorin e fundit të vitit, investimet relativisht afatgjata me të ardhura pozitive ishin të balancuara me pozicione të shkurtra në fjuçërsa të obligacioneve, të cilat mundësuan mbrojtje nga rritja e përfitimeve dhe njëkohësisht arritjen e përfitimit mesatar pozitiv nga mjetet e investuara.

**Rezultatet e investimit të rezervave valutore kryesisht u dedikohen kushteve të tregut në kohën e investimit, si dhe kthimin e portfoliut të referencës<sup>69</sup>, që shërbejnë si një drejtim për investime. Portfoli operativ, duke pasur parasysh nevojën për të ruajtur mjetet në euro, ka një ndikim negativ<sup>70</sup> në të ardhurat nga investimet e rezervave valutore, në një nivel që është më pak negativ sesa niveli i portfoliut referues. Rritja e përfitimeve nga obligacionet qeveritare, e cila ishte më e theksuar në dhjetor, çoi në uljen e vlerës së tregut të portfoliove të eurozonës. Megjithatë, fitimet e realizuara nga transaksionet e kontratave të ardhshme brenda portfoliut të likuiditetit dhe investimit të investimeve në euro arritën të kompensojnë pjesërisht performancën e pafavorshme të këtyre portfoliove, të cilat tejkaluan performancën e portfoliove referente. Nga ana tjetër, portfoli i investimeve në dollarë amerikan arriti një normë relativisht solide të kthimit, që është më e lartë sesa portfoli referues.**

Grafik 96


Vlera e ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit (fondi i tremujorit, në milionë euro)



Burimi: BPRM-së.

Grafik 97

Norma e kthimit nga portfoliut në vitin 2017



\*ИП во САД -долари: заклучно со јули 2017 година.

**Për të zvogëluar ekspozimin ndaj rrezikut të normës së interesit, disa nga letrat me vlerë të investuara brenda rezervave valutore regjistrohen si letra me vlerë që mbahen deri në maturim, të cilat sipas karakteristikave të tyre kanë një kthim të parashikueshëm dhe të qëndrueshëm.** Niveli i portfoliut deri në maturim në euro ishte relativisht i qëndrueshëm, ndërkohë që maturimi i mbetur i këtij portfoli ka rënë ndjeshëm. Duke pasur parasysh vlerësimin për rritjen e rrezikut valutator, mjetet që maturonin në kuadër të portfoliut të investimit deri në maturim në dollarë amerikanë gjatë


<sup>69</sup>Indeksi i referencës së çmimeve të letrave me vlerë dhe indeksi i tregut të parasë, i përbërë nga instrumente financiar real, me kohëzgjatje të rregulluar që korrespondon me kohëzgjatjen e rregulluar bazë të portfoliut të investimeve.

<sup>70</sup>Mjetet brenda portfoliut operativ, për shkak të funksionit të tyre, plasohen parasegjithash në llogaritë rrjedhëse në bankat qendrore, ku zbatohet një normë interesi negativ prej 0.40%. Megjithatë, për të kufizuar efektin negativ në të ardhurat, një pjesë e mjeteve mbahen në llogaritë rrjedhëse në bankat komerciale, në shumën për të cilën bankat nuk ngarkojnë interes negativ.

gjysmës së dytë të vitit u ridrejtuam në plasimet afatshkurtra në kuadër të portofolit likuid të dollarit amerikan, gjë që shkaktoi një ulje të nivelit të këtij portofoli.

Grafik 98

Karakteristikat e portofolit deri në maturim në vitin 2017



\*HTM (Held-to-maturity) -letrat me vlerë deri në maturim  
Burimi: BPRM-së.

Norma e përgjithshme e kthimit të rezervës valutore në vitin 2017, e cila krahas të ardhurave të realizuara përfshinte edhe çmimet e përlogaritura si dhe ndryshimet e kursit të këmbimit që janë 0.55%, që është mesatarisht më e ulët në krahasim me vitin 2016 (0.72%).

## VII. Aktivitetet dhe zhvillimet në sistemet e pagesave dhe pagesës së shërbimeve

*Në vitin 2017, BPRM-së ndërmori aktivitete të shumta me të cilat theksoi angazhimin e saj për të përmirësuar më tej tregun e shërbimeve të pagesave dhe zhvillimin e infrastrukturës së pagesave në vend, si dhe integrimin e tyre me standardet evropiane. Në këtë kontekst, me gamën e ndryshme të aktiviteteve dhe projekteve të ndërmarra, BPRM-së realizoi me sukses rolin e saj operativ, mbikëqyrës, zhvillimor dhe katalizator në sferën e pagesave*

### 7.1. Aktivitetet nga ana e BPRM-së

**Që nga fillimi i vitit 2017, BPRM-së nëpërmjet sistemit të pagesave MIPS<sup>71</sup> u mundëson bankave që të kryejnë pagesat në euro (flukseve hyrëse dhe dalëse) në vend dhe jashtë vendit nëpërmjet sistemit të pagesave TARGET 2<sup>72</sup> të Eurosistemit.** Me mbivendosjen e MIPS-it në një platformë të vetme për pagesat në denarë dhe euro, BPRM-së i ka realizuar rekomandimet e dhëna nga Komisioni Evropian për Republikën e Maqedonisë dhe Raporti i Eurosistemit për të analizuar nevojat e Bankës, duke iu referuar krijimit të një kanali alternativ të rregullimit të korrespondencave bankare që lidhet me TARGET 2 dhe përkatësisht reduktimin e kostos së pagesave ndërkufitare. Përfitimet nga mënyra e re e pagesave (pagesa të shpejta, të besueshme dhe efikase me kosto më të ulët), BPRM-së i promovon në mënyrë aktive para sektorit bankar dhe kompanive maqedonase.

**Vendosja strategjike për harmonizimin kombëtar me legjislacionin evropian po zbatohet edhe në vitin 2017.** Drafti i rregullores së re për shërbimet e pagesave dhe sistemeve të pagesave janë transpozuar në dispozitat e Direktivës së shërbimeve pagesor 2 (2015/2366/EC), të parasë elektronike 2 (2009/110/EC) Direktiva mbi zgjidhjen e finalitetit (98/26/EC), Direktiva për llogaritë e pagesës (2014/92 /KE) dhe dispozitat përkatëse të tarifave dhe Rregullorja për zëvendësimin për transaksionet me kartela për pagesë (2015/751/EC) dhe Rregullorja për vendosjen e kërkesave teknike dhe të biznesit për transferet e kreditit dhe të borxheve të drejtpërdrejta në euro (260/2012/EC) në UE. Pritet që rregullorja e re do të sigurojë parasëgjithash konkurrencë më të madhe tek shërbimet e pagesave me hyrjen e institucioneve jobankare në treg (nëpërmjet futjes së zgjidhjeve të reja të pagesave), informacione të qarta dhe në kohë për përdoruesit e shërbimeve pagesore, nivel më të lartë të mbrojtjes së përdoruesve të shërbimeve pagesore, stabilitet më i madh i sistemeve të pagesave, një bazë solide ligjore për një integrim më të shpejtë të Republikës së Maqedonisë në BE dhe përfshirje në zonën (Single Euro Payment), të cilat do të japin një shkallë më të lartë përfshirjes pagesore të Republikës së Maqedonisë si dhe një shkallë më të madhe të harmonizimit me BE-në në fushën e pagesave.

<sup>71</sup>MIPS paraqet një sistem për shlyerjen e pagesave me vlerë të madhe dhe pagesat urgjente në denarë dhe euro në kohë reale në baza bruto (RTGS - Real Time Gross Settlement System)

<sup>72</sup>TARGET 2 - një sistem për shlyerjen e pagesave në euro në kohë reale në baza bruto, pronari dhe operatori i të cilit është Eurosistemi.



**Me aplikimin e kornizës së re të monitorimit, e bazuar në standardet e pranuar ndërkombëtarisht të njohura si "Parimet për infrastrukturë të tregjeve financiare", në vitin 2017, BPRM-së filloi me mbikëqyrjen e pjesëshme dhe të drejtpërdrejtë të sistemit të pagesave të KIBS-it,<sup>73</sup>ndërsa mbikëqyrja indirekte e operatorëve në sistemet e pagesave, është kryer në baza të rregullta.**

**Me qëllim të përparimit të funksionit të saj operativ në sferën e pagesave, BPRM-së ka implementuar një projekt banking-elektronik për kryerjen e qarkullimit pagesor ndërkombëtarë për nevojat e shtetit dhe organeve shtetërore.** Në këtë mënyrë, BPRM-së përmirëson cilësinë e shërbimeve që i ofron shtetit dhe autoriteteve shtetërore në fushën e qarkullimit pagesor ndërkombëtarë. Nevoja për përparim të shërbimeve, veçanërisht është e shprehur në kushtet e zhvillimit të vazhdueshëm të teknologjisë digjitale, e cila mundëson kryerjen e shpejtë dhe efikas të pagesave si dhe monitorimin e tyre.

**Për të arritur një nivel më të lartë të digjitalizimit të shoqërisë maqedonase dhe për të zvogëluar përdorimin e parave të gatshme, BPRM-së, Ministria e financave dhe përfaqësuesit e sektorit bankar përgatitën Draft - strategjinë për reduktimin e parave të gatshme në Republikën e Maqedonisë. Draft strategjia** përfshin një gamë të gjerë të masave të propozuara administrative, tregtare, arsimore dhe promovuese, me një afat kohor të përcaktuar dhe bartës të zbatimit të tyre. Zbatimi i strategjisë duhet të kontribuojë në përdorimin më të madh të instrumenteve të pagesave të parave jo të gatshme në mënyrë efikase dhe të besueshme, me qëllim ruajtjen e stabilitetit financiar dhe një sistemi bankar të shëndoshë. Në të njëjtën kohë, reduktimi i përdorimit të parave të gatshme do të kontribuonte në reduktimin e ekonomisë joformale dhe evazionit fiskal.

**Në korrik të vitit 2017, u organizua konferenca e dhjetë e jubileut për pagesat dhe infrastrukturën e tregut, me titull "Angazhimet në integrimin e pagesave në Evropë -inovacione dhe bashkëpunim".** Në konferencë, në praninë e një grupi profesional të folësve të shquar dhe përfaqësuesve të lartë të vendit dhe nga jashtë, u rishikuan tema të rëndësishme në sferën e pagesave në nivel global, evropian dhe kombëtar.

## **7.2. Volumi i qarkullimit pagesor**

**Shumat e përgjithshme të qarkullimit pagesor në vend në vitin 2017 shënuan rritje vjetore prej 9% dhe arritën nivelin prej 5,929.4 miliardë denarë, që është 9.6 herë më i lartë se PBB-ja nominale.** Nga këndvështrimi strukturor, shumica e vlerës së qarkullimit pagesor të përgjithshme bëhet përmes MIPS-it (60%), pasuar nga pagesat e realizuara në kuadër të sistemeve të brendshme të bankave (33%), KIBS-it (me rreth 6%), me skemat ndërkombëtare të karteleve (rreth 1%) si dhe CASCIS<sup>74</sup>, me një pjesëmarrje të vogël në totalin e pagesave. Në aspektin e numrit të transaksioneve, pjesa më e madhe e pagesave me para jo të gatshme janë bërë me kartelat e pagesave nga skemat e kartelave ndërkombëtare (38%), transfertat kreditore nga qarkullimi pagesor i brendshëm i bankave (27%) dhe KIBS (21%), ndërsa pjesa e mbetur është kryer nga kartelat pagesore të qarkullimit intern të bankave (10%) dhe transferimet kreditore përmes MIPS-it (4%). Krahasuar me vitin 2016, ndryshime të rëndësishme janë vërejtur në numrin e


<sup>73</sup>Shtëpia e kleringut "Sistemet ndërbankare të kleringut" SHA Shkup (KIBS) është operator i sistemit për shlyerjen neto të pagesave të vonuar multilaterale, për përpunimin e pagesave të vogla shuma e të cilave nuk i kalon 1.000.000,00 denarë.

<sup>74</sup>Sistemi i kartelës ndërkombëtare AD Shkup (CASCIS) përfaqëson një sistem për shlyerjen neto të pagesave të vonuara multilaterale të pagesave me markat vendase të kartelave pagesore.

përgjithshëm të transaksioneve të realizuara përmes skemave të kartelave ndërkombëtare, që kanë regjistruar një rritje të pjesës strukturore me 5.6 pikë përqindjeje në vitin 2017 (një rritje prej 32.4% në 38%), duke treguar rritjen e përdorimit të kartelave të kreditit për kryerjen e pagesave jo të gatshme.

Grafik 99

Volumi i qarkullimit pagesor



Burimi: BPRM-së.

**Për sa i përket kanalit të ri të themeluar rishtazi për ekzekutimin e pagesave të brendshme dhe ndërkufitare në euro përmes MIPS dhe TARGET2, në vitin 2017 vlera totale e pagesave të realizuara në euro nga MIPS-i arriti 343 milionë euro, ndërsa numri i përgjithshëm i pagesave të jashtme arriti në rreth 4.6 mijë transaksione. Nga aspekti i hyrjeve në euro, nëpërmjet TARGET2 dhe MIPS-it, janë realizuar rreth 0.5 mijë transaksione me një vlerë totale prej 303 milionë eurosh.**

### 7.3. Zhvillimet e pagesave jo të gatshme në Republikën e Maqedonisë

**Vlera totale e pagesave jo të gatshme<sup>75</sup> në vend në vitin 2017 shënoi rritje vjetore prej 9.6% dhe arriti në 3.483 miliardë denarë, që është më shumë se 5.6 herë më e lartë se PBB-ja nominale.** Këtë vit, shumica e vlerës së transaksioneve jo të gatshme (99%) është bërë përmes transfertave të kredive (me kontribut strukturor pothuajse të barabartë të transfertave të kredisë të iniciuara në letër ose në mënyrë elektronike) dhe vetëm 1% e vlerës është realizuar me përdorimin e kartave të pagesave.


Edhe pse pjesa e transaksioneve me kartelë pagesore në vlerën totale të transaksioneve jo në të gatshme është e ulët, vlera e realizuar me këtë instrument pagese përfaqëson 9% të konsumit personal në Republikën e Maqedonisë për vitin 2017. Analiza e strukturës së pagesave në tregti në Republikën e Maqedonisë tregon një preferencë të lartë për pagesat në para të gatshme, pavarësisht trendit të zvogëlimit të pranisë së pagesave në

<sup>75</sup>Transaksionet jo-cash u referohen transaksioneve të iniciuara me një urdhërpagesë - instrument pagese: transfertat e kredive, debitimet direkte, kartelat pagesore, transaksionet me përdorim të parasë elektronike, çeqet dhe instrumentet e tjera të pagesave. Në Republikën e Maqedonisë, debitë direkte ende nuk janë futur si një instrument pagese, ndërsa çeqet janë shfuqizuar në vitin 2007. Në të njëjtën kohë, pavarësisht mundësisë ligjore, nuk ekzistojnë transaksione që përdorin para elektronike. Andaj, në vlerën e përgjithshme të transaksioneve jo-cash përfshihen vetëm transfertat e kredive në pagesat e brendshme dhe pagesat me kartela pagesore të lëshuara në Republikën e Maqedonisë në operacionet e pagesave të brendshme (përfshijë transaksionet brenda sektorit të institucioneve financiare monetare).

para të gatshme në qarkullimin e përgjithshëm në tregti. Sipas vlerësimeve<sup>76</sup>, në vitin 2017, pjesëmarrja e pagesave me paratë gatshme në vlerën totale të transaksioneve në tregtinë me pakicë ishte 72%, krahasuar me 2016 (78%), ose 90% në vitin 2008. Ajo që është e rëndësishme është prania e një tendence të qartë dhe konstante të reduktimit të përdorimit të parave të gatshme në tregti në kurriz të rritjes së pagesave me para jo të gatshme. Përveç kësaj, vërehet një ndryshim në strukturën e numrit të transaksioneve me instrumente të pagesave jo të gatshme, më saktë rritja e pjesës së kartelave pagesore me 4 pikë përqindje, apo ulje e pjesës së transfereve kreditore të iniciuara në letër me 4 pikë përqindjeje, në bazë vjetore. **Numri i përgjithshëm i transaksioneve të realizuara me instrumente të pagesave me para jo të gatshme** për vitin 2017 arriti në 102 milionë, shumica e të cilave u realizuan me kartela pagesash (43%), ndërsa pjesa tjetër ishin transfertat kreditore të nisura në letër ose në mënyrë elektronike me një pjesëmarrje prej 33% dhe respektivisht 24%. Ky ndryshim tregon intensifikimin e trendit të përdorimit më të madh të karteleve pagesore nga popullata dhe kompanitë për realizimin e pagesave jo të gatshme në tregti.

Grafik 100

Pjesëmarrja e instrumenteve të pagesave në qarkullimin e përgjithshëm të jo-cash'it




Burimi: BPRM-së.

**Në vitin 2017, numri i përgjithshëm i transaksioneve me transfere kreditore arriti në 58.7 milionë.** Kështu që, pjesa strukturore e transfereve kreditore të realizuara në mënyrë elektronike, në numrin e përgjithshëm të transfereve kreditore ishte 42%. Numri më i madh i transaksioneve me transfere kreditore u realizuan nga subjektet juridike (71%), ndërsa pjesa tjetër lidhet me personat fizik.

<sup>76</sup> Gjatë interpretimit të rezultateve për pjesëmarrjen e pagesave në cash në transaksionet e përgjithshme tregtare, duhet marrë parasysh që vlerësimi i vëllimit të pagesave në para të gatshme është bërë në atë mënyrë që qarkullimi i përgjithshëm në tregtinë me pakicë, përveç tregtisë me automjete dhe motoçikleta, të largohet vlera e përgjithshme e transaksioneve të realizuara me kartelat pagesore në pikat e shitjes (fizike dhe virtuale). Meqë bëhet fjalë për një informacion të kryer (vlerësimi), ekziston paqartësi rreth saktësisë së rezultateve të fituara.

Grafik 101

Transferet kreditore (TK) si instrument pagese jo-cash për personat fizik (PF) dhe personat juridik (PJ)



Burimi: BPRM-së.

Në këtë mënyrë, personat juridik gjithnjë e më shumë përdorin shërbimet elektronike bankare në krahasim me personat fizikë (51% e numrit të transfereve kreditore janë iniciuar në mënyrë elektronike, ndërsa tek personat fizik janë iniciuar vetëm 20% në mënyrë elektronike, pjesa tjetër është e iniciuar në letër). Nga pikëpamja e pajisjes me të cilën janë iniciuar transferet elektronike të kredive, aplikacioni më i madh (gati 100%) për personat juridik ka një kompjuter personal, ndërsa personat fizikë gjithashtu shohin përdorim të moderuar të telefonave celularë dhe ATM-ve, me 7% dhe 1%. Kjo situatë mund të jetë një tregues i një ndryshimi gradual, por të sigurt në kulturën e pagesave në ekonominë vendase, duke përdorur përfitimet e pagesave elektronike. Megjithatë, të dhënat krahasuese tregojnë se RM-së ka pjesëmarrje të ulët strukturore në numrin e transaksioneve elektronike të iniciuara nga transferet kreditore (42.2%), në krahasim me vendet e vjetra anëtare të BE-së<sup>77</sup> dhe vendeve të CIJE-së<sup>78</sup>, ku pjesëmarrja e transfereve të iniciuara elektronike të kreditit brenda numrit të përgjithshëm të transaksioneve me transfertat kreditore është përkatësisht 90.8% dhe 86.4%<sup>79</sup>.

<sup>77</sup>Austria, Belgjika, Gjermania, Greqia, Danimarka, Irlanda, Italia, Anglia, Portugalia, Finlanda, Franca, Holanda, Suedia dhe Spanja.


<sup>78</sup>Bullgaria, Estonia, Qiproja, Letonia, Lituania, Polonia, Republika Çeke, Rumania, Sllovakia, Sllovenia, Hungaria dhe Kroacia.

<sup>79</sup>Të dhënat më të fundit në dispozicion për shtetet anëtare të BE-së kanë të bëjnë me vitin 2016.

**Vlera totale e transaksioneve me kartela pagesore, nga pikëpamja e vendndodhjes së pajisjeve (në vend dhe jashtë vendit) në vitin 2017, arriti në 213 miliardë denarë.** Për sa i përket qëllimit të përdorimit të kartelave të pagesave vendase dhe të huaja në pajisjet e vendosura në vend, kartelat e pagesave më së shumti janë përdorur për tërheqjen e parave të gatshme (përkatësisht 69% dhe 60%). Më tej, rezidentët përbënin 26% të vlerës së transaksioneve në vendet fizike të shitjes në vend, 4% për depozitimin e parave të gatshme në ATM dhe vetëm 1% për pagesat në internet (dyqanet virtuale për shitje). Sidoqoftë, në krahasim me performancat e kategorive të njëjta për vitin 2016, ka një pjesëmarrje strukturore të zvogëluar në përdorimin e kartelave të pagesave për tërheqjen e parave në ATM dhe rritjen e përdorimit të kartelave të pagesave në vendet fizike të shitjes (përkatësisht 3 pikë përqindjeje). Ndryshime të ngjashme u bënë edhe me jorezidentët të cilët përdorën kartela të pagesave të huaja në pajisjet e brendshme, duke bërë 39 % të vlerës së transaksionit në vendet fizike për shitje, 60 % për tërheqjen e parave në ATM dhe 1 % për pagesat në internet krahasuar me 2016 vit kur përqindja e aksioneve ishte 37%, 62% dhe 1% respektivisht. Në të njëjtën kohë, rezidentët kanë përdorur relativisht më tepër kartelat vendore për pagesa jashtë vendit për transaksione në vendet fizike të shitjes (55% në vitin 2017, krahasuar me 52% në vitin 2016), në kurriz të reduktimit relativ të tërheqjes së parasë së gatshme.

Grafik 102

Pjesëmarrja e transaksioneve me kartela pagesore në vlerën e përgjithshme



Burimi: BPRM-së.

#### 7.4. Infrastruktura pagesore e cila përkrah pagesat digjitale

**Numri i përgjithshëm i llogarive transaksionale në Republikën e Maqedonisë në fund të vitit 2017 arriti rreth 3.860.000 llogari që regjistroi rënie të moderuar vjetore prej 0.18%.** Pjesëmarrja e numrit të llogarive në dispozicion për fillimin e pagesave elektronike në vitin 2017 shënoi një rritje të lehtë në krahasim me vitin 2016 dhe përbënin rreth 8% të numrit të përgjithshëm të llogarive transaksionale, duke treguar përdorimin e kufizuar të kanaleve bankare digjitale për të kryer pagesat. Nga ana tjetër, numri i kartelave kontaktuese dhe jokontaktuese në vitin 2017 është rritur gati dy herë në vit dhe arriti një pjesëmarrje prej 27.3% në numrin e përgjithshëm të kartelave me funksion pagese (1.8 milionë kartela në qarkullim). Numri i pajisjeve të instaluar në pikat e shitjes që mbështetin kartat teknologjike me kontakt dhe pa kontakt gjithashtu shënoi rritje

në pjesëmarrjen e saj në numrin e përgjithshëm të pajisjeve për transferimin elektronik të mjeteve në vendet fizike të shitjes me 15 p.p. në baza vjetore dhe arriti në 49.4% në fund të vitit 2017. Trendi i rritjes së vendosjes dhe përdorimit të pajisjeve digjitale moderne për të bërë pagesa konfirmohet nga rritja e numrit të ATM-ve me funksion shtesë për fillimin e transferimit të kredive në vitin 2017 (rritje vjetore prej 9.4%). Përveç kësaj, vërehet një tendencë që bankat të reduktojnë kohën e pritjes në sportelet e bankave që punojnë me

Tabela 3  
Infrastruktura pagesore

	2016	2017
<b>Llogaritë e transaksioneve</b>	<b>3,865,479</b>	<b>3,858,644</b>
Llogaritë në dispozicion për inicim të pagesave elektronike	261,266	324,319
<b>Gjithsej kartelat me funksion pagese</b>	<b>1,818,676</b>	<b>1,821,997</b>
<i>sipas teknologjisë së pagesës</i>		
me kontakt / pa kontakt	252,851	498,199
Internet	18,764	19,337
<b>Bankomatet</b>	<b>1,039</b>	<b>1,031</b>
Me funksion të deponimit të parave të gatshme	86	256
Me funksion të transferit kreditor	256	280
<b>Pajisje për transfer elektronik të mjeteve në vende fizike të shitjeve</b>	<b>34,826</b>	<b>31,995</b>
me kontakt / pa kontakt	12,056	15,807
<b>Pajisje me vende virtuale të shitjeve (internet-vende shitëse)</b>	<b>711</b>	<b>832</b>

Burimi: BPRM-së.

pagesa në para të gatshme, si dhe operacionet manuale të stafit në sportele, duke rritur vazhdimisht numrin e ATM-ve me një funksion të depozitimit në para (118 ATM me një funksion për të depozituar para në vitin 2017 që krahasuar me vitin 2016 ky numër arrinte në 86). Në anën tjetër, në vitin 2017 pajisjet për transferimin elektronik të mjeteve në vendet fizike të shitjes - терминалет POS, regjistruan një rënie vjetore prej 8.1%, që është rrjedhojë e procesit të optimizimit të kostove të pajisjeve për transferimin elektronik të mjeteve në vende të shitjes, që përfshinë zëvendësimin e terminaleve të vjetra me POS terminale të reja, me terminale POS më moderne, e me këtë edhe zvogëlimin e numrit të terminaleve POS në mesin e shitësve. Në fund të vitit 2017, numri i përgjithshëm i tregtarëve në vend që pranonin kartelat ishte 12.817. Shumica e shitësve me pakicë (11.899) që pranojnë pagesa në vende fizike për shitje me 92.8%, të ndjekur nga shitësit me pakicë që pranonin pagesa për shitjet virtuale (719) ose 5.6%, ndërsa pjesa tjetër (199) përbëhej nga tregtarët që pranonin pagesa në pajisje të tjera (sistemet e mbledhjes së shpejtë<sup>80</sup> dhe ofruesit e shërbimeve të mikropagesave<sup>81</sup>) ose 1.6% të numrit të përgjithshëm të tregtarëve.

<sup>80</sup>Sistemi i pagesës (grumbullimit) të shpejtë është një teknologji inovative që mundëson, nëpërmjet pajisjeve të përshtatshme të bëj pagesa më të shpejta të parave të gatshme dhe jo të gatshme për lloje të ndryshme shërbimesh (pagesa e faturës së ujit, taksën e radiodifuzionit, TV kabllorikun, celularit, sigurimit, shkollimit etj.).


<sup>81</sup>"Mikropagesat" janë " pagesa të produkteve dhe shërbimeve në një shumë të vetme jo më të madhe se 1.000 denarë, me ç'rast pëlqimi për të bërë pagesën bëhet përmes mjeteve të telekomunikacionit, pajisjeve digjitale ose informative-teknologjike.

## VIII. Lëshimi dhe menaxhimi i kartëmonedhave dhe monedhave të Republikës së Maqedonisë- operacionet e thesarit

### 8.1. Paratë e lëshuara në qarkullim

Më 31 dhjetor 2017, shuma e përgjithshme e parave të lëshuara në qarkullim është 36.208 milionë denarë dhe krahasuar me fundin e vitit 2016 ato u rritën me 1.783 milionë denarë ose 5.18%<sup>82</sup>. Struktura e parasë në qarkullim tregon se në fund të vitit, kartëmonedhat tregojnë se në fund të vitit, kartëmonedhat përbëjnë 96.4% dhe monedhat 3.6% të vlerës së përgjithshme. Nga aspekti i numrit të parave të lëshuara në qarkullim, pjesëmarrja e parasë bankare është 22.6% (73.6 milionë copë) dhe monedha 77.4% (251.6 milionë copë).


Grafik 103  
Paratë e lëshuara në qarkullim



Burimi: BPRM-së.

Kartëmonedhat me emërtim 1000 denarë (68.1%), 500 denarë (13.1%) dhe 2000 denarë (12.8%) zënë pjesëmarrjen më të madhe në vlerën e përgjithshme të emetimit të kartëmonedhave. Kartëmonedhat e mbetura përbëjnë 6.0% të vlerës së përgjithshme. Në vitin 2017, vlera më e madhe në vlerë të arkës kanë prerjet prej 50 denarë (35.9%), 10 denarë (33.8%) dhe 5 denarë (13.2%).


Grafik 104



Burimi: BPRM-së.

<sup>82</sup>Në të dhënat e paraqitura për paratë e lëshuar në qarkullim, nuk përfshihen sasi dhe vlera e monedhave për qëllime kolektive, që BPRM-së për arsye artistike, kulturore dhe promovuese i përgatiti dhe lëshoi në qarkullim. Monedhat për qëllime kolektive janë në dispozicion kryesisht jashtë vendit, por edhe në Republikën e Maqedonisë. Vlera e monedhave për qëllime kolektive në qarkullim, më 31 dhjetor 2017, arriti në 7.5 milionë denarë.

Grafik 105



Burimi: BPRM-së.

Në strukturën e parave të lëshuara në qarkullim sipas numrit të copave, kartëmonedhat kanë pjesën më të madhe në emërtimin e 1000 (32.3%), 10 (26.8%) dhe 100 (20.2%) denarë. Kartëmonedhat e mbetura përbëjnë 20.7% të totalit të kartëmonedhave në qarkullim. Pjesëmarrje më të madhe në monedhat e emetuara gjithsej ka prerja prej 1 denarë (38.7%).

Gjatë vitit 2017, u punua në përmirësimin e cilësisë së parave në qarkullim, duke iu referuar veçanërisht tendencave aktuale në mënyrën e flukseve të mjeteve monetare në para me vlerë nominale prej 10 dhe 50 denarë. Analizat gjithëpërfshirëse dhe dobësitë e identifikuar kanë imponuar nevojën për të gjetur një zgjidhje alternative të përshtatshme, e cila do të eliminojë lëvizjet specifike të cilat kryesisht janë të njëanshme në monedha dhe do të racionalizojnë dhe optimizojnë procesin e furnizimit me këto prerje. Për këtë qëllim, BPRM-së vendosi të aplikojë një koncept të ri që do të zëvendësojë monedhat ekzistuese me paratë e letrës të bëra nga polimeri si një alternativë e besueshme ndaj parave letre dhe një trend veçanërisht aktual, që shumë banka qendrore tashmë e kanë futur për paratë që kanë një vlerë nominale më të ulët dhe një frekuencë më të lartë në qarkullim.


## 8.2. Furnizimi i bankave dhe qendrave të parasë me kartëmonedha dhe monedha

Gjatë vitit 2017, BPRM-së lëshoi qendra të mjeteve monetare dhe të holla<sup>83</sup> në vlerë prej 36,108 milionë denarë (një rënie prej 2,1% krahasuar me 2016). Në të njëjtën kohë, janë pranuar para të gatshme nga bankat dhe qendrat e parasë në vlerë prej 34,312 milionë denarë (ulje prej 0,2% krahasuar me vitin 2016). Analiza e strukturës sipas emërimit të kartëmonedhave dhe monedhave tregon se në lëshimin dhe gjatë marrjes, në paratë prej letre një pjesëmarrje më e madhe vërehet në emërtimin prej 1000 denarë nga 38.2% në vitin 2017 (d.m.th. 38.7% në vitin 2016) kurse në monedhat mbizotëron emërtimi prej 10 denarësh, me një pjesëmarrje prej 39.0% në vitin 2017 (krahasuar me 37.8% në vitin 2016).

<sup>83</sup>Gjatë vitit 2017, qendra e dytë për para të gatshme (kompani e cila i plotëson kushtet për kryerjen e furnizimit me të holla – (cash), që është regjistruar në vitin 2016, në mënyrë aktive ishte e përfshirë në procesin e furnizimit me të holla (cash), që pa dyshim nga puna u rritën ndikimet e tregut në këtë segment dhe mundësoi krijimin e kushteve të shëndetshme konkurruese, rritjen e cilësisë së shërbimeve të parasë dhe rruajtjen e nivelit standard të parave cilësore në qarkullim. Në periudhën vijuese, pritet intensifikimi i aktiviteteve të qendrave të parasë në sistemin e arkëtimit operacional përmes shpërndarjes rajonale të mbështetjes së infrastrukturës operacionale.



Grafik 106



Burimi: BPRM-së.

### 8.3. Përpunimi dhe shkatërrimi i kartmonedhave dhe monedhave

Gjatë vitit 2017, në procesin e kontrollit të cilësisë së kartmonedhave që ishin në qarkullim, të gjitha kartmonedhat e pranuar u përpunuan. Nga numri i përgjithshëm prej 54.2 milionë copave të përpunuara, 16.7 milionë copë (12.1 milionë kartmonedha në 2016) u shkatërruan për shkak të pamjaftueshmërisë së qarkullimit. Emërtimet e 100 dhe 10 denarëve (58.2%) zënë pjesën më të madhe në kartmonedha të shkatërruara. Në 2017, 9.7 milionë copë monedha u përpunuan në emërtimet e 1, 2, 5, 10 dhe 50 denarë, nga të cilat 295.5 mijë copë u tërhoqën si të papërshtatshme për qarkullim.

### 8.4. Ekspertizë për paratë e dyshimta / të falsifikuara


Në kuadër të përgjegjësisë së tij si autoriteti i vetëm për përcaktimin e origjinalitetit të kartmonedhave dhe monedhave të shprehura në denarë dhe në monedha të huaja, Banka Qendrore gjatë 2017 me sukses e realizoi funksionin për ekspertizë të parave të falsifikuara. Me qëllim të përforsimit të kapaciteteve për të zbuluar me saktësi paratë e dyshimta dhe të falsifikuara në subjektet që operojnë të holla ditore, Banka Qendrore gjatë vitit 2017 vazhdoi me trajnimet e specializuara të stafit në Banka dhe qendra për të holla. Përmes prezantimeve dhe trajtimit të drejtpërdrejtë të parave autentike dhe të falsifikuara, pjesëmarrësve ju transmetua ekspertizë profesionale që do të zbatonin në ekzekutimin e mëtejshëm të aktiviteteve.

Sa për numrin e hetimeve të kryera gjatë vitit 2017, nga totali i dorëzuar prej 485 kartmonedha të dyshimta të shprehura në denarë, gjatë ekspertizës profesionale u vërtetua se 83 mostra janë origjinale, ndërsa 402 mostrat e mbetura ishin të falsifikuara. Numri i kartmonedhave të falsifikuara të zbuluara gjatë vitit 2017 ishte më e ulët me 53% në krahasim me 2016. Në numrin e përgjithshëm të kartmonedhave të falsifikuara të denarit në vitin 2017, më së shpeshti është emetimi i 500 denarëve (231 copë) ose 57.5% të numrit të përgjithshëm të falsifikimeve<sup>84</sup>, e ndjekur nga emetimi 1000 denarë (106 copë) ose 26.4% të numrit të përgjithshëm të falsifikimeve dhe emetimi i 100 denarëve (55 copë), ose 13.7% të numrit të përgjithshëm të falsifikimeve. Vlera e përgjithshme e denarëve të falsifikuar në vitin 2017 është 231.660,00 denarë dhe ka peshë të parëndësishme në raport me vlerën e përgjithshme të parave në qarkullim.


<sup>84</sup>Pjesa më e madhe në numrin e kartmonedhave të falsifikuara ka emërtimin prej 500 denarë, që ekskluzivisht është për shkak të faktit se akoma dorëzohen mostra të cilat u organizuan, u liruan në qarkullim gjatë viteve të kaluara.

Grafik 107

Rishikimi i denarëve të falsifikuar



Rishikimi i parave të huaja të falsifikuara



Burimi: BPRM-së.

Sa i përket ekspertizës së kryer të kartëmonedhave dhe monedhave të dyshimta të paraqitura në monedhë të huaj në vitin 2017, nga 605 analiza të bëra rezultuan 600 para të falsifikuara dhe 5 para origjinale. Në numrin e përgjithshëm të parave të falsifikuara të letrës, më të zakonshmet janë kartëmonedhat në euro (553 copë) dhe dollarët amerikanë (26 copë).

Ndryshe nga viti i kaluar, kur u zbuluan sasi të mëdha të monedhave të falsifikuara në valutë të huaj (1001 copë), këtë vit numri i tyre është zvogëluar disa herë dhe përbën gjithsej 7 monedha të falsifikuara në euro.

Vlerësimi i përgjithshëm është se paratë-letra dhe monedhat e falsifikuara kanë cilësi relativisht të dobët të prodhimit, gjë që mundëson zbulimin e thjeshtë dhe të lehtë dhe përcaktimin e karakteristikave të tyre<sup>85</sup>.

### 8.5. Kontrolli i zbatimit të standardeve dhe kriterëve për operacionet e "cash-it" me bankat dhe qendrat e parasë

Me qëllim të zbatimit të plotë të standardeve dhe kriterëve të parashikuara për ngritjen e cilësisë dhe mbrojtjes së integritetit të njësisë monetare vendase, BPRM-së në këtë periudhë forcoi ndjeshëm aktivitetet e saj të kontrollit në bankat dhe qendrat e parasë duke kryer kontrole të drejtpërdrejta dhe të tërthorta në veprimtarinë e tyre. Po ashtu, BPRM-së gjithashtu kryen testime të rregullta, gjegjësisht kontrole mbi karakteristikat funksionale të makinave për përpunimin e kartëmonedhave dhe monedhave, si dhe trajnimin e punëtorëve nga bankat dhe qendrat e parasë për përpunimin manual të parave dhe kthimin e tyre në qarkullim.

Duke sublimuar efektet e këtyre aktiviteteve, pritjet e BPRM-së për të krijuar një sistem të qëndrueshëm të furnizimit me para dhe mbajtjen e një cilësie të caktuar standarde të kartëmonedhave dhe monedhave në qarkullim padyshim që janë konfirmuar.

<sup>85</sup>Gjatë ekspertizës së teknikës për përpunimin e kartëmonedhave të falsifikuara, u konstatua se ato ishin kryer kryesisht me letër të zakonshme, pa elemente të mjaftueshme mbrojtëse, duke përdorur teknologjinë kompjuterike (skanim dhe shtypje) ose duke përdorur një fotokopjues me ngjyrë.

## 8.6. Shitjet e monedhave për qëllime koleksionimi

Monedhat për qëllime të mbledhjes janë unike, mostra përfaqësuese, me vlerë të jashtëzakonshme artistike dhe si pasojë të kontribuojnë në promovimin e Republikës së Maqedonisë jashtë vendit. Edhe pse fillimisht shitja e monedhave për qëllime të grumbullimit destinohet dhe zhvillohet jashtë vendit, interesi thelbësor për ta vërehet edhe në vend.

Gjatë vitit 2017, BPRM-së e pasuroi me njoftime të reja tashmë koleksionin e pasur të monedhave për qëllime grumbullimi, ku si më e rëndësishme mund të theksohet nxjerrja në qarkullim e monedhës me rastin e shënimit të 50 vjetorit të Akademisë së shkencave të Republikës së Maqedonisë.

Në 2017, u shitën gjithsej 603 mostra të monedhave për qëllime koleksioni, nga të cilat 494 copë u shitën përmes BPRM-së, kurse 109 copë u shitën nga ana e komisionerit<sup>86</sup>.

---

<sup>86</sup>Për shkak të rritjes së interesit për këto monedha dhe mundësisë për një disponimi më të madh për furnizim, BPRM-së ka lidhur një marrëveshje me Institutin Kombëtar "Shtëpia Përkujtimore e Nënë Terezës", Shkup, për shitjen e këtyre monedhave.

## **IX. Kryerja e mbikëqyrjes dhe supervizionit**

Gjatë vitit 2017, në përputhje me Planin vjetor të kontrollit, BPRM-së ka kryer kontrolle të rregullta mbikëqyrëse (kontrolle në terren për vlerësimin e rrezikut) në 14 banka dhe një kompani për shërbime ndihmëse për sistemin e informacionit, si dhe kontrollet e inspektimit (kontrollet në terren të pajtueshmërisë me rregulloret) në 15 banka, 2 shtëpi kursimi, në 3 ofrues të transferitmit të shpejtë të parave, 22 nën-agjentë dhe 156 kontrolle në këmbimore të autorizuara.

### **9.1. Kontrollet në terren të rreziqeve**

Bankat në Republikën e Maqedonisë janë të përqendruara në aktivitetet tradicionale bankare dhe rreziku i kredisë në pjesën më të madhe përcakton profilin e tyre të rrezikut<sup>87</sup>. Prandaj, ky rrezik, sidomos cilësia e menaxhimit të saj, me një theks të veçantë në përshtatshmërinë e përcaktimit të humbjeve nga zhvlerësimi, si dhe niveli i ekspozimit, është më shpesh subjekt i vlerësimit me kontrollet në terren. Po ashtu, në periudhën raportuese, tek disa banka individuale u vlerësua përshtatshmëria e sistemit të pastrimit të parave, menaxhimi i rrezikut operacional si dhe saktësia e raporteve mbi transaksionet e kryera me personat e lidhur me bankën. Në periudhën raportuese, u vlerësua përshtatshmëria e sigurisë së informacionit në 6 banka. Gjithashtu, në kuadër të kontrolleve në terren të rreziqeve, tek 3 bankat komerciale u përfshi kontrollimi i saktësisë së raporteve për sa i përket mjaftueshmërisë së kapitalit.

Kontrollet e kryera tregojnë se bankat kryesisht menaxhojnë rreziqet ndaj të cilave ata janë të ekspozuar dhe kryesisht përgjigjen ndaj masave korigjuese të rekomanduara nga BPRM-së.

Me qëllim të përmirësimit të rregullave dhe praktikave të përcaktuara për menaxhimin e rrezikut të kredisë me bankat, nga ana e BPRM-së jepen disa rekomandime që kanë të bëjnë kryesisht me: përmirësimin e procesit të klasifikimit të ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë në kuptim të ndikimit më të madh në aftësinë kreditore dhe përfshirjen e treguesit për paralajmërim të hershëm, reduktimin e ekspozimit të klientëve individual brenda limiteve të ekspozimit të përcaktuara ligjërisht si dhe menaxhimin e duhur, zvogëlimin e rrezikut të përqëndrimit, monitorimin më të shpeshtë të klientëve me rrezik më të lartë kreditor, zgjerimin e procesit të identifikimit të palëve të ndërlidhura dhe menaxhimin e kredive të miratuara me përjashtime. Për më tej, duke analizuar mostrën e zgjedhur të ekspozimeve ndaj rrezikut kreditor, është përcaktuar kategori e papërshtatshëm e rrezikut nga aspekti i zbatimit të kriterëve të përcaktuara në përputhje me rregulloren, kështu që tek 9 bankat është përcaktuar rezervim i kapitalit. Përveç kësaj, është dhënë edhe sugjerim për përmirësimin e procesit të menaxhimit të kredive me probleme duke krijuar një strategji afatmesme e cila do të përfshijë një plan për "marrëveshje" me ekspozimet jofunksionale, identifikimi në kohë për nevojën e ristrukturimit të ekspozimeve kreditore të miratuara, si dhe për të përforcuar procesin e monitorimit të kësaj pjese të portofolios kreditore. Në segmentin "familje", janë dhënë rekomandime për përforcimin e kriterëve për miratimin e ekspozimeve ndaj rrezikut të kredisë, kontrollet e brendshme dhe përcaktimin e limiteve për miratimin e ekspozimeve si përjashtim. Një pjesë e bankave identifikuan nevojën për të përmirësuar testimin e stresit dhe për të rritur aktivitetet e Departamentit të auditimit të brendshëm.

---

<sup>87</sup>Analiza e rreziqeve në sektorin bankar përfshihet në Raportin mbi rreziqet në sektorin bankar në vitin 2017.

Sa i përket masave dhe veprimeve të ndërmarra nga bankat për parandalimin e larjes së parave dhe financimit të terrorizmit, rekomandimet janë dhënë për: forcimin e masave për identifikimin dhe verifikimin e identitetit të pronarit real të klientit, përmirësimin e përmbajtjes së analizave të klientit duke përcaktuar konsistencën transaksionet me aktivitetin e tij dhe gjendjen financiare dhe perceptimin e nevojës për raportimin e tij në Drejtorinë e zbulimit financiar, zgjerimin e grupeve të treguesve të krijuar për të njohur transaksionet e pazakonta, forcimin e kontrolleve të brendshme dhe shtrirjen e fushëveprimit të kontrollit të kryer nga shërbimi i auditimit të brendshëm.

Në vlerësimin e menaxhimit të rrezikut operacional, jepen rekomandime për përmirësimin e procesit të identifikimit, matjes dhe monitorimit të këtij rreziku. Rekomandimet i referohen përcaktimit të limiteve për treguesit kryesorë të rrezikut, duke përcaktuar një humbje minimale, duke përmirësuar regjistrimin e ngjarjeve të dëmshme me bankat dhe duke përmirësuar metodën e vetëvlerësimit të bankave. Gjithashtu, jepen rekomandime lidhur me sigurinë fizike, si dhe nevojën për të rritur burimet për menaxhimin e këtij rreziku.

Në mënyrë që të rritet siguria e informacionit, janë dhënë rekomandime për kufizimin e qasjes në bazat e të dhënave dhe forcimin e sistemit të gjurmës së auditimit, përmirësimin e konfigurimit të sistemit, përmirësimin e mbrojtjes së konfidencialitetit të sistemeve të IT-së, përmirësimin e planit të vazhdimësisë së biznesit, përmirësimin e procesit të testimit të funksioneve ekzistuese gjatë ndryshimeve në aplikime, përgatitjen e një strategjie për zhvillimin e sistemit të informacionit.

## **9.2. Kontrollat në terren në përputhshmëri me rregulloret**

Fokusi i kontrollit në terren për vlerësimin e përputhshmërisë me rregulloret vihet në vlerësimin e veprimtarisë së bankave dhe të kursimoreve në pajtim me Ligjin për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë, Ligjin mbi veprimtarinë e këmbimeve valutore, Ligjin për mbrojtjen e konsumatorit në marrëveshjet e kredisë konsumatore, Ligjin për shërbime të transferimit të shpejtë të parave dhe Ligjin mbi qarkullimin pagesor. Tek të gjitha njësitë e kontrolluara është konstatuar se kryesisht po punojnë në përputhje me rregulloret. Në disa banka janë konstatuar parregullsi në qarkullimin pagesor ndërkombëtar, në operacionet me llogaritë jorezidenciale, si dhe në zbatimin e Ligjit për mbrojtjen e konsumatorit në kontratat për kredi konsumatore.

Kontrollet në terren ndaj institucioneve jo-bankare financiare, respektivisht kembimoret e autorizuara, ofruesit e shërbimeve për transfer të shpejtë të parave dhe sub agjentëve tyre kanë për qëllim të japin vlerësimin e përputhshmërisë së veprimtarisë së tyre me Ligjin e këmbimeve valutore, Ligjin për transferimin e parave dhe Ligjin për parandalimin e larjes së parave dhe financimin e terrorizmit. Në përgjithësi, edhe në këto institucione është vërtetuar puna në pajtueshmëri me rregulloret.

### 9.3. Përfundim

Gjatë kësaj periudhe është bërë përmirësimi i metodologjive të brendshme për vlerësimin e llojeve të rreziqeve të veçanta, duke i harmonizuar ato me standardet e Bazelit për mbikëqyrjen bankare dhe metodologjinë e aplikuar nga Banka Qendrore Evropiane në kryerjen e funksionit të saj mbikëqyrës. Në të njëjtën kohë, u rishikua edhe Metodologjia për përgatitjen e procesverbalit nga kontrolli në terren.

BPRM-së në mënyrë aktive merr pjesë në disa aktivitete që kanë të bëjnë me luftën kundër larjes së parave dhe financimit të terrorizmit, me çka është krijuar bashkëpunim me institucionet tjera relevante në Republikën e Maqedonisë. Në bazë të bashkëpunimit të realizuar, u hartua Strategjia Kombëtare për luftën kundër larjes së parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe Draft udhëzimet për përcaktimin e pronarit real të klientit.

### 9.4. Licencimi i bankave dhe kursimoreve në vitin 2017

Në suaza të aktiviteteve të rregullta në pjesën e licencimit të bankave dhe kursimoreve në përputhje me Ligjin për bankat, gjatë vitit 2017 nga ana e BPRM-së u përpunuan 58 kërkesa për dhënien e lejes për punë. Kërkesat gjatë vitit janë treguar në tabelën vijuese.

Tabela 4

Kërkesa të rishikuara për dhënie të pëlqimit paraprak në vitin 2017

<b>Lloji i lejes/pëlqimit (në banka)</b>	<b>Të lëshuara</b>	<b>Të refuzuara</b>	<b>Të ndaluara</b>
Pëlqim për marrjen e aksioneve në bankë	/	/	1
Pëlqim për fillimin e kryerjes së aktivitetit financiar	1	/	/
Pëlqimi për të ndryshuar dhe plotësuar statutin	12	/	1
Pëlqimi për të emëruar anëtar të Bordit mbikëqyrës	23	/	3
Pëlqim për emërim anëtari të Bordit të drejtorëve	12	/	1
Pëlqim për përfshirjen e një instrumenti kapital në kapitalin e rregullt themelor	1	/	/
<b>Lloji i lejes/pëlqimit (në kursimore)</b>	<b>Të lëshuara</b>	<b>Të refuzuara</b>	<b>Të ndaluara</b>
Pëlqimin për të emëruar një udhëheqës	2	/	/
Pëlqim për kursimore për t'u shndërruar në një institucion financiar	1	/	/
<b>Gjithsej</b>	<b>52</b>	<b>/</b>	<b>6</b>

Burimi: BPRM-së.

## X. Statistika

Të dhënat statistikore zyrtare të përgatitura nga ana e BPRM kanë për qëllim të informojnë publikun për kushtet dhe lëvizjet financiare dhe makroekonomike të ekonomisë, si dhe marrëdhëniet e saj me pjesën tjetër të botës.

Gjatë vitit 2017, BPRM-ja zbatoi vazhdimisht aktivitete për arritjen e përcaktimit strategjik në fushën e statistikave, të cilat sigurojnë të dhëna statistikore cilësore, të harmonizuara plotësisht me standardet statistikore ndërkombëtare dhe evropiane. Kështu, si më parë, gjatë mbledhjes së të dhënave u morr parasysh barra e raportimit, si dhe publikimi efikas, në kohë dhe i thjeshtë i të dhënave.

Ajo që shënon vitin 2017 në fushën e statistikave është kontributi i rëndësishëm në statistikatat e llogarive financiare. Me fjalë tjera, për herë të parë deri tani është kryer një transmetim zyrtar i të dhënave për llogarinë financiare në Eurostat, si rrumbullakim i të gjitha aktiviteteve komplekse të ndërmarra gjatë një periudhe më të gjatë kohore. Transmetimi paraqet një hap të rëndësishëm përpara, drejt harmonizimit të mëtejshëm me kërkesat evropiane, si një nga përcaktimet strategjike të BPRM-së. Gjithashtu, gjatë vitit 2017, pandalshëm u zhvilluan aktivitete të rregullta që vazhdimisht përmirësojnë cilësinë dhe detajet e statistikave të jashtme dhe monetare dhe komunikimi me publikun përmes publikimit të të dhënave statistikore dhe njoftimeve për shtyp.

Sa i përket aktiviteteve më konkrete, në vitin 2017 përparimi në statistikë u arrit në fushat e mëposhtme:

- në fushën e statistikave të llogarive financiare është përgatitur një dokument metodologjik dhe një seri kohore e detajuar e të dhënave për periudhën 2013-2015, për të gjithë sektorët dhe nënsektorët institucionalë, në përputhje me kërkesat e standardit të fundit statistikor ESA 2010<sup>88</sup>. Në dhjetor 2017, në përputhje me afatet kohore të parashikuara në Programin e Transmisionit ESA 2010, BPRM për herë të parë ka kryer transmetimin e të dhënave për llogaritë - kushtet financiare<sup>89</sup>, në një bazë të pakonsoliduar, tek Eurostat. Po ashtu, për herë të parë janë përgatitur të dhëna të hollësishme mbi flukset e mjeteve dhe detyrimeve financiare për sektorin "shtetëror" për vitin 2014 dhe 2015, si një nga komponentët hyrëse kryesore për hartimin e tabelave për borxhin dhe deficitin e tepruar;

- në fushën e statistikave të jashtme, është punuar në përmirësimin e përfshirjes dhe cilësisë së të dhënave, por gjithashtu në pasurimin e të dhënave që janë në dispozicion. Për të përmirësuar metodologjinë e vlerësimit të transfertave private në bilancin e pagesave është punuar për identifikimin dhe shqyrtimin e zgjidhjeve alternative të pranueshme për vlerësimin e sasisë reale të hyrjeve nga jashtë duke marrë parasysh rezultatet e disponueshme nga sondazhet e kryera dhe hyrjet e regjistruara nëpërmjet kanaleve zyrtare. Bazuar në të dhëna shtesë, kryesisht nga EShS, janë ndërmarrë aktivitete për vlerësimin e eksportit të peregjistruar të mallrave dhe shërbimeve, ekonominë gri, hyrjet dhe daljet në udhëtim dhe të tjera;

- në kuadër të aktiviteteve për përmbushjen e kërkesave të Bashkimit Evropian për paraqitjen e të dhënave më të hollësishme për Eurostat dhe organizatat tjera ndërkombëtare dhe përdoruesit e jashtëm, u vazhdua me projektin afatgjatë për ndërtimin e një depoje të të dhënave statistikore për nevojat e statistikave të jashtme,

<sup>88</sup> Sistemi Evropian i Llogarive ESA 2010 (European System of Accounts ESA 2010).

<sup>89</sup> Të dhënat trajtohen në mënyrë eksperimentale, derisa të arrihet qëllimi dhe detaji i përshtatshëm për botimin e tyre.

me të cilin do të mundësohet edhe menaxhimi optimal me bazat e të dhënave statistikore në BPRM;

- në fushën e statistikave të letrave me vlerë dhe për nevojat e statistikave të jashtme nga aspekti i shqyrtimit të mënyrës së mbulimit të këtyre transaksioneve në burimet ekzistuese të të dhënave në BPRM, janë bërë dy analiza, edhe atë: për tregtimin e letrave me vlerë brenda kornizave të projektit për lidhjen rajonale të bursave të letrave me vlerë (përmes të ashtuquajturës SEE link platformë) dhe për tregtimin me derivatet financiare. Njëherit, me promovimin e këtyre statistikave krijohen parakushte për pasurimin e burimeve të të dhënave dhe përmirësimin e cilësisë së statistikave të llogarive financiare, për të cilat gjatë vitit 2017 u punua në vendosjen metodologjike dhe automatizimin e raporteve sipas llojit të letrave me vlerë të cilat janë në pronë të banorëve;

- në fushën e statistikave monetare është bërë harmonizimi i mëtejshëm me standardet më të fundit ndërkombëtare. Sipas Manualit të fundit të FMN-së për statistikave monetare nga viti 2016, është përpunuar një seri kohore e re e të dhënave monetare e përcaktuar me një ndarje më të mirë sektoriale dhe monetare të instrumenteve financiare dhe një metodologji të re për furnizimin e parasë, e cila do të publikohet gjatë vitit 2018. Në të njëjtën kohë, në kuadër të projektit afatgjatë për krijimin e një sistemi të integruar të raportimit për nevojat e statistikave dhe mbikëqyrjes, janë ndërmarrë disa aktivitete për harmonizimin e diapazonit të të dhënave monetare, në përputhje me rekomandimet e BQE dhe rregulloret e reja të Bashkimit Evropian për statistikave të bilanceve dhe statistikave si dhe kërkesat e reja të ESA 2010;

- Në kuadër të angazhimit strategjik për të përmirësuar cilësinë e komunikimit me raportuesit, janë ndërmarrë disa aktivitete. Në baza të rregullta, komunikimi u krye me reporterët dhe u organizuan trajnime të rregullta për mënyrën e raportimit. Për të zvogëluar barrën e raportimit dhe për të racionalizuar procesin e grumbullimit të të dhënave në BPRM, në dhjetor të vitit 2017 u bënë ndryshime në aktet nënligjore për raportimin e investimeve kapitale në dhe jashtë vendit. Risia më e rëndësishme është futja e metodës së mostrës, në vend të metodës aktuale të regjistrimit, gjatë raportimi mbi investimet kapitale në vend, si dhe zvogëlimi i barrës së raportimit për investimet e portofolit brenda dhe jashtë vendit. Rritja e efikasitetit të sistemit ekzistues të raportimit në periudhën e ardhshme do të vazhdojë përmes futjes së raportimit elektronik;

- në aspektin e komunikimit me përdoruesit, rregullisht janë publikuar njoftimet për shtyp për grupet bazë të të dhënave statistikore, publikimi i të cilave është nën autoritetin e BPRM, njëkohësisht me publikimin e të dhënave. Në vitin 2017, për herë të parë u publikua një njoftim i veçantë për auditimin vjetor të të dhënave nga statistikave të jashtme. Gjatë vitit u punua në ndërtimin e një mjeti softuerik i dizajnuar për analizë të brendshme të të dhënave statistikore, si dhe një portal interneti statistikor që do të rrit nivelin e disponueshmërisë dhe do të lehtësoj qasjen e përdoruesve të jashtëm në të dhënat statistikore që do të bëhen funksionale në vitin 2018.

- për të përmirësuar komunikimin me përdoruesit janë bërë aktivitetet për t'u bashkuar me standardet më të fundit të të dhënave të FMN-SDDS plus<sup>90</sup>. Si rezultat i aktiviteteve të rregullta të mëparshme lidhur me përmbushjen e kushteve për anëtarësim brenda këtij standardi (një proces i plotë i rishikimeve të brendshme të përshtatshmërisë së mbulimit dhe cilësisë së 5 treguesve prej 9 të disponueshëm), në prill 2017, BPRM në pozitën e koordinatorit kombëtar, filloi zyrtarisht iniciativën për t'u bashkuar me këtë standard më të lartë për publikimin e të dhënave. Në shtator 2017,

---

<sup>90</sup> Special Data Dissemination Standard Plus.



shqyrtimet përfundimtare të meta-të-dhënave (metadatave) për të gjithë treguesit e disponueshëm SDDS plus u dërguan në FMN;

- në kuadër të realizimit të funksionit statistikor, BPRM mori pjesë në punën e grupit ndërinstytucional për përpilimin e Programit për Sondazhet Statistike për 2018-2022, i cili është një dokument zyrtar që përmban të gjitha anketimet zyrtare statistikore në nivel kombëtar, duke përfshirë edhe 27 studimet statistikore nën juridiksionin e BPRM-së. Në periudhën prej 13 deri më 17 shkurt 2017 është krijuar një mision për vlerësimin e partneritetit të sistemit statistikor kombëtar në lidhje me përputhjen e statistikave në BPRM me Kodin e Praktikës së Mirë të Eurostat-it në të gjitha 15 parimet. Ndërkohë, në kornizat e Raportit të përgatitur nga ekipi vlerësues i Eurostat, përshtatshmëria e statistikave në kuadër të BPRM-së me Kodin e Eurostat është theksuar në disa raste.

Në ushtrimin e funksionit statistikor, BPRM bashkëpunon me bartësit e tjerë të autorizuar të anketimeve statistikore. Bashkëpunimi me EShS dhe MF u forcua më tej përmes aktiviteteve të grupeve punuese ndërinstytucionale për statistikën të llogarive financiare, statistikën fiskale dhe borxhin dhe deficitin e tepruar<sup>91</sup>, shpërndarjen e harmonizuar sektoriale e subjekteve ekonomike, si dhe përmes projekteve të përbashkëta për asistencë teknike për zhvillimin e mëtejshëm të disa fushave statistikore, para së gjithash për raportimin e borxhit dhe deficitit të tepruar.

---

<sup>91</sup> Raportimi i borxhit të tepruar dhe deficitit (Excessive deficit procedure EDP) është një grup i veçantë i të dhënave që shtetet anëtare të BE-së dhe vendet candidate duhet t'i dorëzojnë Eurostat-it, dhe ju referohet borxhit dhe deficitit të sektorit "shtet", sipas standardeve të përcaktuara për llogaritjen e saj.

## **XI. Auditimi i brendshëm**

Në vitin 2017, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm (DAB) zbatoi plotësisht programin e tij të punës. Përmes vlerësimit sistematik dhe rekomandimeve për përmirësimin e procesit të menaxhimit të rrezikut, përshtatshmëria dhe efektiviteti i kontrolleve të brendshme, si dhe proceset e menaxhimit, auditimi i brendshëm ka arritur qëllimet e tij primare, duke siguruar:

1. përdorimin efektiv dhe ekonomik të burimeve;
2. ruajtjen dhe mbrojtjen e sigurt të mjeteve;
3. besueshmërinë dhe integritetin e informatave financiare dhe të tjera; dhe
4. pajtueshmërinë e veprimeve me ligjet dhe aktet nënligjore, politikat e brendshme dhe procedurat për punë.

Në vitin 2017, janë kryer gjithsej 20 auditime të rregullta në gjithsej 25 procese pune, me gjithsej 19 rekomandime për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm. Në baza të rregullta tremujore, është ndjekur zbatimi i rekomandimeve të dhëna, dhe gjetjet nga monitorimi i kryer treguan se rekomandimet kryesisht respektohen dhe zbatohen brenda afatit të caktuar. Niveli i arritjes së rekomandimeve të dhëna në vitin 2017 është 100%.

Përveç auditimit të rregullt, auditimi i brendshëm ka pasur aktivitete shtesë përmes zbatimit të Programit për sigurimin e cilësisë dhe zhvillimin e punës. Nga ky aspekt, gjatë vitit 2017 janë bërë ndryshime në Rregulloren për punën e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm; është bërë edhe vetë-vlerësimi i aspektit organizativ dhe metodologjik të auditimeve të TI-së; është kryer një vlerësim i jashtëm i aktivitetit të auditimit të brendshëm nga ekspertë të pavarur nga Banka Qendrore e Holandës, si dhe aktivitete të tjera me karakter arsimor.

Puna e DAB-it ka qenë e mbikëqyrur nga afër nga Komiteti i Auditimit, i cili zhvilloi seanca të rregullta gjatë vitit 2017.

## XII. Përmirësimi i kapacitetit institucional të BPRM-së

### 12.1. Planifikimi strategjik


Në maj 2017, u miratua Plani i ri Strategjik i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë për periudhën 2018-2020. Plani strategjik përcaktohet në bazë të misionit, vizionit dhe vlerave organizative të BPRM-së, varësisht nga mjedisi makroekonomik dhe sfidat kyçe dhe përmban qëllimet strategjike bazë për periudhën e ardhshme trevjeçare. Qëllimet strategjike përcaktojnë pikat më të rëndësishme, kritike të funksionimit të BPRM-së, në bazë të të cilave janë bërë planet për njësitë organizative dhe Programi i punës së Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë për vitin e ardhshëm.

Programi i punës i bashkon aktivitetet e planifikuara programore të njërive organizative në BPRM dhe në të njëjtën kohë mundëson koordinimin e punës, vlerësimin më të mirë të rezultateve të planifikuara dhe të pritura, si dhe ndarjen adekuate të burimeve në dispozicion me qëllim të realizimit më efikas të qëllimeve strategjike.

### 12.2. Menaxhimi me resurset njerëzore

BPRM është një institucion që vazhdimisht kujdeset dhe investon në punonjësit e tij, që të forcojë aftësitë dhe kompetencat e tyre dhe të rrisë njohuritë profesionale, me qëllim që të krijojë një staf kompetent që do t'i përgjigjet në mënyrë adekuate sfidave për arritjen e suksesshme të qëllimeve të saj.

Grafiku 108  
Struktura e kualifikimit të të punësuarve në BPRM për vitin 2017 (në përqindje, të gjendjes deri më 31.12.2017)



Burimi: BPRM.

Në vitin 2017, numri i përgjithshëm i të punësuarve në BPRM është 446. Në vitin 2017, nuk shënohet ndryshim në strukturën gjinore të të punësuarve në BPRM krahasuar me vitet e mëparshme, me çka popullsia femërore është 59.6% kundrejt popullsisë mashkullore e cila është 40.4 %.


Sa i përket strukturës së moshës, moshë mesatare e punëtorëve është 44.8 vjet në 2017, kundrejt moshës mesatare prej 44.1 vjetësh, në vitin 2016. Grafik tregon strukturën e kualifikimit të BPRM-së për vitin 2017, sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve të Republikës së Maqedonisë (KKK). Sipas tij, përqindja më e lartë u regjistrua në arsimin e lartë, me një total prej 74.9% (nga të cilat përqindja më e lartë u regjistrua nga studimet katërvjeçare dhe master studimet me 42.7% respektivisht 19.8%).

Proceset e zhvillimit profesional, vlerësimi i performancës dhe shpërblimi janë procese që ndikojnë në zhvillimin e karrierës së punëtorëve në BPRM. Në vitin e fundit u

zhvilluan konsultime, me qasje stërvitore, në nivel të drejtorive, me qëllim të përmirësimit të mëtejshëm të procesit vjetor të vlerësimit të performancës së punëtorëve. Roli i menaxhimit me burimet njerëzore, përmes këshillimit, është të sigurojë një aplikim objektiv të vlerësimit të performancës dhe të ofrojë informata kthyesë të përshtatshme për punonjësit për arritjet e tyre. Ky sistem në Bankën Popullore përdoret si një mjet për angazhim më të madh, produktivitet dhe shfrytëzim të njohurive dhe potencialit krijues në institucion. Në të njëjtën kohë, për zbatimin cilësor të këtyre proceseve, si çdo vit, u punua në zhvillimin e aftësive profesionale dhe të buta të punëtorëve dhe menaxherëve në institucionin.

BPRM vazhdimisht investon në aftësimin profesional dhe përmirësimin e të gjithë të punësuarve, në mënyrë që të përmbushen qëllimet strategjike, misioni dhe vizioni i institucionit. Gjatë vitit 2017, u organizuan gjithsej 347 trajnime profesionale në vend dhe jashtë shtetit.

Grafiku 109  
Trajnime profesionale të realizuara në vend dhe jashtë vendit (numri i trajnimeve profesionale, gjendja deri më 31.12.2017)



Burimi: BPRM.

Krahasuar me vitin paraprak, numri i përgjithshëm i aftësimit profesional është rritur me 10.9%, ndërsa në vend është rritur me 22.6%. Numri i të punësuarve që kanë marrë pjesë në aftësimin profesional në vitin 2017 është rritur me 20.6% krahasuar me vitin e kaluar.

Organizatorët kryesorë të jashtëm të trajnimeve profesionale janë bankat qendrore evropiane dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar në bashkëpunim me Institutin e Bashkuar të Vjenës, me të cilin BPRM bashkëpunon intensivisht përmes programeve për bashkëpunim të ndërsjellë.

Si organizatorë kryesor të aftësimeve profesionale në vend paraqiten qendrat e brendshme të edukimit, në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe ndryshimin e rregulloreve ligjore, të cilat janë në domenin e punës së BPRM-së.

BPRM i ndjek trendët në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore, inkurajon të mësuarit e vazhdueshëm dhe zhvillimin e punëtorëve, dhe veçanërisht të kuadrove të rinj. Për këtë qëllim, në mënyrë të vazhdueshme, organizon trajnime të brendshme të lidhura me forcimin e aftësive të buta, të punonjësve dhe strukturës drejtuese të BPRM-së, si dhe trajnime të specializuara për njohuri profesionale.

### 12.3. Aktiviteti hulumtues

Aktiviteti hulumtues i BPRM-së në vitin 2017 u fokusua në fushat që janë të rëndësishme për arritjen e qëllimeve themelore të punës, mbështetjen e procesit të vendimmarrjes, parashikim në kohë të sfidave të ardhshme, si dhe forcimin e mëtejshëm të kapacitetit institucional. Gjatë vitit 2017 janë punuar disa projekte kërkimore, të cilat kanë të bëjnë me: vlerësimin e produktivitetit të ekonomisë

nëpërmjet përdorimit të mikro të dhënave, dekompozimi i projeksionit të inflacionit të fituar me modelin MAKPAM të BPRM-së, vlerësimi i kanalit të kreditit të transmetimit monetar në Maqedoni, si dhe vlerësimin e kanalit të marrjes së rrezikut nga lehtësimi sasior i BQE-së mbi flukset e kapitalit në rajon, analizë e rezultateve të hulumtimit anketor mbi financimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, efektet e kreditimit të popullsisë dhe të sektorit korporativ në llogarinë rrjedhëse, lidhjen midis flukseve të kapitalit dhe aktivitetit të investimit, efektet e transmetimit të inflacionit të eurozonës mbi inflacionin në rajon, përcaktuesit e kredive jo-performuese të ndërmarrjeve dhe popullsisë, implikimet makroekonomike nga rritja e borxhit të ekonomive familjare. Për më tepër, gjatë vitit janë punuar projekte të tjera kërkimore, realizimi i të cilave është në vijim, kryesisht në fushën e: ndërveprimeve midis sektorëve bazë makroekonomikë, stabilitetit financiar dhe sistemit bankar. Programi i aktivitetit kërkimor për periudhën 2018-2020, i miratuar në mesin e vitit 2017, udhëzoi të vazhdohet me aktivitetet në kuadër të fushave kërkimore bazë, dhe u plotësua me disa projekte të reja.

Më 5-7 prill 2017, u organizua Konferenca e Gjashtë Hulumtuese me temën: "Bankingu qendror në kushtet e pasigurisë së vazhdueshme globale: Mësimet më të reja gjatë kërkimit të "normales së re". Konferenca tradicionalisht është mbajtur me rastin e pavarësisë monetare dhe këtë herë si shenjë e shënimit të 25 vjetorit të pavarësisë monetare të Republikës së Maqedonisë. Njëherit, për herë të parë konferenca u organizua si një ngjarje e përbashkët me Shkollën Ekonomike të Londrës - hulumtimi i Evropës Juglindore, dhe Konferencën e tyre mbi Kohezionin Social në Evropën Juglindore. Konferenca filloi me një panel mbi politikën e përfaqësuesve të lartë të bankave qendrore, institucioneve akademike dhe kërkimore, ndërsa gjatë dy ditëve të konferencës u mbuluan disa sesione në të cilat prezantuan materiale hulumtuese të përfaqësuesve të bankave qendrore dhe institucioneve akademike nga rajoni dhe BE-ja. Në kuadër të kësaj ngjarjeje, u nda edhe çmimi i rregullt vjetor i BPRM-së për punimin më të mirë të hulumtuesit të ri në fushën e makroekonomisë dhe bankave dhe sistemeve bankare.

Në kuadër të aktiviteteve për përkrahjen e zhvillimit të veprimtarisë hulumtuese dhe analitike, vazhdoi puna e Klubit Kërkimor, i cili është i hapur për hulumtuesit jashtë BPRM-së. Gjatë vitit 2017 u mbajtën katër seanca të rregullta tremujore të Klubit, në të cilat u prezantuan dhe u shqyrtuan disa punime shkencore-hulumtuese, të cilat ishin të lidhura me pyetjet kërkimore në fushën e politikës monetare, bankingut, lidhjeve midis variablave të caktuara makroekonomike dhe vlerësimit të cenueshmërisë potenciale të krizave. Gjatë vitit 2017, në fushën e veprimtarisë kërkimore, BPRM kishte bashkëpunim teknik me Bankën Qendrore të Belgjikës, e cila u realizua nëpërmjet shkëmbimit të përvojave në fushën e veprimtarisë kërkimore në dy bankat qendrore, si dhe nëpërmjet bashkëpunimit në një projekt specifik hulumtimi. Punonjësit e BPRM, me punimet dhe prezantimet e tyre, morën pjesë në disa konferenca dhe ngjarje ndërkombëtare.

#### **12.4. Menaxhimi i rreziqeve operacionale**

Duke pasur parasysh kornizën e krijuar për administrimin e rreziqeve operacionale, gjatë vitit 2017, është bërë një rishikim i regjistrit të proceseve të punës dhe është përditësuar shkalla e rëndësisë së tyre. Gjithashtu, bazuar në monitorimin sistematik të proceseve të punës dhe burimeve të mundshme të rrezikut operacionel, janë identifikuar ngjarjet bazë të rrezikut. Duke u nisur nga vlerësimi i mundësive dhe

pasojave të mundshme të materializimit eventual të ngjarjeve të rrezikshme, është bërë një vlerësim i nivelit të rrezikut operacional. Strategjitë dhe masat për ballafaqimin me rreziqet operationale të identifikuara janë përfshirë në aktivitetet programore të njëjësive organizative të BPRM-së për vitin 2017.

### **12.5. Sigurimi i vazhdimësisë në punë**

Duke filluar nga politika e vazhdimësisë së punës e Bankës Popullore, BPRM siguron një sistem për planifikimin e koordinuar, përditësimin dhe testimin e masave të nevojshme për të siguruar vazhdimësinë e proceseve të punës në një situatë krize.

Gjatë vitit 2017, planet për sigurimin e vazhdimësisë në punë (PVP) janë rishikuar për një total prej 97 procesesh pune. Për më tepër, për të konfirmuar plotësinë dhe zbatueshmërinë e planeve për vazhdimësinë e proceseve kritike të punës, gjatë vitit 2017 janë ndërmarrë aktivitete për përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm, trajnimin e të punësuarve dhe testimin e planeve për sigurimin e vazhdimësisë së tetëmbëdhjetë proceseve kritike të punës, në kushte të skenarëve të krizave të paracaktuara dhe gamën e testimit. Për rezultatet e testeve të kryera, janë përgatitur raporte të detajuara me planet e duhura të veprimit për zbatimin e masave të përcaktuara për përmirësimin e planeve për sigurimin e vazhdimësisë.

### **12.6. Siguria e sistemit të informacionit dhe mbrojtja e të dhënave personale**

Nga aspekti i aktiviteteve për të siguruar përputhjen e akteve të brendshme përkatëse dhe funksionimin e BPRM-së me rregulloret për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe me ndryshimet në mjedisin që mbartin rrezik potencial për rrezikimin e sigurisë së sistemit informativ, janë kryer kontrole periodike në bazë të të cilave janë dhënë rekomandime për të tejkaluar mospërputhjet e identifikuara. Gjithashtu, në kuadër të aktiviteteve të rregullta janë analizuar incidentet që janë paraqitur gjatë punës, me çka edhe raportin vjetor i incidenteve të regjistruara gjatë vitit të kaluar është shqyrtuar nga Bordi mbikëqyrës për sigurinë e sistemit të informacionit.

Në periudhën Maj-Dhjetor 2017, në BPRM u realizua një projekt i jashtëzakonshëm i cili kishte për qëllim verifikimin dhe konfirmimin e përputhshmërisë së BPRM-së me kontrollet e detyrueshme të sigurisë të specifikuara në dokumentin "Korniza për kontrollet e sigurisë tek klientët"<sup>92</sup>, i cili u botua nga SWIFT më 31 mars 2017. Ekipi i projektit për verifikimin e përputhshmërisë së BPRM-së me kontrollet e detyrueshme të sigurisë të përshkruara nga SWIFT, ka bërë një kontroll mbi pajtueshmërinë e BPRM-së me gjithsej 225 kërkesa për siguri, të grupuara në 16 kontrole të detyrueshme, dhe në dhjetor 2017 e publikuan dokumentin e përputhshmërisë së BPRM-së me kontrollet e detyrueshme të parapara në "Kornizën për kontrollet e sigurisë tek klientët" në regjistrin KIC (KYC)<sup>93</sup>të SWIFT-it.

<sup>92</sup>Customer Security Controls Framework.

<sup>93</sup> Aplikacioni "Njoftoje klientit tuaj" (Know Your Customer) përdoret për të shkëmbyer informacione ndërmjet anëtarëve të SWIFT-it.

## 12.7. Zhvillimi në fushën e teknologjisë informatike

Në vitin 2017, në fushën e teknologjisë së informacionit, u punua në më shumë se 6,500 raste pune. Nga këto, shumica, ose 54%, janë kërkesa për shërbime IT, 32% janë të lidhura me zgjidhjen e incidenteve, ndërsa 14% i përkasin mirëmbajtjes së rregullt të infrastrukturës së informacionit dhe përmirësimit të saj. Drejtoria e TI-së mirëmban rreth 130 servera, 460 stacione pune, 190 aplikacione (kryesisht zgjidhje softuerike të zhvilluara brenda BPRM-së dhe një pjesë e vogël e blerë nga furnizues të jashtëm), si dhe një gamë të gjerë të burimeve të tjera të TI-së që punonjësit e bankës përdorin çdo ditë.

Për të përmirësuar në vazhdimësi funksionet dhe kontrollet e përgjithshme të sigurisë në BPRM, të cilat duhet të jenë në përputhje me kërkesat e biznesit dhe rregullatorit, në tremujorin e parë të vitit 2017, u bë zëvendësimi i sistemit të vjetër dhe është instaluar një sistem i ri SIEM për menaxhimin e ngjarjeve dhe incidenteve në fushën e sigurisë së informacionit. Në këtë mënyrë është rritur efikasiteti operacional në analizën e ngjarjeve të sigurisë për pajisjet e përgjithshme të TI-së, si: pajisjet e rrjetit, serverat, stacionet e punës (workstations) dhe natyrisht, janë përmirësuar performancat e pajisjeve dhe aplikacioneve nga të cilat janë mbledhur ngjarjet e sigurisë.

Për vitin 2017 janë planifikuar 34 projekte softuerike të TI-së, prej të cilave janë realizuar 22 projekte të TI-së, 10 projekte të TI-së janë në proces edhe në vitin 2018, ndërsa 2 janë anuluar.

Drejtoria e TI-së në vitin 2017 realizoi një sërë aktivitete për harmonizimin e BPRM-së me kërkesat e detyrueshme të sigurisë të përshkruara nga ana e SWIFT në dokumentin e titulluar "Korniza për kontrollet e sigurisë tek klientët"<sup>94</sup>, me çka edhe u bë inkuadrimi i sistemeve të reja, rikonfigurimi i sistemeve ekzistuese, ndryshimi në regjistrat, procedurat dhe udhëzimet, trajnimi i punonjësve dhe riorganizimi i punonjësve për ndarje më të mirë të detyrave.

Në nëntor 2017, nga lokacioni rezervë i BPRM-së me sukses u bë testimi dhe kontrollimi i funksionalitetit të pajisjeve të TI-së në lidhje me Planin për sigurimin e vazhdimësisë së proceseve të punës lidhur me MIPS në kushte të një shtate krize.

Në periudhën tetor-dhjetor 2017, një kompani e specializuar e huaj ka kryer një inspektim dhe vlerësim të testimit të sigurisë nga depërtimi (në gjuhën angleze penetration testing) ë sistemin informativ të BPRM-së. Kontrolli përfshiu sistemet operative, bazat e të dhënave dhe softuerët e tjerë të sistemit, si dhe siguria e aplikacioneve për 18 sistemet kritike. Kontrolli u krye në 2 (dy) faza, për një periudhë prej 75 ditësh, gjatë të cilave u prezantuan shtatë rekomandime, një informative dhe gjashtë me rrezik të ulët.

Në tremujorin e fundit të vitit 2017, mbaroi migrimi i softuerit për ndjekje të sistemeve operative (System Center Operation Manager), nga versioni 2012 në versionin 2016, me çka Drejtoria për TI një fitoi një dukshmëri më të mirë të statusit dhe performancës së serverëve, pajisjeve të rrjetit dhe shërbimeve të TI-së, si dhe raportimin më të shpejtë të problemeve akute në infrastrukturën e TI-së.

---

<sup>94</sup>Customer Security Controls Framework.

## **XIII. Aktivitete të tjera**

### **13.1. Bashkëpunimi ndërkombëtar**

Gjatë vitit 2017, BPRM-ja ka vazhduar aktivitetet e saj të lidhura me mirëmbajtjen dhe promovimin e bashkëpunimit ndërkombëtar, si në baza multilaterale ashtu dhe në baza bilaterale.

Në kuadër të bashkëpunimit multilateral, është kryer vizitë e rregullt nga ana e përfaqësuesve të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) të lidhura me konsultimet në përputhje me nenin IV të Statutit të Fondit. Gjithashtu gjatë vitit 2017 vazhdoi bashkëpunimi me FMN-në në fushën e statistikave, me qëllim të përmirësimit të statistikave që janë në kompetencë të BPRM-së. Sa i përket bashkëpunimit me Bankën Botërore, u realizuan dy misione të asistencës teknike në fushën e mbikëqyrjes bankare, e cila u krye nga "FINSAK" (FinSAC – World Bank Financial Sector Advisory Centre). Guvernatori dhe Zëvendësguvernatorët e BPRM-së morën pjesë në takimet e rregullta pranverore të Asamblesë vjetore të FMN-së dhe Bankës Botërore, si dhe në takimin e konstituencës holandeze. Gjatë vitit 2017, BPRM-ja mori pjesë në disa nga mbledhjet e rregullta të Bankës për Marrëveshjet Ndërkombëtare në Bazel, si dhe takimet e organizuara nga ana e Klubit të guvernatorëve të bankave qendrore të Rajonit të Detit të Zi, Ballkanit dhe Azisë Qendrore.

Në kuadrin e bashkëpunimit bilateral, gjatë vitit 2017, BPRM-ja kishte bashkëpunim më të frytshëm me Bankën Kombëtare të Belgjikës, duke vazhduar bashkëpunimin teknik afatgjatë të krijuar me Bankën Qendrore Holandeze, Bankën Qendrore të Gjermanisë, si dhe me bankat e tjera qendrore nga BE-ja dhe vendet në rajon. Sa i përket Bankës Qendrore Evropiane (BQE), bashkëpunimi u realizua në kuadrin e qasjes rajonale për bashkëpunimin midis BQE-së dhe bankave qendrore të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Përveç kësaj, gjatë këtij viti, me iniciativën e bankës qendrore të Turqisë, u nënshkrua një Memorandum Mirëkuptimi me qëllim të promovimit të bashkëpunimit të ndërsjellë.

Edhe në vitin 2017, BPRM-ja ka marrë pjesë në aktivitetet strategjike kombëtare që kanë të bëjnë me procesin e aderimit të Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian, nëpërmjet pjesëmarrjes së saj të duhur në dialogun e rregullt me Komisionin Evropian në kuadër të nënkomiteteve që rrjedhin nga Komiteti për Stabilizim dhe Asociim, pjesëmarrjes në përgatitjen dhe zbatimin e programit vjetor kombëtar për miratimin e të drejtës së Bashkimit Evropian (NPAA), pjesëmarrjes në përgatitjen e kontributit të Republikës së Maqedonisë në raportin vjetor të Komisionit Evropian, si dhe në përgatitjen e Programit të Reformës Ekonomike (ERP).

Sa i përket fondeve të para-pranimit që janë në dispozicion nga BE, në vitin 2017, BPRM-ja realizoi projekte të financuara përmes Instrumentit të Ndihmës së Para-Anëtarësimit (IPA) dhe Instrumentit të Bashkëpunimit Teknik dhe Shkëmbimit të Informatave (TAIEX).

Në kuadër të instrumentit të IPA-s, Banka popullore u përfshi si përfituese në kuadrin e programeve kombëtare për vitin 2012, si dhe në Programin Multi-Përfitues për bashkëpunim statistikor të IPA për 2015. Gjatë vitit 2017, vazhdoi projekti i mëhershëm



"Krijimi i një mjeti analitik të brendshëm dhe portal statistikor në Internet për përdoruesit e jashtëm", me realizimin e të cilit pritet të ketë përmirësim në disponueshmërinë e të dhënave statistikore për përgatitjen e të cilave është kompetente BPRM , duke siguruar qasje më efikase dhe më të lehtë tek të dhënat që janë në dispozicion për përdoruesit e brendshëm dhe të jashtëm. Në kuadër të Programit Multi-Përfitues të IPA-s për bashkëpunim statistikor, u ofrua mbështetje financiare për pjesëmarrjen e përfaqësuesve të BPRM-së në takimet e rregullta dhe komitetet e Eurostat-it në fushën e statistikave të bilancit të pagesave.

Në kuadrin e instrumentit TAIEX, gjatë vitit janë realizuar tre projekte në disa fusha të punës së sistemit bankar qendror.

### **13.2. Marrëdhëniet me publikun**

BPRM, në vitin 2017 bëri përpjekje për transparencë dhe informim në kohë të publikut për aspekte të ndryshme të fushës së veprimtarisë së institucionit. Informimi u bë nëpërmjet komunikimit të rregullt me mediat publike, përmes publikimit të njoftimeve për shtyp dhe materialeve të tjera që synojnë informimin e publikut, me përgjigje të rregullt dhe në kohë të pyetjeve gazetareske, dhënien e intervistave, organizimin e konferencave për shtyp si dhe publikimin e përmbajtjeve në faqen e internetit ([www.nbrm.mk](http://www.nbrm.mk)).

Duke e ndjekur zhvillimin e teknologjisë, në suaza të aktiviteteve për përafrimin e punës së BPRM-së me publikun e gjerë dhe për ngritjen e vetëdijes së qytetarëve për fushën e veprimtarisë dhe funksionimit të institucionit, në vitin 2017 BPRM-ja përgatiti dhe lëshoi në produksion një faqe të re institucionale te internetit. Njëri nga qëllimet që duhej arritur me këtë ndryshim ishte funksionaliteti më i madh dhe shikueshmëria më e madhe e faqes së internetit, edhe atë përmes të gjitha pajisjeve nga të cilat ka mundësi për qasje në faqet e internetit, gjë që do t'u mundësonte përdoruesve qasje më të lehtë dhe më të shpejtë tek informatat dhe të dhënat që janë subjekt i interesit të tyre.

Në faqen e internetit edhe më tej përditësohen informata rreth: njoftimet e rregullta të BPRM-së, njoftimet për zbatimin e instrumenteve të politikës monetare, njoftimet për të dhëna dhe publikime të reja (në gjuhën maqedonase dhe angleze, dhe për pjesën më të madhe edhe në gjuhën shqipe). rregullisht përditësohen përmbajtjet e postuara në domenin e aktiviteteve të BPRM-së.

Me rritjen e efikasitetit dhe arritjen e afateve më të shpejta për dërgimin e përgjigjeve, vazhdoi komunikimi i drejtpërdrejtë me publikun edhe përmes e-mailit [info@nbrm.mk](mailto:info@nbrm.mk), si dhe përmes formave të kontaktit të faqeve zyrtare të BPRM-së në rrjetet sociale. Institucioni gjithashtu ka një adresë të veçantë për qasje të lirë në informacione me karakter publik, si dhe adresa elektronike për pyetje dhe përgjigje në fushën e statistikave dhe mbikëqyrjes. Ka filluar të funksionojë dhe një adresë e veçantë për pyetjet nga ana e gazetarëve në mënyrë që të konsiderohen në kohë dhe përgjigjet të dorëzohen në një kornizë kohore më të shkurtër.

Raportet vjetore, tremujore, mujore dhe raportet tjera të punës publikohen në formë elektronike në faqen e internetit të BPRM-së, në gjuhën maqedonase dhe në atë angleze. Raporti vjetor i punës publikohet edhe në formë të shtypur, në gjuhën

maqedonase dhe në gjuhën angleze. Duke filluar nga viti 2015 është filluar me përkthimin e raporteve vjetore dhe tremujore të punës edhe në gjuhën shqipe, ndërsa raportet e përkthyer janë publikuar në faqen e internetit të BPRM-së.

Duke ndjekur trendët e reja në mënyrën e komunikimit të bankave qendrore me publikun, në vitin 2017 BPRM-ja përgatiti një plan operacional për zhvillimin e faqeve të institucionit në rrjetet sociale, përmbushja e të cilave ka filluar tashmë dhe pritet që këto faqe të jenë edhe më të disponueshme dhe më të pranueshme për audiencën e gjerë në periudhën e ardhshme.

Në vitin 2017 u përgatit një plan për futjen e një sistemi të centralizuar elektronik për koordinimin e marrëdhënieve me publikun - BPRM Media, i cili do të fillojë të funksionojë në 2018. Duke ndjekur shembullin e një sërë bankash qendrore, BQE, FMN dhe institucione dhe organizata të tjera ndërkombëtare, BPRM-ja përgatiti një koncept për integrimin e shtypit elektronik në punën e institucionit dhe filloi zbatimin e tij, me qëllim që të bëjë rritjen e ndërgjegjësimit të publikut dhe përmirësimin e marrëdhënieve me publikun.

### **13.3. Edukimi financiar**

Gjatë vitit 2017, janë kompletuar disa aktivitete në fushën e edukimit dhe njohurive financiare.

Gjatë gjithë vitit, në hapësirat e BPRM-së janë mbajtur leksione interaktive për nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme. Janë përfshirë mbi 1200 studentë të cilët kanë qenë të bashkangjitur nga mësuesit dhe profesorët. Përveç leksioneve për çështjet e politikës monetare dhe funksionet themelore të BPRM-së, vizitat përfshinë edhe vizitë të muzeut, si dhe farkëtarit pranë BPRM-së. Gjithashtu, BPRM-ja organizon një karvan vizitash në më shumë se 15 shkolla fillore dhe të mesme nga 9 qytete dhe komuna në vend.

Në janar 2017, BPRM dhe Byroja për zhvillimin e arsimit nënshkruan një Memorandum Bashkëpunimi në fushën e edukimit financiar dhe fushave të tjera të arsimit. Të dy institucionet e kryejnë bashkëpunimin në fushën e edukimit financiar përmes hartimit të politikave, kryerjes së hulumtimeve dhe analizave, ndërmarrjes së aktiviteteve të përbashkëta për ngritjen e vetëdijes publike dhe promovimin edukimit financiar, si dhe shkëmbimin e ekspertizës përkatëse. Me këtë bashkëpunim kontribuohet në ngritjen e vetëdijes në mesin e nxënësve dhe forcimin e njohurive të tyre në fushën e financave.

Java Globale e Parave (JGP) u mbajt të dielën, nga 27 mars deri më 2 prill, dhe në ditën e parë të kësaj jave Trupi Koordinues i Institucioneve Rregullatore për Edukimin Financiar në Maqedoni, në bashkëpunim me Byronë për Zhvillimin e Arsimit dhe Bashkësia e Organizatave Mikrofinanciare, shënoi fillimin e JGP përmes shumë aktiviteteve edukative – P.sh. karvanët edukative. Në këtë karvan, u organizuan vizita nga nxënës të katër shkollave të mesme nga Shkupi në ambientet e pesë rregullatorëve (BPRM, Ministria e Financave, Agjencia për Mbikëqyrjen e Sigurimeve, MAPAS dhe Komisioni i letrave me vlerë), si dhe në Bursën e Maqedonisë, një fond pensional, një fond investimi, një bankë komerciale, një shtëpi kursimi dhe një kompani

sigurimi. Pastaj, gjatë gjithë javës, u organizuan vizita në qytete të ndryshme. Ky vit ishte viti i pestë me radhë që u shënuar JGP në Republikën e Maqedonisë.

Më 11 maj 2017, për herë të parë u shënuar "Dita e Edukimit Financiar", një ngjarje e organizuar nga Trupi Koordinues i institucioneve rregullatore për edukimin financiar në Maqedoni. Qëllimi i ngjarjes ishte rritja e vetëdijes në mesin e popullatës, mbi të gjitha tek të rinjtë, për marrjen e vendimeve të shëndosha financiare në të ardhmen në mënyrë më të lehtë dhe më të sigurt. Edukimi financiar është një faktor i rëndësishëm për ndërtimin e një sektori financiar të qëndrueshëm dhe të sigurt dhe kjo ngjarje ka rezultuar e suksesshme në aspektin e ngritjes së vetëdijes publike lidhur me funksionimin e institucioneve financiare dhe rregullatorëve të tyre.

Në nëntor të vitit 2017, Banka Kombëtare e Republikës së Maqedonisë, Ministria e Financave dhe Agjencia për Mbikëqyrjen e Sigurimeve dhanë çmime për veprat më të suksesshme artistike dhe letrare të shpallura në konkurs me rastin e "Ditës Botërore të Kursimeve - 31 Tetor" në dy tema në fushën e kursimit "Edhe unë mund të kursej" dhe në fushën e sigurimit "Çfarë do të thotë për mua sigurimi i shtëpisë dhe familjes time". Në konkurs kishte mbi 780 pjesëmarrës nga mbi 100 shkolla që dërguan vepra artistike dhe letrare në tema të lidhura me kursimet dhe sigurimet. Të gjitha shkollave fillore dhe të mesme që morën pjesë në konkurs iu dha certifikatë falënderimi për interesin e treguar, i cili paraqet nxitje për nxënësit dhe stafin mësimdhënës për të mbështetur gjeneratat e ardhshme për të dërguar krijime kreative në konkurset e viteve në vijim.

Në dhjetor 2017, BPRM-ja dhe rregullatorët e tjerë të sistemit financiar, në bashkëpunim me Fondin Evropian për Evropën Juglindore (EFSE DF), organizuan punëtorin e tretë për gazetarët nga redaksionet ekonomike të mediave të shkruara dhe elektronike. Tema e punëtorisë së këtij viti ishte "Lexim dhe interpretim i saktë i raporteve të BPRM-së dhe institucioneve të tjera rregullatore". Qëllimi i punëtorisë ishte rritja e nivelit të edukimit financiar në mesin e popullatës nëpërmjet bashkëpunimit me gazetarët nga redaksitë ekonomike që informojnë publikun për tendencat dhe gjendjet më të fundit në fushën e ekonomisë.

#### **13.4. Aktivitetet e Muzeut dhe Bibliotekës dhe arkivit të BPRM-së**

Aktiviteti i muzeut të BPRM-së, përveç detyrave aktuale të punës dhe aktiviteteve të tjera të rëndësishme që lidhen me aspektet e auditimit dhe kontrollit të Mbledhjes Numizmatike të BPRM-së dhe punës së muzeut, përfshinte një numër aktivitete të kërkimore dhe përgatitore për edukimin e drejtpërdrejtë rreth muzeut për fëmijët dhe të rinjtë dhe vizitorët e tjerë të ekspozitës së përhershme të muzeut. Në të njëjtën kohë, Muzeu gjithashtu kontribuoi në pjesëmarrjen në konferencat ndërkombëtare dhe rajonale lidhur me punën e muzeut dhe prezantimin e tij të duhur. Gjithashtu, Muzeu ishte i përfshirë në mënyrë aktive në instalimin e ekspozitës "Pluhuri i Artë" të Muzeut Kombëtar të Sllovenisë, me të cilin u shënuar 25 vjetori i pavarësisë monetare të Republikës së Maqedonisë. Përveç kësaj, në kuadër të punës hulumtuese muzeologjike, u përgatit projekt detyra për ekspozitën e re të përhershme të muzeut të BPRM-së. Në kuadër të punës së veçantë kërkimore numizmatike, e cila përfshin studimin dhe interpretimin e aspekteve të ndryshme të numizmatikës dhe të historisë monetare të Maqedonisë, u përfundua gjithashtu edhe hulumtimi mbi përdorimin e parave në Maqedoninë e Epërme në periudhën e lashtë, e cila ishte e mbështetur nga BPRM-ja,

ndërsa gjithashtu u vazhdua me studimin segmentar të qarkullimit lokal të parave para-romake, romake dhe bizantine nga pjesa jugperëndimore e Maqedonisë.

Veprimtaritë hulumtuese të Bibliotekës dhe arkivit, gjatë vitit të kaluar, kanë qenë të lidhura me pasurimin e fondit të bibliotekës dhe atij arkivor: monitorimin e risive në tregun e librave, përzgjedhjen për shtypjen e botimeve periodike, digjitalizimin e materialit arkivor që rrjedh nga puna e BPRM-së dhe aktivitetet kërkimore në Njësinë për shkarkimin e materialit të rëndësishëm për punën e bankës qendrore në Republikën e Maqedonisë.